



Eduard Abazi
PAD: Largohehi nga koalicioni, aleancë me PS

► Faqe 8



Anëtar i PBDNJ
Jani: Zgjedhjet e 2013, të pagarantuara nga KQZ

► Faqe 9



Vizita në Tiranë
Diplomati serb, misteri i ardhjes pa ftesë

► Faqe 6

[SHQIPTARJA.com]

TELEVIZIONI MË I RI
INFORMATIV NË SHQIPËRI

A1 REPORT!
origjina e lajmit...

LEKË 30

VITI II - NR. 251 E martë, 23-10-2012

NE DITEN E 31/ Ish të burgosurit politikë përfundojnë protestën për dëmshpërblimet

KATER ARSYET PSE U MBYLL GREVA E URISE

Zbulohen motivet që çuan në braktisjen e çadrës: Të kënaqur me ndërkombëtarizimin e protestës. Berisha u premtim një fond nga paratë e Alpetrolit, rezikonin përçarjen dhe ish-in të drobitur

Lajmi

Rreth orës 14:00 të ditës së djeshme, 6 grevistët që ndodheshin që prej 31 ditësh në çadrën e ngujimit, kanë vendosur të ndërpresin grevën e urisë. Sipas tyre arsytet ishin terrori psikologjik dhe gjendja e rënduar shëndetësore që po u rrezikonte edhe jetën.

TIRANE

ESMERALDA KETA

Vendimi për mbylljen e grevës së urisë së ish të burgosurve politikë, ka ardhur pas deklaratës që ka bërë rreth mesditës, zëdhënësi i komisionarit Fyle, për negociatën të qeverisë me ish të përdjekurit. Burime konfidenciale nga greva e urisë na thonë se shtytja kryesore për të marrë vendimin final, ka qenë pikërisht deklarata e Fyles që u bë rreth mesditës... ► vijon në faqe 4-5



Në foto: Grevisti i urisë Lavdosj Beqo, dje në mesditë duke i dhënë dorën njërit prej policëve që kishin rrethuar çadrën e grevës

NE ITALI REZULTON AKOMA E VJEDHUR

Italiani Nicolini nxori në shitje "Jaguar"-in më 3 Shtator

Një tjetër mister mbrapa makinës për të cilën u arrestua Asllan Patrioti



TIRANE

HABJON HASANI

Makina Jaguar, për të cilën Asllan Patrioti, koordinator i grevës së urisë vazhdon të jetë në burg... ► Faqe 2-3

NERANXI
... gjithmonë një hap përpara...
Patatina Nachos dhe Meksikane
shoqëruar me salcat dhe djathin përkatës
Adresa: Autostrada Tiranë - Durrës, km 7, Yrshek Tiranë; Tel: 042 406 500; 042 406 501; Fax: 042 406 502; e-mail: neranxi@neranxi.com; www.neranxi.com

BLOG/ JOGA DHE JU

► Faqe 18




HARMONIA E JOGËS DHE SPORTET

NGA ANILDA NOCKA

"FIKS FARE"

► Faqe 12



Fishekët kinezë, Poliçani mashtroi zvicerianët

RAPORTI ► Faqe 15

Amnistia fiskale, KLSH: Mbledhja e parave dështoi

BULQIZE ► Faqe 17

Imitojnë skenë filmi, vetëvaret aksidentalisht 10-vjeçari

PIKTORI ► Faqe 20-21

Vdekja e Mios, studiuësja: Nuk u ndihmua për djalin

Koment



NGA AFRIM KRASNIQI

Greva dhe mësimet prej saj

Grupi i ish të përdjekurve politikë i ka dhënë fund grevës së tij 31 ditore. Dy të tretat e pjesëmarrësve në grevë përfunduan në spitale dhe vetëm gjashtë prej tyre ishin protagonistë të aktit të djeshëm final, kur në prani të policisë, medieve, diplomatëve të huaj dhe disa... ► vijon në faqe 22

Koment



NGA ANDI KANANAJ

Vetëvrasja e shumicës në pushtet

Nga entuziazmi i madh i pushtetit absolut përfaqësuesit e Partisë në pushtet po mendojnë me zë të lartë për punët e tjerëve. Të vjedhësh ditën me diell dhe mos të të duhet të merresh me ligjin të jep hapësirat e duhura të kohës që të angazhohesh me kundërshtarin, si për këshillime nga bota artit, ajo... ► vijon në faqe 22



Investigimi

Lajmi

Makina Jaguar, për të cilën Asllan Patrioti, koordinator i grevës së urisë vazhdon të jetë në burg, është nxjerrë në shitje nga Massimiliano Nicolini që në 3 shtator në gazetën Çelësi, për shumën 35 mijë euro. Në Itali, sipas autoriteteve atje, kjo makinë rezultoi në vjedhur. Massimiliano e ka marrë me leasing, ndërkohë që në Shqipëri pasi e denoncon të vjedhur, e nxjerr në shitje.

■ ■ ■ TIRANE

HABJON HASANI

Një kërkim i thjeshtë në internet duket se ka ofruar detaje të rëndësishme në lidhje me Massimiliano Nicolinin dhe makinën e tij të vjedhur "Jaguar", e cila u bë shkas për arrestimin e koordinatorit të grevës Asllan Patrioti. Më datën 12 Shtator 2012 Massimiliano Nicolini ka regjistruar në Tiranë kompaninë e tij "Balcan Company". Në të dhënat e portalit të QKR-së në lidhje me këtë kompani jepet dhe numri i telefonit të kësaj kompanie. Nga një kërkim në internet rezultoi se i njëjti numër telefoni është lënë si numër kontakti në portalin e gazetës "Çelësi" në një njoftim për shitjen e një automjeti "Jaguar". Makina në shitje përshkruhet si një "Jaguar cv 4.2, ngjyrë e zezë e vitit 2008. Njoftuesi (që ka lënë si numër kontakti të njëjtin numër të përdorur nga Nicolini) deklaroi se këtë automjet e ka blerë në vlerën e 140 mijë eurove, ndërsa e ofron për shitje në vlerën e 35 mijë eurove, shifër kjo e negociueshme sipas njoftuesit. Me të njëjtin numër të shpallur në këtë njoftim në gazetën "Çelësi" gazeta Shqiptarja.com ka kontaktuar Nicolinin tre ditë më parë. Pra bëhet e qartë se ka qenë Massimiliano Nicolini ai që ka shpallur shitjen e automjetit të tij "Jaguar". Por ajo çka paraqitet si elementi më i rëndësishëm në këtë njoftim është data e postimit të tij. Shitja e automjetit "Jaguar" është shpallur më datën 3 Shtator 2012 nga Nicolini. Shqiptarja.com ka kontaktuar dje autoritetet italiane të cilat kanë konfirmuar se në Itali ky "Jaguar" vazhdon të jetë i klasifikuar si një automjet i vjedhur. Siç rezultoi nga njoftimi, Nicolini e ka gjetur "Jaguar"-in e tij të paktën që nga 3 Shtatori por ka mbi një muaj e gjysmë që nuk ka njoftuar gjetjen e tij. Autoritetet italiane kanë konfirmuar se automjeti i Nicolinit në Itali është i regjistruar në emrin e një kompanie "Leasing". Kjo do të thotë se Nicolini e ka marrë duke e paguar me këtë këtë automjet dhe deri në pagesën e plotë të shumës

Nicolini nxori në shitje "Jaguar"-in më 3 Shtator

Por në Itali rezultoi e vjedhur. Italiani e ka marrë me leasing

PYETJE PERGJIGJE

■ **Përse po investigon Shqiptarja.com në lidhje me makinën "Jaguar" të Massimiliano Nicolinit?**

Sepse Massimiliano Nicolini ka denoncuar në polici shtetasin Asllan Patrioti se i ka kërkuar rryshfet për gjetjen e makinës.

■ **Çfarë ka ndodhur me makinën?**

Makina është denoncuar si e vjedhur nga Nicolini në muajin Qershor, në këtë muaj ai ka denoncuar edhe ish-ortaken e tij si autore të vjedhjes. Më tej më 3 Shtator Nicolini rezultoi se e ka gjetur makinën dhe madje e ka vënë në shitje tek portali i gazetës "Çelësi".


■ **Si rezultojnë marrëdhëniet Patrioti-Nicolini?**

Rezultoi se ata janë njohur në mesin e muajit korrik. Në takimin e parë Nicolini i ka thënë Patriotit se i kishte humbur makinë dhe ky i fundit i ka deklaruar se do ta ndihmonte ta gjente shoqërisht makinën. Më datën 2 Gush Nicolini dhe Patrioti nënshkruajnë një marrëveshje bashkëpunimi. Më datën 22 Shtator Asllan Patrioti nis aktivitetin si koordinator i grevës së urisë, pra Patrioti nis këtë aktivitet 19 ditë pasi Nicolini e kishte gjetur makinën dhe e kishte vënë në shitje. Më datën 16 Tetor, një muaj e gjysmë pas gjetjes së makinës Nicolini i dërgon sms Patriotit dhe i thotë se donte ta takonte për t'i dhënë një shpërbilim mirënjohje pasi e kishte gjetur makinën, madje i kërkonte ndjesë për mungesën e gjatë të tij në javët e fundit

makina qëndron në emrin e kompanisë. Por ama në rast të vjedhjes apo grabitjes së automjetit, Nicolini nuk ka kurrëfarë detyrimit dhe humbja i shkon kompanisë "Leasing".

DATA


Përveç rrethanave të paqar-



Në foto: Massimiliano Nicolini (majtas) Faksimile e shpalljes më datën 3 Shtator 2012 në portalin "Çelësi" ku kërkohet shitja e "Jaguar"-it nga Nicolini

Në vitin 2011

Nicolini: Kam aplikuar për konsull i Shqipërisë



Faksimile e kërkesës së një kompanie italiane drejtuar Nicolini më 2010, ku atij i drejtohet me titullin konsull

ta të grabitjes së automjetit të Nicolinit dhe mossinjalizimin e autoriteteve italiane për gjetjen e tij prej 1 muaj e gjysmë, data e vënies në shitje të "Jaguar"-it ngre disa pikëpyetje edhe në lidhje me arrestimin e Asllan Patriotit. Nga itinerari i kësaj historie është mësuar që në muajin Qershor Massimiliano Nicolini ka denoncuar në Shqipëri dhe Itali grabitjen e "Jaguar"-it të tij. Në këtë muaj ai pa-diti ish-ortaken e tij si autore e kësaj grabitjeje. Në mesin e muajit korrik Nicolini është prezantuar me Asllan Patriotin. Sipas dëshmitares së takimit

Jonida.D në Korrik Nicolini i kishte treguar Patriotit për makinën e vjedhur, ky i fundit i kishte thënë se do ta ndihmonte miqësisht për ta gjetur, ndërsa në datën 2 gusht ata kanë nënshkruar dhe një kontratë bashkëpunimesi tyre. Më tej më datën 3 Shtator Nicolini shpall shitjen e makinës së tij "Jaguar" në portalin e gazetës "Çelësi". Më datën 22 Shtator fillon greva e urisë dhe Asllan Patrioti shërben si koordinator i saj. Të paktën 1 muaj e gjysmë pas gjetjes së makinës Nicolini kontaktonte më datën 16 Tetor Asllan Patriotin dhe i dërgon një sms

ku i thotë se kishte gjetur makinën dhe se donte ta takonte, ndërsa në sms i kërkonte dhe ndjesë që nuk ishte dukur për një kohë të gjatë. Dëshmitare e këmbimit të këtyre mesazheve është shtetasja Jonida.D e cila përktheu sms-në për llogari të Patriotit. Më datën 17 Tetor Nicolini dhe Patrioti takohen të "Vila Gold" ndërsa të dy kishin probleme për tu marrë vesh në gjuhën italiane, Nicolini i ka kërkuar në telefon përkthyesen Jonida.D duke i thënë që ta pyeste Asllanin se sa lekë donte për ndihmën që i kishte dhënë. Nisur nga kjo trajektore ng-

jarjesh është e qartë se Nicolini "është kujtuar" për Asllanin një muaj e gjysmë pasi kishte gjetur makinën dhe pas fillimit të grevës së ish-të përndjekurve. Në sms Nicolini i ka kërkuar ndjesë Asllan patriotit që nuk e kishte kontaktuar prej shumë kohësh. Atëherë në këto kushte lind pyetja e thjeshtë: Përse e denoncoi Massimiliano Nicolini Asllan patriotin për rryshfet dhe mashtrim? Nëse kishte 1 muaj e gjysmë që kishte gjetur "Jaguar"-in e tij dhe po kaq kohë pa takuar Patriotin, atëherë si ka mundur Patrioti t'i kërkojë lekët Nicolinit?



>Data: 02/08/2012 15.30
 >A: <m. [redacted]@libero.it>
 >Ogg: Re: R: Richiesta di Visure
 >
 > [redacted] > wrote:
 >
 >
 >>Ciao [redacted] La Bic in italia ha una domiciliiazione a Sossano(VICENZA) in Via del Rio 25 non ha la partita Iva ma il codice fiscale che è 98150030173. Ha partecipazioni in diverse Società Italiane che chiaramente non risultano il da quel che ho capito e se scrivi all'Ambasciata basta che vedano le partecipazioni in Società di Nicolini Masimiliano risalgono anche alla Bic domiciliata in italia con il numero di Codice Fiscale.Ed il conto corrente estero dove ha operato è presso la Banca FRIULADRIA di Este (VICENZA) mi pare, comunque nella provincia di Vicenza.Domattina dovrei riuscire ad avere una visura o qualche dato in più.Considera che Ivan Manzoni ,di Waterwall lo spettacolo con l'acqua, ha pagato 40.000 Euro che sono finiti su quel conto che Nicolini ha usato per cose sue private e quindi mai dichiarati ne in Italia ne in Albania.Oltre ad altri che ha truffato a cui ha fatto versare sempre su quel conto che è aperto come conto estero.Aspetta a dichiarare il conto corrente fino a quando ho ulteriori certezze.>>
 >>

Faksimile e e-mail-eve të dërguara nga Marco N. ish-ortaku i Massimiliano Nicolini

>>
 >>On Wednesday, August 1, 2012, [redacted] wrote:
 >>
 >>
 >>Lui n Italia ha dichiarato di essere Console dell'Albania (e la notizia è stata pubblicata anche lì) e in Albania se qualcuno dice di essere chi non è viene arrestato anche se straniero perchè lui no?
 >>
 >>Non conosco qualche giornalista che chieda pubblicamente come fa a girare tranquillo senza che nessuno gli dica nulla? Anche se lui ha dichiarato il falso, in Italia, lo ha fatto denigrando l'Albania e quindi dovrebbero arrestarlo per il coinvolgimento della Nazione Albanese nelle sue truffe.
 >>
 >>In Italia come ben sai diceva che la BIC e AIC erano Società a partecipazione StataleAdesso in Italia sta svolgendosi un'altro processo a suo carico ancora per bancarotta fraudolenta dove è coinvolto anche Nirvano e piano piano arrivano altri processi che deve fare
 >>
 >>TI RINGRAZIO DI CUORE UN FORTE ABBRACCIO PER QUALSIASI COSA IO CI SONO PER TE COME UN FRATELLO
 >>
 >>Marco

KOMUNIKIMET

Ortaku i italianit: Dyshoj për evazion fiskal

Zbardhen e-mail-et e bashkëpunëtorëve të Nicolinit

TIRANE

HABJON HASANI

Më datën 2 Gusht Asllan Patrioti dhe Massimiliano Nicolini kanë nënshkruar një kontratë bashkëpunimi të panoterizuar, Patrioti nënkroi si kryetar i shoqatës ndërsa Nicolini si pronar i kompanisë shqiptare "Balcan Investments Company"(BIC). Si për ironi , rezulton se në të njëjtën ditë dhe datë, pra më 2 Gusht dy ish ortakë të Nicolinit, njëri italian dhe tjetri shqiptar kanë këmbyer disa email-e mes tyre ndërsa përbajtja e email-eve hedh dritë në lidhje me dyshimet e forta të ish-ortakëve se Nicolini nëpërmjet kompanisë së tij shqiptare "BIC" po kryente evazion fiskal dhe po fshihte të ardhurat e fituara nga mashtimet që u kishte bërë biznesmenëve të ndryshëm. Shqiptarja.com publikon sot dy prej këtyre email-eve, që të dy email-et janë dërguar nga shtetasi italian Marco N. në drejtim të një biznesmeni shqiptar, që të dy personazhet kanë bashkëpunuar dikur me Nicolinin por në Gusht të vitit 2012 ata kanë nisur interesimin për Nicolinin dhe kompanitë e tij.

ITALIANI

Marco N. është një biznesmen italian, një menaxher që dikur ka punuar me Massimiliano Nicolinin në Shqipëri dhe në Itali. Burime të mirëinformuara kanë detajuar për Shqiptarja.com se Marco N. gjatë vitit 2010 ka qenë dhe përfaqësues i kompanive të Nicolinit dhe ka punuar për këto kompani. Në email-et e dërguara prej tij më datat 1 dhe 2 Gusht 2012, ai jep disa të dhëna "pikante" dhe shfaq hapur dyshimet e tij se Massimiliano Nicolini pasi ka hapur në Shqipëri kompaninë "BIC" ka krijuar më pas dhe

filiale të saj në Itali por pa i deklaruar këto filiale pranë autoriteteve shqiptare. Ish-ortaku i Nicolinit jep në email dhe koordinatat e këtij filiali

italian të kompanisë "BIC". "Kompania BIC (Balcan Investments Company) në Itali ka një seli të sajën në Sosano (Vicenza) në rrugën

"Via del Rio 25", nuk ka numër TVSH-je por ka numër NIPT-i 98150030173. Kjo kompani ka aksione në disa shoqëri italiane dhe këto gjëra nuk fig-

urojnë aty(në Shqipëri) nga sa di unë, kështuqë nëse i shkruan Ambasadës Italiane mjaft të shikojnë këto pjesëmarrjet në shoqëri të tjera të Massimil-

iano Nicolinit duke ju referuar dhe BIC(Balcan Investments Company)e cila rezulton në Itali e regjistruar me NIPT", - shkruan Marco N. , - ish bashkëpunëtori i Nicolinit në vitin 2010.

EMAIL

Në email-in e datës 2 Gusht 2012 ish ortakut i Nicolinit, Marco N. përmend dhe rastin e një biznesmeni italian që sipas tij është mashtruar nga Massimiliano Nicolini, në email thuhet se Nicolini i ka marrë pronarit të kompanisë italiane "Uateruall" një shumë prej 40 mijë eurosh pa i bërë punën e premtuar dhe duke e mashtruar. Por ish-ortaku Nodari në email hedh dyshime se Nicolini këto lekë i ka hedhur në një llogari bankare të deklaruar në Itali si "llogari jashtë vendit" ndërsa shton se këtë llogari bankare Nicolini nuk e ka deklaruar as tek autoritetet italiane dhe as te autoritetet shqiptare. "Ki parasysh që Ivan Manzoni, ai biznesmeni i spektakleve ujore i kompanisë "Uateruall" i ka paguar 40 mijë euro të cilat kanë përfunduar në atë llogarinë që Nicolini e ka përdorur për punët e tij personale, pra të padeklaruaru asnjëherë as në Shqipëri dhe as në Itali. Përveç të tjerëve që i ka mashtruar duke i derdhur gjithnjë lekët te ajo llogaria që ai e mban të hapur si një llogari jashtë vendit", - shkruan Marco N. në email. Një tjetër fakt interesant zbulohet nga Marco N. në email-in e datës 1 Gusht 2012. Në këtë email ai ndër të tjera përmend dhe faktin se në Itali Massimiliano Nicolini u deklaronte të gjithëve se kompaninë e tij shqiptare "BIC" e kishte në bashkëpunim me shtetin shqiptar. Kjo është një tjetër e dhënë e rëndësishme e cila nëse rezulton e vërtetë flet për një shpërdorim dhe mashtrim spektakolar nga ana e Nicolinit me simbolet dhe emrin e shtetit shqiptar.

E-mail-et e përkthyer

Email i datës 2 Gusht 2012
 Dërguesi: Marco N.

"Çkemi..., Kompania BIC(Balcan Investments Company) në Itali ka një seli të sajën në Sosano (Vicenza) në rrugën "Via del Rio 25", nuk ka numër TVSH-je por ka numër NIPT-i 98150030173. Kjo kompani ka aksione në disa shoqëri italiane dhe këto gjëra nuk figurojnë aty(në Shqipëri) nga sa di unë, kështuqë nëse i shkruan Ambasadës Italiane mjaft të shikojnë këto pjesëmarrjet në shoqëri të tjera të Massimiliano Nicolinit duke ju referuar dhe BIC(Balcan Investments Company)e cila rezulton në Itali e regjistruar me NIPT. Ndërsa llogaria bankare që ka operuar jashtë vendit kjo kompani është në "Banca Fridularia di Este" më duket, megjithatë është e sigurt që është në provincën e Vicenza-s. Nesër në mëngjes do të mund të siguroj diçka ose ndonjë të dhënë më shumë. Ki parasysh që Ivan Manzoni, ai biznesmeni i spektakleve ujore i kompanisë "Uateruall" i ka paguar 40 mijë euro të cilat kanë përfunduar në atë llogarinë që Nicolini e ka përdorur për punët e tij personale, pra të padeklaruaru asnjëherë as në Shqipëri dhe as në Itali. Përveç të tjerëve që i ka mashtruar duke i derdhur gjithnjë lekët te ajo llogaria që ai e mban të hapur si një llogari jashtë vendit. Prit mos e deklaroi tani këtë punën e llogarisë sa të marr edhe unë ca të dhëna më konkrete".

Email i datës 1 Gusht 2012
 Dërguesi Marco N.

Ai në Itali ka deklaruar se është konsull i Shqipërisë dhe ky lajm është publikuar edhe aty. Po në Shqipëri nëse dikush thotë që është dikush që nuk është në të vërtetë arrestohet edhe pot ë jetë shtetas I huaj, po ai ç'ne nuk arrestohet?. Nuk njeh ndonjë gazetar që të pyesë publikisht se si ka mundësi që ky bredh I getë dhe askush nuk i thotë gjë? Edhe pse ai ka bërë deklaratë të rreme, në Itali, e ka bërë duke denigruar Shqipërinë, kështuqë duhet ta arrestojnë për përfshirjen e shtetit shqiptar në mashtrimet e tij. Në Itali, siç dhe ti e di mirë, thonte që BIC(Balcan Investments Company) dhe AIC(Albanian Investments Company) ishin kompani ku një pjesë të aksioneve i kishte shtetit shqiptar. Tani në Itali po zhvillohet një tjetër process ndaj tij sërish për vjedhje nëpërmjet falimentimit ku është përfshirë edhe Nirvano dhe avash avash e presin të tjera procese gjyqësore.....Të falenderoj nga zemra, përqafime, për çdo gjë që të kesh më konsidero si vëllanë tënd. Marco.



Reagimi i Berishës: Nuk e njoh grevën, është politike

Vetëm një orë përpara se të mbyllej greva e urisë, kryeministri Berisha ka deklaruar se nuk do të hyjë në negociata me ish të përndjekurit për kërkesat që kanë. Për kryeministrin Berisha greva është politike dhe nuk ka të bëjë aspak me interesat e të përndjekurve politikë duke lënë të nënkuptohet se nuk do të negociojë. "Një vend i lirë e pluralist

respekton protestën paqësore të të gjitha formave. Kjo është grevë nuk ka të bëjë aspak me interesat e të përndjekurve politikë, por interesat për pushtet të një partie të caktuar. Zgjedhjet do të vijnë e shqiptarët do të vendosin për partinë që duan. Sa i takon standardit të PD-së në pushtet për martirët e gjallë të fjalës së lirë ai është standardi më i lartë i ish

evropës komuniste. Standardi përveç kompenzimit 18.6 dollarë për ditën e vuajtjes së dënimit. Janë lidhur 21 mijë pensione. 2200 apartamente. Ata që janë në grevë për qëllime politike, nga këto forma kanë përfutur së bashku 900 mijë dollarë. Përndryshe respektojmë çdo formë proteste paqësore"- ka deklaruar dje kryeministri Berisha.

Afrim Biturku: S'heqim dorë nga kauza jonë, sërish protesta

Ish të burgosurit, arsyet që i nxorën nga greva e urisë

Vendimi pas deklaratës së Fyle, çështja u ndërkombëtarizua



KRONOLOGJI
■ 22 shtator nisi greva e urisë së ish të burgosurve politikë
■ 8 tetor Gjergj Ndreca tenton të vetëdijet
■ 10 tetor Lirak Bejko i vë flakën vetes
■ 10 tetor blindohet greva, drejtuesit e policisë dërgojnë 60 uniforma blu për të ruajtur grevistët nga ndonjë tentativë tjetër vetëfijimi
■ 11 tetor Gania Aliaj, një ish i përndjekur politik tenton vetëdijegjen para çadrave, por dështon
■ 12 tetor një përfaqësi prej 3 grevistësh zhvillojnë një takim me presidentin Nishani
■ 18 tetor arrestohet koordinatori i grevës, Asllan Patrioti
■ 19 tetor policia u heq grevistëve çajin, sheqerin dhe trisolin
■ 21 tetor "Avokati i Popullit" kërkon nisjen e hetimeve për heqjen e ilaçeve, policia akuzon "Avokatin" se u dërgon ushqime në çadër
■ 22 tetor grevistët deklarojnë mbylljen e grevës
■ Që nga dita e parë dhe deri sa u mbyll greva, kryeministri Berisha jo vetëm nuk e ka njohur atë, por madje i ka akuzuar grevistët se po përdoren politikisht nga PS

TIRANE
ESMERALDA KETA

vijon nga faqja 1

...Vetëm pak minuta më vonë, ka ardhur edhe qëndrimi publik i grevistëve për të lënë grevën, ide të cilën ata në fakt kishin ditë që e mendonin. Ndërkohë që tjetër element që i shtyu grevistët të merrnin vendimin për t'i dhënë fund ngujimit të tyre një muaj, ishte fakti se ata ishin të kënaqur që kjo grevë ia kishte arritur qëllimit. Kauza e tyre ishte ndërkombëtarizuar tashmë, dhe për të kishin reaguar që nga OSBE-ja, e deri tek SHBA, BE, Gjermania, thuajse të gjithë. Ndërkohë që një tjetër arsye, e cila i ka shtyrë grevistët të marrin këtë vendim, duket se ka qenë edhe fakti që ata e dinin shumë mirë se kryeministri Berisha, nën presion, nuk do të ndërmerre asnjë nisim për të demshpërlim, ndërsa shpresojnë se tashmë, duke hequr dorë nga presioni, kreu i qeverisë edhe mund të lëshojë diçka. Burime nga qeveria thanë se njerëz të kryeministrit kanë premtuar se për të demshpër-



Afrim Biturku

blimin e tyre do të merret një fond nga pagesa prej parave të privatizimit të kompanisë së naftës, Albpetrol.

Gjithashtu, një tjetër arsye se përse vendosën të lin grevën është edhe fakti se ata rrezikonin të përçaheshin. Duke qenë se kishin ngelur vetëm 6 persona dhe shëndeti i tyre sa vinte e përkeqësohej, sidomos pas heqjes së lëngjeve dhe sheqerit, nëse ndonjëri prej tyre do të vendoste të dilte nga çadra, atëherë greva e tyre kishte marrë fund automatikisht, duke bërë që ajo të dështonte. Një tjetër arsye se përse 6 grevistët e urisë ven-

KËRKESAT E GREVISTËVE
■ Të zhdëmtohen totalisht të burgosurit politikë duke iu logaritur inflacionin 30% që është vlerësuar leku që nga 2007 deri më tani
■ Të merren në mbrojtje sociale ata që kanë mbetur vetëm
■ Të strehohen të burgosurit politikë
■ Ata që janë gjallë t'u akordohet pension sipas ligjit 7703 dt 11.5.93, neni 5 me procedurë të përshpejtuar dhe të drejtpërdrejtë
■ Trajtimi mjekësor të jetë falas për të burgosurit politikë
■ Ligjërimi në Parlament i konventës 12 i Këshillit të Evropës për hapjen e dosjeve
■ Të hapen dosjet e vonuara të të burgosurve politikë që nuk kanë marrë asnjë kësht si dhe të hiqen nga parlamenti nenet e terrorit për të burgosurit politikë që janë dënuar në revoltën e Spaçit 73 dhe 84
■ Të punësohen të burgosurit politikë

dosën t'i jepnin dje fund grevës së urisë, ishte edhe fakti se pas 31 ditësh në ngujim ata ndiheshin të lodhur dhe në një situatë tejet të vështirë e pa rrugëdalje.

GREVISTËT

Nëse do ta vazhdonim edhe sot grevën e urisë, së paku Ramazan Spahia, nuk do t'ia kish të dalë". Kështu shprehet për "Shqiptarja.com", Afrim Biturku, njëri prej 6 grevistëve të urisë që vendosën mesditën e djeshme t'i japin fund ngujimit një muaj. Sipas tij, jeta është më e shenjtë se sa indiferenca e qeverisë, ndaj, shprehet ai, në vendosim të jetojmë dhe të luftojmë për kërkesat tona. "Një nga arsyet që na çoi drejt vendimit për të mbyllur grevën ishte gjendja e rënduar e dy prej tyre, sidomos e Ramazan Spahisë dhe Vllasi Koçit. Pas heqjes së lëngjeve dhe sheqerit gjendja shëndetësore u rëndua së tepërmi. Nëse ne nuk do ta kishim mbyllur grevën gjatë ditës së sotme, Ramazan Spahinë nesër (sot) nuk do e kishim më mes nesh. Dhe në këtë situatë në menduam se jeta e secilit prej nesh është më e vlefshme ndaj çdo lloj sakrifice. Pikërisht për këtë arsye, vendosëm të jetojmë dhe të vazhdojmë më vonë sërish protestën tonë, pasi ne nuk heqim dorë për asnjë arsye nga kërkesat tona. Por kau-

Zëdhënisi i Fyle

Peter Stano: Negociata prioritet, të nisë dialogu

Vetëm pak para se greva e urisë të shpallej e mbyllur ka reaguar Komisioni Evropian, i cili e ka quajtur shqetësuese situatën aktuale të grevistëve dhe i ka bërë thirrje qeverisë që të dialogojë me ta. Sipas zëdhënësit të komisionerit Fyle, Peter Stano, negociimi i qeverisë me ish të përndjekurit politik është prioritet. "Ne jemi duke i ndjekur zhvillimet dhe jemi të shqetësuar për situatën e ish të përndjekurve në grevën e urisë. Kjo situatë duhet të jetë një prioritet. Kur flasim për shqetësimin që këta ish të përndjekur ngrënë, ne inkurajojmë dialogun për këtë çështje, dialog me autoriteteve dhe shoqërisë civile. Ky dialog duhet të jetë brenda kuadrit ligjor dhe legjislativ përkatës", ka deklaruar dje Peter Stano, zëdhënisi i komisionerit Fyle. Ai rekomandon që situata të zgjidhet brenda



Peter Stano

kuadrit ligjor institucional. Duket se reagimi i Bashkimit Evropian u ka dhënë shpresa ish të përndjekurve se kanë mundësi që të zgjidhen në rrugë ligjore situata e tyre. Ndërsa pamjet e djegies së dy prej ish të përndjekurve bënë xhiron e botës, duke zënë vend në faqet e shtypit më të rëndësishëm ndërkombëtar

ARSYET E DALJES NGA GREVA

- 1 Ishin të kënaqur që kauza e tyre u ndërkombëtarizua dhe u fol nga të gjithë, nga OSBE, SHBA apo BE.
- 2 E ditën se Berisha, nën presion nuk do të paguante asgjë, ndërsa pa presion ai do të paguajë, siç kanë premtuar qeveritarët, nga fondet e shitjes së Albpetrolit.
- 3 Rrezikonin të përçaheshin, sepse nëse dilte edhe njëri, protesta do të dështonte.
- 4 Ishin të lodhur dhe të dërmuar nga greva e urisë dhe pa rrugëdalje.

za jonë nuk merr fund këtu. Ne do të nisim sërish protesta, dhe nëse nuk ka reagim nga qeveria, do të ketë greva urie në disa rrethet njëkohësisht", - na shpjegon Afrim Biturku. Ndërkohë që koordinatori i grevës së urisë, Skënder Tufa thotë se vendimi u mor nga grevistët dhe ai e respekton atë që vendosën grevistët që janë brenda çadërës në ngujim. "Vendimin e morën grevistët. Unë jam koordinatori. Lodhja e tyre, shëndeti, terrori psikologjik ishte tej mase i rëndë. Prandaj vendosën ta ndërpresin grevën, por kauza nuk ndalon me kaq. Kjo është një betejë, jo luftë e humbur. Madje ne ia arritëm qëllimit. Opinioni ndërkombëtar u sensibilizua. Ne na u mohua çdo e drejtë. U trajtuam në mënyrë më barbare dhe shteti i sotëm është diktatorial", - ka deklaruar koordinatori i grevës, Skënder Tufa.



**Partia Demokratike:
Dëmspërblimi do të
përfundojë më 2017**

Partia demokratike ka reaguar sërish dje në lidhje me grevën e urisë. Sipas zëdhënësës së PD-së, Silvii Bardhi, dëmspërblimi do të përfundojë më 2017. "Janë vendosur tarifrat prej 18.6 dollarë për ditë të vuajtjes së dënimit, sipas ligjit dëmspërblimi duhet të përfundojë brenda vitit 2017. Janë vendosur pensione shtetërore në çdo rast në shumën e

pensionit mesatar shtetëror e sipër duke llogaritur për efekt pensioni 1 vit burg të barabartë me dy vite pune shumë të rënda (jo në bujqësi pasi dihet se puna në bujqësi shpërblehej shumë më pak). Pensionet nuk llogariten në shumën e dëmspërblimit sipas tarifës 18.6 dollarë ditën e burgut. Janë vendosur pensione familjare për të gjithë personat në moshë

nën 25 vjeç ose mbi 60 vjeç që kanë qenë në ngarkim të personave të pushkuar ose që kanë vdekur në burgje dhe janë paguar detyrimet nga data e pushkatimit apo vdekjes në burg të kryefamiljarit e në vazhdim. Janë lidhur pensione invaliditeti për të gjithë personat e burgosur për qëllime politike në spitale psikiatrike", - sqaroi Bardhi.



Në foto: Gjergj Ndreca dhe Lirak Bejko në momentin ku i kanë vënë zjarrin vetes

REPORTAZH/ Çfarë ndodhte dje pas mbylljes së grevës

Greva, dyshekët u falen romëve

Perikli Shqevi mbledh nga oborri sendet e tij

■ ■ ■ TIRANE

BRUNILDA GOROVELLI

Vetëm pak minuta pasi greva e urisë u deklarua e mbyllur, çadra e grevës është zhdukur thuajse plotësisht. Romët kanë mbrirë menjëherë pas daljes së lajmit, me karrocet e tyre, duke ngarkuar çdo gjë që kishin lënë ish të burgosurit politikë në këtë qadër.

Menjëherë pas deklarimit së bërë nga grevistët rreth orës 14:00 për t'i dhënë fund ngujimit, është boshatisur edhe rrugica të "Komuna e Parisit", ku edhe që prej një muaji zhvillohej greva e urisë e ish të përndjekurve politikë. Pas orës 14:00, në atë lagje shihje veç dy policë, të cilët kanë ruajtur për ditë të tëra nën masa të rrepta sigurie këtë zonë, kanë lënë qadrën e urisë dhe janë rikthyer pranë vendit të tyre të punës. Brenda pak minutash është zhdukur çadra edhe ato pak dyshekë që ish të dënuarit politikë i përdorën për gjatë muajit të ngujimit. Karrocet e romëve kanë mbrirur menjëherë tek vendi ku po mbahej protesta dhe në të janë ngarkuar ata dyshekë që ishin lagur nga shiu si dhe sende të tjera, si plasmasët apo kartonët që kanë përdorur ish të burgosurit politikë në këtë grevë. Ndërsa dyshekët e tjerë janë sistemuar në shtëpinë e Shqevi që është ngjitur me vendin ku u zhvillua greva e urisë. Ndërkohë që në vendin ku u zhvillua greva e urisë, ndodhej edhe një ish grevist, Xhemal Zhuri, që po merrej me pastrimin e vendit, ndërsa Perikli Shqevi menaxhonte situatën që nga oborri i shtëpisë së tij, pasi është ende në arrest shtëpie.



Shqevi

Ai është akoma në arrest shtëpie, por sipas tij, do të dalë në gjyq javës që vjen së bashku me Gjergj Ndreçën. Perikli Shqevi akuzohet se i vuri flakën shokut të tij Gjergj Ndreca



Në foto: Romët duke mbledhur dyshekët tek çadra e grevës së urisë së ish-të përndjekurve

tretërve Perikli Shqevi u mundua të merrte në oborrin e tij disa nga mjettet që i kishte vënë në dispozicion të grevës, siç ishte një minibufe, disa karrige, një tavolinë apo edhe jastëkë. Ai na tregon se këto sende i kishte marrë nga shtëpia e tij për t'i vendosur te

çadra ku u zhvillua për një muaj me radhë greva e urisë, dhe tashmë po i merrte sërish në shtëpinë e tij. Pyetur nga "Shqiptarja.com" se si u arriti në një vendim kaq të paparashikuar nga të gjashtë ish të dënuarit politik, ai na shpjegon se kështu e tyre tani ishte kombëtare dhe ndërkombe-tare, kjo nëpërmjet mediave dhe ambasadorëve të huaj sidomos të SHBA-së. "Mbi të gjitha shëndeti i tyre ishte arsyeja kryesore pasi Ramazan Spahiu dhe Lavdosha Beqo ishin më të mosuar dhe gjendja e tyre ishte shumë e rëndë, nuk mund t'i mbanim dhe të sakrifkoheshin edhe ata. Por duke qenë se ne çështjen tonë e bëmë të njohur ndërkombëtarisht edhe kombëtarisht shpresojmë të zgjidhet duke negociuar me kryeministrin dhe në rrugë juridike. Tani për tani nuk besoj të ketë një grevë të dytë"- thotë Perikli Shqevi ish i dënuar politik. Ndërsa sa i përket çështjes së tij, Perikliu shprehet është akoma në arrest shtëpie dhe pret që të bëjë gjyqin bashkë me Gjergj Ndreçën. "Unë jam akoma në arrest shtëpie. Po pres që nga java që vjen të bëjmë gjyqin bashkë me Gjergjin"- thotë duke sistemuar sendet në oborrin e shtëpisë Perikli Shqevi.

Deklarata

Agim Kollçaku: Do vetëdigjem para parlamentit



Agim Kollçaku

Pas daljes së tij nga greva ditën e dielë, Agim Kollçaku ka deklaruar se do të vetëdigjem nëse nuk lejohet të futet në qadër. Ndërsa dje greva është deklaruar e mbyllur nga bashkëvuajtësit e tij, ne kontaktuam për të verifikuar edhe një herë se çfarë do të bëhej më deklaratinë e tij pasi ishte në pritje të ngjarjeve që do të ndodhnin në qadër. Ai për "Shqiptarja.com" shprehet se është tejet i vendosur të bëjë një akt të tillë nëse nuk ka realizim të kërkesave dhe nëse nuk ka negociata me kryeministrin, Sali Berisha. "Unë sigurisht që i përmbahem deri në fund deklarimit sime, por duke qenë se jam në gjendje shëndetësore jo të mirë, sapo dola nga spitali, pasi u vizitova nga zemra dhe mora disa ilaçe, kam nevojë për pak qetësi dhe të bisedoj me të gjithë shokët e mi për të vendosur se kur do të bëhet kjo gjë dhe se a u realizuan kërkesat tona"-thotë Agim Kollçaku pas mbylljes së grevës. Agim Kollçaku tregon për "Shqiptarja.com" paraditen e djeshme se si kishte ndodhur ngjarja e ditës së dielë kur ai është kthyer nga spitali QSUT-së. Ai shprehet se pasi e kishin dërguar menjëherë në spital, kishte dalë prej tij me dëshirën e tij dhe se ishte ndaluar nga policët që rretho-

nin grevën për t'u rikthyer sërish në qadër. "Isha në gjendje shëndetësore shumë të rëndë nga zemra. Dola nga spitali me dëshirën time dhe isha me vendim nga Ministri e Shëndetësisë, Vangjel Tavo, për të qenë pjesë e grevës, por kur erdha këtu vepruan edhe me mua njësoj si me të tjerët duke mos më lënë që të futem në grevë përsëri. "Kemi urdhër nga lart më thanë". Unë them që do të vetëdigjem para parlamentit, pres që të përfundojë dialogu i shokëve dhe nëse nuk ka dialog, ata kanë bërë mend të vdesin aty. Unë do ta bëjë patjetër por kjo varet se sa do të zgjasin greva e shokëve në qadër- thotë për "Shqiptarja.com" Agim Kollçaku. Ndërkohë na tregon se e shfaqja i thotë që të heqë dorë nga akti i vetëflimit se nuk do të vdesim pa bukë. "Por më mirë kështu se sa pa dinjtet, më mirë të vdes se sa gjallë"-thotë në tej Kollçaku.

SPASTRIMI

Pas heqjes së të gjitha tendave dhe të gjithë sh-



KABINETI SALAJ

APARATE DËGJIMI

Mbi bazën e një experience 10-vjecare në fushën e vendosjes së APARATEVE të dëgjimit kabineti "SALAJ" ju vjen në ndihmë në këto shërbime:

- Matjen e dëgjimit (audiogram) FALAS.
- Marjen e masës si dhe përgatitjen e saj (silikon apo akrilike) në kohë rekord brenda dy ditëve.
- Përcaktimin dhe programimin e aparatit sipas shkallës së dëgjimit.
- Shërbime (servis) për të gjitha tipet e aparateve.

Adresa: Pallatet e Shallvareve, Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit, përballë Taiwan Nd. 24, Shk. 4, Ap.5 - Tiranë
Tel: +355 4 2262 304 / **Mob:** 068 23 800 95
E-mail: info@salajakustik.com
Website: www.salajakustik.com



Ministri i Jashtëm serb, i përfolur për pastrim parash në Qipro

Janë tre fakte që përkohë me vizitën e ministrit të Jashtëm serb në Tiranë, Ivan Mrkiç, që u detyrua të dilte nga aeroporti i Rinasit nën masa të rrepta sigurie pas protestës së AK. Ai vjen në Tiranë në ditën kur mësohet se përfundimisht qeveria shqiptare anulon tenderin për interkonjeksionin Shqipëri-Kosovë, duke e lënë sërish të lirë Serbinë të kontrollojë energjinë në Kosovë. Por ai

vjen në Tiranë në ditën kur të përndjekurit politikë deklaruan mbylljen e një greve urie, duke u shprehur se Berisha pranon të takojë një ministër serb dhe s'guxon të takohet me shtetasit e vendit të tij që po vetëflijoheshin. Ndërkohë që Mrkiç është i njohur për publikun në Serbi vetëm për diçka: kur ishte ambasador në Qipro, ishte përfolur se ka ndihmuar në fshehjen e parave të zhdukura nga bankat jugosllave

gjatë viteve '90, por edhe për pastrim parash. Asokohe në pushtet ishte Slllobodan Milosheviçi kasapi i Ballkanit, i cili transferoi miliona nga Beogradi në drejtim të bankave fantazmë në Qipro. Politika në Tiranë akuzon se ka qenë Damir Fazliç ai që ka negociuar këtë vizitë Mrkiç për të ardhur në Tiranë, por sërish dihet shumë pak për qëllimet e kësaj vizite dhe për axhendën.

Kreu i diplomacisë serbe, sot takim me Berishën dhe Panaritin

Vizitë mister e Mrkiç në Tiranë, s'ka ftesë

Mbrëmë në Rogner, takim dhe me minoritetin serb

Lajmi

Shefi i diplomacisë serbe Ivan Mrkiç ka mbërritur në Tiranë ku pritet të takohet sot me ministrin e Jashtëm shqiptar Edmond Panariti dhe kryeministrin Berisha. Vizita e tij dy ditore nuk është zyrtare, ndërkohë që pason pas 8 vitesh vizitën e ish-ministrit Vuk Drashkoviç

■ ■ ■ TIRANË

JAKIN MARENA



Ivan Mrkiç

Protesta

Aleanca Kuq e Zi pritet që ditën e sotme në orën 10.00 të protestojë përpara selisë së Ministrisë së Jashtme shqiptare kundër vizitës së ministrit të Jashtëm serb Mrkiç në Tiranë dhe pritjes që ministri Panariti e kryeministri Berisha po i bëjnë atij.

Vizita e ministrit të Jashtëm serb, Ivan Mrkiç është shoqëruar me mister, me protesta nga AK që e bëri të hynte nga dera e pasme e Rinasit e me habi, për shkak se do të zhvillojë vetëm dy takime, me homologun e tij Panariti dhe kryeministrin Berisha. Ai ka shkelur në orën 14.45 të ditës së djeshme tokën shqiptare për të mbërritur pa u pritur nga homologu i tij Panariti në ambasadën serbe në Tiranë. Kështu, që nga dhjetori e para do të realizuar e para dhe e fundit vizitë zyrtare e një shefi të diplomacisë serbe në Shqipëri, ajo e Vuk Drashkoviç, vizita e djeshme e Mrkiç është e para e këtij lloji pas tetë vitesh, por që gjithsesi mbetet një vizitë jozyrtare. Mësohet se ajo është një vizitë personale e kreut të diplomacisë serbe dhe ka pasur interlokutorë të padukshëm që kanë garantuar mbërritjen e Mrkiç në Tiranë, në kuadër të një turi takimesh në të gjitha vendet e Ballkanit. Burimet zyrtare në Ministrinë e Jashtme saktësojnë se ka qenë një takim i Panaritit me Mrkiç në SHBA, ku shefi i diplomacisë serbe i ka shfaqur dëshirën për të ardhur në një vizitë në Shqipëri, ndonëse nuk ka qenë artikulluar asnjë ftesë zyrtare. Ministri Panariti ka rënë dakord dhe kanë caktuar si datën më të përshtatshme 22 tetorin, ditën e djeshme për ta realizuar këtë vizitë. Pavarësisht se

AK, Protesta në Rinas

Bashkurti: Qeveria të informojë për vizitën e njeriut të Milosheviçit

■ ■ ■ TIRANË

Aleanca KuqeZi zhvilloi një protestë në Aeroportin e Rinasit kundër vizitës së ministrit të Jashtëm të Serbisë, Ivan Mrkiç, duke e bërë atë të dilte nga dera e pasme. Aktivistë të AK u mblodhën në dalje të seksionit "VIP" të aeroportit "Nënë Tereza" me banderola ku shkruhej "Kosova është Shqipëri". Ndërkohë që AK ka shprehur shqetësimin për mbajtjen sekret të vizitës dyditore në Tiranë të shefit të diplomacisë serbe. Lisen Bashkurti, Sekretar për Çështjet Ndërkombëtare në AK tha se shteti shqiptar dhe ata të cilët përgatitën këtë vizitë, duhet të japin përgjigje për terrin informativ që shoqëron këtë vizitë. "Është detyrim i diplomacisë shqiptare të informojë menjëherë opinionin publik. E para për CV e ministrit të Jashtëm serb që është pasues i detashmentit të Milosheviçit, Nikoliçit e të gjithë asaj kaste politike që bëri genocid e krimet



Protesta e AK në Rinas

kundër njerëzimit në Kosovë dhe që nuk e pranojnë këtë opinionialisht. Së dyti duhet të njoftojnë axhendën e këtij takimi, që deri më tani mbahet në konspiracion të plotë dhe së treti të zbardhë rezultatet e këtyre bisedimeve," thotë Bashkurti. Për të cilin shtete të ndryshme europiane janë duke mbajtur një qëndrim të kushëzuar me Serbinë, ndërsa Tirana zyrtare i hap dyert pa mëdyshjen më të vogël.

të gjitha takimet janë përcaktuar për t'u mbajtur pas orës 10.00 të ditës së sotme, në këtë orë me Ministrin Panariti, me të cilin do të ketë takim kokë më kokë e më pas me delega-

cionet zyrtare dhe një konferencë për mediat, si dhe me kryeministrin Berisha, kreu i diplomacisë serbe ka ardhur që ditën e djeshme. Pasi është akomoduar në hotel "Rogner" ai

është takuar me personelin e ambasadës së Serbisë në Tiranë, ku sëbashku dhe me përfaqësues të MPJ shqiptare kanë darkuar sëbashku po në këto ambiente. Ndërkohë që dje, si-

pas agjencisë serbe të lajmeve TANJUG që i referohej burimeve të ministrisë së Jashtme serbe, ministri Mrkiç është takuar dhe me përfaqësuesit e minoritetit serb në Shqipëri, me të cilët ka diskutuar në lidhje me trajtimin e tyre e që do shërbejë dhe si "paketë" në bisedimet me Panaritin dhe Berishën. Mësohet se pala shqiptare do hedhë në tavolinën e këtyre bisedimeve në këtë vizitë jozyrtare kërkesën për firmosjen e 14 marrëveshjeve me qeverinë serbe, të cilat presin vetëm firmën e palës mike. Një ndër më të

rëndësishmet në këto marrëveshje është ajo e njohjes së diplomave të shqiptarëve në Lugjinën e Preshevës, marrëveshje të cilën Serbia e ka nënshkruar me të gjitha vendet e tjera të rajonit e që ka mbetur ende pa u firmosur vetëm me Shqipërinë. Ministri serb, Mrkiç ka thënë se vizita e tij në Tiranë ka një rëndësi të veçantë për ripërtëritjen e marrëdhënieve në rajon. Ish-presidenti Boris Tadiç disa herë është ftuar dhe përkundër konfirmimeve, ai s'ka qenë si president shteti në vizitë zyrtare në Shqipëri.

VIZITA TE REALIZUARA NGA DY VENDET RESPEKTIVE

VIZITA TË KRYEMINISTRAVE SHQIPTARË NË SERBI

■ **Mars 2003**
Kryeministri i Shqipërisë merr pjesë në ceremoninë e varrimit të Zoran Xhinxiç

VIZITA TË MPJ-VE SHQIPTARË NË SERBI

■ **Nëntor 2002**
Ilir Meta, Zv.kryeministër dhe Ministër i Punëve të Jashtme

■ **Korrik 2004**
Kastriot Islami, Ministër i Punëve të Jashtme (vizitë zyrtare)

■ **Maj 2005**
Kastriot Islami, Ministër i Punëve të Jashtme (vizitë zyrtare)

■ **Mars 2010**
Ilir Meta, Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Punëve të Jashtme (vizitë zyrtare)

VIZITA TË MPJ-VE SERBË NË SHQIPËRI

■ **Mars 2002**
Goran Svilanoviç, Ministër i Jashtëm i Serbisë e Malit të Zi (Samiti i SEECP)

■ **Shkurt 2003**
Goran Svilanoviç, Ministër i Jashtëm i Serbisë dhe Malit të Zi (viziton Tiranën në cilësinë e Kryetarit të Radhës së SEECP-së)

■ **Dhjetor 2004**
Vuk Drashkoviç, Ministër i Punëve të Jashtme (vizitë zyrtare)

VIZITA TË TJERA

VIZITA TË ZYRTARËVE SERBË NË SHQIPËRI

■ **4 Mars 2010**
Ivica Daçiç, Zv/Kryeministër dhe Ministër i Brendshëm (me rastin e takimit të 7 të Ministrave të Evropës Juglindore)

■ **29 prill 2011**
Ivica Daçiç, Zv/Kryeministër dhe Ministër i Brendshëm (me rastin e Forumit të MARRI-t, Durrës)

■ **31 maj 2010**
Petar Skundriç, Ministër i Minierave dhe Energjisë

■ **27 gusht 2010**
Tomica Milosavljeviç, Ministër i Shëndetësisë

VIZITA TË ZYRTARËVE SHQIPTARË NË SERBI

■ **25 Janar 2010**
Myqerem Tafaj, Ministër i Arsimit (në kuadër të Konferencës Rejonale për Arsimin)

■ **5-6 korrik 2010**
Petrit Vasili, Ministër i Shëndetësisë (për nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit në fushën e shëndetësisë)



PS, Grupi: Berisha në interpelancë për 100 vjetorin e Pavarësisë

Socialistët kanë vendosur të thërrasin në interpelancë në seancën më të parë që të jetë e mundur kryeministrin Berisha në lidhje me përgatitjet që qeveria shqiptare po bën për festimin e 100 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Në mbledhjen e djeshme të grupit parlamentar të kësaj partie, pa praninë e kreut Edi Rama, është diskutuar në lidhje me seancën e ditës së mërkurë të

Parlamentit, në të cilën do diskutohen një seri ligjesh dhe projektligjesh të paraqitura nga qeveria shqiptare. Shqetësimi kryesor ka qënë bllokimi i fondeve për organizimin e festimeve për festën e pavarësisë, sidomos për bashkinë e Vlorës, e cila përmes kryebashkiakut socialist Shpëtim Gjika ka deklaruar se do të bëjë ç'është e mundur për organizimin e një feste dinjtoze. Nga ana tjetër

shqetësim për deputetet socialistë ka qënë fakti i vendimit për të festuar në Vlorë më 27 nëntor, dhe më 28 nëntor në Tiranë, një akt i papranueshëm për PS. Ndërkohë që nga Berisha do kërkohet të dihet nëse kthimi i eshtrave të ish-mbretit Ahmet Zogu bëhet në përvjetorin e monarkisë apo në 100 vjetorin e Pavarësisë. Ku pritet të bëhet debat në lidhje me këtë element të fundit.

Kryeministri bullgar garanci homologut shqiptar për në BE

Borrissov: Bullgaria do blejë bitumin shqiptar

Berisha: Cilësi më të mirë se në Kanada

Lajmi

Kryeministri bullgar Borissov në takimin me homologun shqiptar Berisha, tekta ka deklaruar mbështetjen për integrimin në BE për Shqipërinë, tha se ka nevojë të blejë tërë bitumin shqiptar. Berisha tha se rëra bituminoze shqiptare ka cilësi më të lartë se ajo kanadeze.

TIRANE

JAKIN MARENA

Kryeministri bullgar Boyko Borissov, gjatë takimit me homologun e tij shqiptar Sali Berisha ka qënë tepër konkret në elementët e bashkëpunimit mes dy vendeve, tekta ka kërkuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë eksportimin e tërë bitumit shqiptar në drejtim të Bullgarisë. Kërkesë që ka marrë mbështetjen e plotë të kryeministrit Berisha, i cili e ka cilësuar rërën bituminoze shqiptare më cilësore se atë kanadeze. Ai tekta ka folur për eksportin e energjisë elektrike përmes Kosovës në Shqipëri dhe mbështetjen në ndërtimin e hidrocentraleve ka bërë dhe kërkesën për bitum. "Unë kam një kërkesë për palën shqiptare: në qoftë se ka mundësi, Shqipëria të eksportojë bitum, një çështje kjo për të cilën u diskutua edhe gjatë bisedimeve midis dy delegacioneve. Ka rrugë në Bullgari që janë ndërtuar para shumë vitesh e janë aq të qëndrueshme dhe aq të mira, në saj të bitumit të mirë shqiptar. Jemi të gatshëm të marrim tërë sasinë që disponon vendi juaj", deklaroi Borissov. Nga ana e tij kreu i qeverisë shqiptare Berisha, ka vlerësuar bashkëpunimin në fushën e energjisë të një rëndësie shumë të madhe dhe parësore për vendin, duke përmendur përpjekjet për të zhvilluar lidhjet e interkonjeksionit me Maqedoninë, Bullgarinë dhe me Kosovën. Por ka folur dhe për kërkesën e kryeministrit bullgar për bitum. "Është e vërtetë që bitumi i Shqipërisë është i cilësisë më të lartë, por, ka një të dhënë tjetër të re shumë pozitive; rërat bituminoze të Shqipërisë janë të cilësisë më të lartë që mund të ekzistojnë, sipas studimeve që kanë bërë institutet shkencore të Milanos. Ato janë shumë më cilësore, sesa rërat kanadeze dhe të çdo vendi



Kombësia

"Unë i përmbahem parimit, që në këtë vend çdo qytetar i tij të deklarojë lirshëm përkatësinë etnike që i përket, dhe që e ndjen vetë. Ky është standarti që ne duhet të respektojmë. Nuk ekziston asnjë loj kufizimi dhe nuk do të ekzistojë për qytetarët që ndjehen dhe kanë një përkatësi të caktuar etnike", tha Berisha.

Berisha me homologun e tij bullgar, Boyko Borissov

tjetër. Ato mjaftojnë për të shtruar të gjitha rrugët e Europës. Unë sot pasdite, në forumin ekonomik dypalësh do të ftoj sipërmarrësit bullgarë që të

vijnë e të investojnë në rërat bituminoze, si një material i shkëlqyer dhe me kosto të ulët të rrugëve", është shprehur Berisha. Duke marrë miratimin e

Borrissov që sipas tij, "me këtë rërë bituminoze dëshirojmë të bëjmë një rrugë shumë më të shkurtër mes dy kryeqyteteve". Deklaratë e mirëpritur nga Ber-

isha. Bullgaria deklaroi votën e saj pro statusit të vendit kandidat në BE për Shqipërinë. Konfirmimin e ka dhënë në mënyrë publike, vetë kryeministri i Bullgarisë, Boyko Borissov, i cili gjatë një konference të përbashkët për mediat me kryeministrin Berisha në Tiranë, tha se shqiptarët mund të shprehin për votën e ndihmën e Bullgarisë.

Divjakë



Edi Rama: Fermerëve, subvencionim

Kreu i opozitës Edi Rama ka udhëtuar drejt Divjakës për të parë nga afër problemet që ndeshen fermerët e kësaj zone. Ai ka "prekur" me dorë atë që quhet stërmundim të fermerëve shqiptarë, të cilët pasi kanë shpenzuar qimet e kokës në fermat e tyre, nuk nxjerrin jo fitime por as shpenzimet e tyre. Pronari i një sere thotë se ka investuar miliona lekë të marra kredi për ta ngritur këtë biznes. Por në vend që të kultivojë domate dhe trançug gjatë stinës së dimrit, destinacionin serës ka marrë një drejtim tjetër. "Nuk kemi mundësi për domate dhe trançug sepse kjo është një sere dimerore, por ne s'kemi nafte. Kam provuar por kam mbetur si peshku pa ujë sepse m'u mbarua solari", thotë pronari i serës. Jo vetëm nafta është problem për këta fermerë. "Janë tre shtylla. E para ujitja dhe kullimi dhe këtu do të bëjmë një investim masiv që ta rimëkëmbim gjithë sistemin, e dyta kostoja që është e pamundur sot që një serë me një investim kaq të rëndësishëm ku vetëm toka ka kushtuar 210 milionë lekë të mbillen lakra. Kjo është shembëlltura e falimentimit jo për fajin tuaj, por për faj të shtetit që e ka braktisur fshatin. Pra ulja e kostonë së prodhimit duke ju mbështetur për naftën dhe inputet dhe e për makinerinë bujqësore. E treta është garantimi i nxjerrjes së produkteve në treg", tha Rama. Për të cilin është shumë i rëndësishëm subvencionin për fermerët shqiptarë.



NJOFTIM

Televizioni "A1Report" kërkon korrespondentë dhe kameramanë për të përforuar rrjetin e gazetarëve në të gjitha qytetet e vendit. Kudo që ti jeton, jashtë Tiranë dhe veçanërisht në qytetet:

- DURRES
- LEZHE
- SHKODER
- LAÇ
- VLORE
- GJIROKASTER
- KUKES
- POGRADEC

Dëshiron të punosh si gazetar?

na shkruaj në adresën: staf.a1report@hotmail.com

POLITIKE

Vasili: Ne vendosim nëse i kemi dyert e hapura për PS, jo ajo

Dy muaj para mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare, Lëvizja Socialiste për Integrim do të përcaktojë rrugën e mundshme në këto zgjedhje. Zëvendës kryetari i LSI, Petrit Vasili, për mediat tha se partia e tij do të përcaktojë gjatë punimeve të konventës zgjedhore të pranverës koalicionet e mundshme me

PD-në, me PS-në, apo të dalë e vetme në zgjedhje. Po ashtu, numri dy i LSI-së, Petrit Vasili komentoj edhe qëndrimin e kreut të PS-së, i cili tha se PS-ja mund t'i fitojë zgjedhjet edhe pa LSI-në, por dera mbetet e hapur për këtë forcë politike. Vasili thotë se duhet të jetë LSI-ja ajo që do të përcaktojë nëse do i mbajë të hapura mundësitë për koalicion zgjedhor. Duke

dhënë në këtë mënyrë dhe përgjigjen e shpejtë në lidhje me debatet në Asambleen e PS, ku Rama tha pak a shumë se llogaritë duhet të bëhen në zgjedhjet e vitit 2013 dhe pa LSI. Vasili ka komentuar dhe procesin zgjedhor në LSI, ku anëtarësia e kësaj force politike rizgjidhi në krye të saj Ilir Metën. Ai tha se zgjedhjet u mbajtën në një proces transparent dhe demokratik.

Flet nënkryetari i partisë: Të hapur për aleancë me PS

Abazi: PAD, gati të largohemi nga koalicioni me PD

"Kongresi i vjeshtës vendos, baza dakord"

Lajmi

Nënkryetari i PAD, Eduart Abazi shprehet se PD nuk ka plotësuar pikat e marrëveshjes bashkëqeverisëse dhe për të një zv.ministër dhe Ceka këshilltar janë pak, pasi partia s'ndjehet në koalicion. Ai tha se baza kërkon largim, dhe kongresi i vjeshtës do vendosë.

TIRANE

JAKIN MARENA

Në një intervistë për gazetën "Shqiptarja.com" nënkryetari i PAD, Eduart Abazi, i cili pas dorëheqjes së Cekës bashkëdrejton partinë me nënkryetarin tjetër Genc Anastasi deri në kongres tha se po shihet mundësia e largimit nga koalicioni me Berishën.

PAD është në koalicion me PD në këtë mandat qeverisës. Sa janë plotësuar pikat e marrëveshjes bashkëqeverisëse...?

Realisht do thoja: Jo ku jemi por si ndjehemi në koalicion. Nëse do jesh pjesë në koalicion duhet të jesh pjesë dhe përgjegjës, detyrave e përfitimëve, ashtu sikurse janë dhe në interes të qytetarëve, që na kanë dhënë besim dhe ne kursesi nuk duhet t'i zhgënjëjmë ata. Përsa më pyetët në mënyrë të drejtëpërdrejtë unë mund të them: Ne s'jemi jashtë koalicionit, por jemi sa për të thënë në koalicion deri në një moment të dytë. Jemi duke mbyllur mbledhjet për zgjedhjen e strukturave e forumeve drejtuese nëpër rrethe, prej nga ku do na vijë fryma se si do të jetë vazhdimi i mëtejshëm i qëndrimit në këtë koalicion, apo i vendimeve të reja të fundit. Asambleja dhe kongresi i Aleancës Demokratike që mbahet në vjeshtën e këtij viti.

Ju po thonë që mund të ikni nga koalicioni me PD...?

Është një alternativë që ka kohë që po diskutohet realisht, sepse problemi nga baza kanë ardhur duke u agruar, shqetësimet e tyre kanë qënë të drejtëpërdrejtë. Ne jemi përpjekur që përmes daljeve publike që kemi bërë, t'i bëjmë prezente koalicionit dhe PD që shqetësimet janë reale. Mbështetësit tanë në bazë e ndjejnë atë, për të mos arritur deri tek përkushtimi dhe largimet nga puna që janë bërë, ku është përdorur një "gjuetë shtrigash" edhe ndaj këshilltarëve të dalë në emër të partisë sonë pas zgjedhjeve të 8 majit të vitit 2011. Ne jemi shumë të kujdesshëm në këtë drejtim, pasi kujdesi ynë është në funksion të faktorizimit në maksimum të vlerave të PAD, që të mos shpërdorojmë besimin e mbështetësve të votuesve tanë. Aq më tepër të mos luajmë me besimin e tyre në raport me partnerët e tjerë në koalicion,



Nënkryetari i PAD Eduart Abazi dhe ish presidenti Neritan Ceka

sido dhe kurdoqofshin ata.

Sistemi zgjedhor e bën të detyrueshëm një koalicion me një parti të madhe. Mund të shihet mundësia e një rikthimi matjas...?

Dy forcat kryesore, si PD e PS dhe drejtuesit e koalicionëve, janë të përgjegjësë pasi pas çdo raundi zgjedhor kanë bërë edhe premtime, kanë bërë lëvizje që do rregullojnë diçka në sistemin zgjedhor të radhës, ku dhe ky i fundit është një zhvillim për partitë e vogla. Ne i kemi bërë prezente qëndrimet tona, jemi shumë të kujdesshëm për të artikuluar qëndrimet tona dhe jemi shumë të kujdesshëm për të artikuluar fjalën e fundit që ju kërkoni: Ne jemi në pritje të qëndrimeve dhe të opinioneve

që na vijnë nga baza, për të qënë përcuesit e frymës që vjen nga ajo. Në qëndrimet dhe ardhjet e derisot me shikojmë që qëndrimi në këtë koalicion është i kontestuar nga pothuajse pjesën më të madhe të tyre. Se si do të jetë koalicioni i ardhshëm, një koalicion që mendohet që është i formuar apo një tjetër koalicion që është në formim e sipër, varet si do jenë format e tjera të ndërtimit të koalicionit edhe për shkak të imponimit që bën sistemi zgjedhor, të cilin dy partitë e mëdha e miratuan pavarësisht kontestimeve tona, ne nuk mund të bëhemi pjesë e kësaj loje. Sepse kam thënë që nëse të gënjën njëherë është faji i tij, hajt dhe herën e dytë mund të mos kesh vëmendje, por herën e tretë është faji yt nëse ti pranon variantin e atij të gënjën sër-

Kongresi

"Jemi duke mbyllur mbledhjet për zgjedhjen e strukturave e forumeve drejtuese nëpër rrethe, prej nga ku do na vijë fryma se si do të jetë vazhdimi i mëtejshëm i qëndrimit në këtë koalicion, apo i vendimeve të reja të fundit, Asambleja dhe kongresi i Aleancës Demokratike që mbahet në vjeshtën e këtij viti"

ish për ta bërë pjesë të programit tënd. Ne s'mund t'i zhgënjëjmë më mbështetësit tanë që kemi në bazë.

Po ju i keni disa poste në koalicion, ish-presidenti Ceka është këshilltar i kryeministrit Berisha, zv.ministri Demeti...?

Kursesi nuk jemi të plotësuar. Nëse ju kujtoni që një këshilltar të kryeministrit siç është rasti i një personaliteti të kulturës si Neritan Ceka është një nder për të, mendoj se është gabim, sepse prania e tij si këshilltar është nder për çdo kryeministër. Përsa i përket pozicionit të një zv.ministri, mund të them se jemi të zhgënjyer pasi për peshën që kemi si parti nuk mund të përmbledhet kontributi në bashkëqeverisje me këto dy poste. Për nuk

janë përmbushur detyrimet ndaj AD. Aq më tepër që dhe me një zv.ministër, tashmë është bërë praktikë pasi janë shtuar shumë sa për të plotësuar oretet e njërit apo tjetrit, jemi të pakënaqur sërish. Sepse bashkëqeverisja duhet të konvertohet në kontributin e votave që ka grumbulluar partia ose në kontributin që ka dhënë ajo në koalicionin që ju thoni që ajo bën pjesë realisht. Në këtë këndvështrim ne themi që jemi të pakënaqur nga koalicioni, aq më tepër nga vlerësimi që na bëhet.

Konkretisht vijojnë problemet...?

Kohët e fundit kanë vijuar problemet, mbështetësit tanë pushohen nga puna e s'gjejnë mbështetje. Kërkesat e herëpashershme që kemi bërë ne, duke iu drejtuar qoftë dhe kryeministrit si drejtues i koalicionit, nuk kemi marrë asnjë përgjigje as në kohën e duhur, jo më që të themi se problemet kanë marrë një zgjidhje. Ndaj ne jemi të zhgënjyer realisht nga qëndrimi në këtë koalicion. Por do të jemi të kujdesshëm për të mos bërë kapërcime që mund të jenë me kosto politike, por do jemi gjithnjë koherent me qëndrimet tona, duke marrë gjithnjë dhe qëndrimin e bazës, që të mos marrim mbi vete përgjegjësitë që nesër mund të na ngarkohen për vendime të nxituara që mund të marrin sot.

Me sa duket po kthehet koalicioni i kahershëm të e majta...?

Mund të them që baza e AD përbehet nga aleancistë. Kjo u tha dhe përmes votës së marrë në zgjedhjet e

"Në zgjedhjet e 8 majit 2011, PAD ka marrë mbi 35 mijë vota dhe mbi 200 këshilltarë bashkiakë dhe komunalë në të gjithë vendin"

8 majit 2011, që s'ishte pak por 35 mijë vota e me mbi 200 këshilltarë bashkiakë dhe komunalë në të gjithë vendin. PAD është një forcë liberale demokratike e qendrës. Ka qënë faktor stabiliteti për të ruajtur dhe ekuilibre në kohë shumë të vështira në të cilat ka qënë vendi, qoftë në qeverisjen e PS qoftë dhe në atë të PD. Në kushte të tilla ne jemi shumë të hapur dhe transparentë. Ju duhet të shikoni sa pahlivanë janë ata që kapërcen nga ektremi i majtë në ektremin e djathtë dhe anasjelltas. Ndërsa ne jemi në qendër, e kemi shumë më të lehtë të mbështetemi pa bërë kapërcime. Në këto kushte mund të them se ne s'paragjykojmë asnjë përsa kohë që themi që gjithë shqiptarët kanë të drejtë të zgjedhin variantin më të mirë, aty ku u bëhet më mirë atyre. Për ne jemi shumë komodë në qendër, dhe kemi një besim reciprok me qendrës dhe bazës për të gjetur një zgjidhje sa më adekuate, që të jetë sa më e qëndrueshme për të mos u paragjykur nesër nga veprimet që do të ndërmarim si rezultat i vendimit që do të na vijë nga drejtuesit në bazë dhe strukturat e partisë deri në kongresin e vjeshtës.

Zv.ministri Demeti:

"Koalicioni po funksionon pa probleme"

Numri dy i ministrisë së Mjedisit, Njëherësh dhe anëtar i kryesisë së Partisë Aleanca Demokratike është shprehur për gazetën se koalicioni qeverisës me PD po funksionon normalisht dha pa probleme. Për të nuk bëhet fjalë për ndonjë largim të mundshëm nga ky koalicion, pavarësisht se thotë që për marrëveshjen parazgjedhore do diskutohet. "Nuk ka pasur asnjë problem në koalicionin bashkëqeverisës mes PAD e PD. Marrëdhëniet janë mëse normale, as me



Arben Demeti

plus as me minus", deklaroi dje Demeti. Njëherësh në lidhje me marrëveshjen parazgjedhore ai ka nënvizuar se "pritë një marrëveshje e re përpara zgjedhjeve parlamentare, për të dalë sëbashku në këtë sfidë elektorale". Ndërkohë ai ka komentuar dhe kongresin e ardhshëm të PAD dhe mundësinë e një largimi nga koalicioni me PD. "Nuk shtrohen probleme të tilla fare, pasi koalicioni funksionon normalisht dhe nuk besoj se pritet ndonjë surprizë në kongres në lidhje me të", tha Demeti.



Çuçi: Të mblidhet KQZ, të mos rrezikojmë për 2013

PS i bën thirrje Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të mos humbasë kohë, por të nisë sa më parë punën për të mos rrezikuar aplikimin për herë të parë të teknologjisë në zgjedhjet e 2013-tës. Eksperti i Partisë Socialiste, Bledar Çuçi, tekta vëren vonesën në konstituimin e tij, thotë se mungesa e eksperiencës së disa prej anëtarëve të këtij institucioni, por edhe dy risitë, ajo e

numërimit elektronik të votave dhe identifikimi i pjesshëm elektronik i votuesve e kthejnë në domosdoshmëri nisjen sa më parë të punës. Duke nënvizuar se dhjetori i 2012-tës është afati maksimal për dekretimin e datës së zgjedhjeve, eksperti i PS-së inkurajon Presidentin Bujar Nishani të mos presë deri në limitet e fundit kohore, por të përcaktojë sa më parë datën e zgjedhjeve. Kodi Zgjedhor

parashikon disa etapa për masat që KQZ-ja duhet të ndërmarë për realizimin e teknologjisë së re informative në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013. Neni 105 i kodit përcakton se jo më vonë se 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, KQZ-ja fillon përgatitjen e projektit për ngritjen e sistemit të verifikimit dhe regjistrimit të zgjedhësve (SEV) dhe sistemit elektronik të numërimit (SEN).

Intervistë/ Flet anëtari i sapozgjedhur në KQZ, Jani Jani: Ne, pa mandate partiakë

Zgjedhjet 2013, të pa garantuara

Anëtari që përfaqëson PBDNJ: Kryetarja e KQZ, nuk i garanton zgjedhjet në 2013, nevojitet zbatimi i kodit dhe toleranca midis anëtarëve të KQZ. Qëndrimi që do të mbajë në komision

Lajmi

Drejtimi i institucionit të administrimit të zgjedhjeve nga një femër, do të jetë i vështirë sipas anëtarit të propozuar nga PBDNJ, Jani Janit. Ai theksoi se KQZ e re nuk duhet të ndjekë hapet e asaj të mëparshme.

■ ■ ■ TIRANE

ARTEMISA HOXHA

Në një intervistë për Shqiptarja.com, anëtari i KQZ, Jani Jani deklaroi se do të theksojë se parimor në KQZ sipas Janit, do të jetë zbatimi i Kodit Zgjedhor. toja thjesht si karrierë, por edhe si një kontribut i një qytetari të përgjegjshëm që i takon minoritetit etnik grek në Shqipëri. Jani shpalos impresionet dhe të ardhmen e tij në këtë post që do të luajë një rol të rëndësishëm në zgjedhjet e ardhshme.

Ju u votuat nga Parlamenti me shumicë votash për të qenë anëtar në institucionin e administrimit të zgjedhjeve. Si ka qenë për ju ky moment?

Kuptohet që ky ishte një moment i veçantë për mua kur pothuaj gjithë Parlamenti i dha votën propozimit të PBDNJ-së për antarë të KQZ-së, pikësepari duke i njohur PBDNJ-së kontributet e derisotme në politikën shqiptare dhe në zhvillimet demokratike të dy dekadave të fundit, rolin e saj konstruktiv në zhvillimin dhe administrimin e proceseve të ndryshme zgjedhore ndërsa për sa i përket personit tim ky cast ishte tepër emocional, jo vetëm ngaqë mora shumicë votash, por më shumë për arsye të përgjegjësisë që i ngarkohen një anëtar të një institucioni të tillë në kushtet e një serie zgjedhjesh tejet të kontestuar në Shqipëri. Këto zgjedhje si edhe administrimi i tyre nga ana e KQZ-së krijuan imazhin e një institucioni të ndikuar nga politika dhe

Në foto: Jani Jani anëtar i KQZ

jo nga ligji.

Çdo të thotë për ju të qenurit për herë të parë në KQZ dhe cila do të jetë strategjia dhe pozicionimi juaji në këtë institucion?

E thashë edhe më lart. Të qenurit në këtë institucion, ku prirë dhe sidomos në periudhat zgjedhore gjykoresh nga gjithë qytetarët e këtij vendi, të ngarkon me përgjegjësi, jo vetëm në zbatimin e ligjit, por edhe në ndryshimin e imazhit të krijuar nga publiku për këtë institucion. Mendoj që strategjitë nuk janë personale në këto pozicione. Strategjitë dhe qëndrimet duhet të burojnë nga gërma dhe fryma e Kodit Zgjedhor dhe jo nga direktivat partiake. Pavarësisht bindjeve politike, ne qytetarët e këtij vendi duhet të mësohemi të zbatojmë ligjet.

Si e vlerësoni faktin që për herë të parë në kye të KQZ u zgjodh një femër dhe sa garanci jep kjo për një administrim korrekt për zgjedhjet e ardhshme?

Pikësepari e konsideroj pozitiv faktin që KQZ-ja drejtohet nga një grua, por kjo nuk mjafton dhe as nuk mund të jetë garanci për një administrim korrekt të zgjedhjeve të ardhshme. Ga-

Konstituimi

Zgjedhja e Jani Janit me shumicë votash në Parlament

Jani Jani, është anëtari i KQZ i propozuar dhe i zgjedhur në Kuvend nga Partia e Bashkimit për të Drejtat e Njeriut. Ai u votua në Parlament me një shumicë votash nga të dyja palët politike, me plot 127 vota. Ndërkohë që Jani Jani fitoi të drejtën për të qenë anëtar i KQZ përballë kandidatës tjetër të propozuar nga PBDNJ, Spiro Kuro. Jani Jani vjen edhe si përfaqësues i minoritetit grek në vendin tonë. Ndërkohë që vetëm pak ditë më parë, Jani Jani së bashku me 6 anëtarët e tjerë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve bënë betimin në Parlament, nga i hap rrugë mbledhjes së më sëpejt të këtij institucioni. 6 anëtarët e KQZ janë zgjedhur me miratimin dhe konsensusin e opozitës, gjë që nuk ka ndodhur me kryetaren që do të drejtojë këtë institucion, Lefterie Lleshi. Leshi u zgjodh në Parlament vetëm me 71 vota të deputetëve të djathtë. Pritet tashmë që shumë shpejt KQZ e re të bëjë dhe konstituimin e saj si institucioni që do të administrojë zgjedhjet e ardhshme. Kjo KQZ do të zvendësojë KQZ e mëparshme, nga e cila do të zvendësohen anëtarët e PS, kryetarja dhe anëtarit i partisë së vogël parlamentare, PBDNJ. Kurse dy anëtarët e djathtë në KQZ Vera Shtjefni dhe Hysen Osmanaj janë ripropozuar dhe rizgjedhur anëtar në këtë institucion.

rancia për një administrim korrekt të zgjedhjeve të ardhshme është zbatimi me përpikmëri i Kodit Zgjedhor,

toleranca dhe bashkëpunimi konstruktiv i gjithë antarëve të KQZ-së. Nga ana tjetër kërkohet ndryshimi i men-

Jani

E konsideroj pozitiv faktin që KQZ-ja drejtohet nga një grua, por kjo nuk mjafton dhe as nuk mund të jetë garanci për një administrim korrekt të zgjedhjeve të ardhshme. Garancia për një administrim korrekt të zgjedhjeve të ardhshme është toleranca dhe bashkëpunimi konstruktiv i gjithë antarëve të KQZ-së

talitetit partiak dhe të ndryshjeve nga forcat politike. As duhet të arrijmë edhe ne të themi që zgjedhjet u zhvilluan normale dhe jo të përsërisim refrenin se "këto zgjedhje ishin më të mira se të kaluarat"?

Një koment të shkurtër lidhur me emërimin e ish kreut të KQZ-së në pozicionin e tanishëm, pasi nuk është deontologjik. Por do desha të shtoja diçka, pas më shumë se dy dekada demokraci nuk kemi mundur të respektojmë dhe afirmojmë institucionet dhe ligjet. Ka ardhur koha që tu japim më shumë rëndësi institucioneve se sa personave.

Çfarë do të ndryshojë në karrierën tuaj një post i tillë?

Deri para një jave kam qenë pedagog në Universitetin e Gjrokastrës, lektor i gjuhëve klasike. Do vazhdoj brenda mundësive të jap mësim në këtë institucion të rëndësishëm arsimor për jugun si edhe të vazhdoj kualifikimin dhe veprimtarinë shkencore. Zgjedhjen time në këtë pozicion nuk do ta konceptoj thjesht si karrierë, por edhe si një kontribut i një qytetari të përgjegjshëm që i takon minoritetit etnik grek në Shqipëri.

LAJME SHKURT

■ Xhaçka: Fitova pa tërheqjen e kandidatëve të tjera
Kryetarja e zgjedhur Kongresin e së Shtunës për Forumin e Gruas Socialiste, Olta Xhaçka tha se i gjithë procesi i zgjedhjes së saj në krye të këtij forumi ishte transparent. Ajo rrezon zërat se zgjedhja e saj nuk erdhi aspak si rezultat i tërheqjes së dy kandidatëve të tjerë për këtë post. "Në garën për kryetaren e Forumit të Gruas Socialiste nuk pati asnjë tërheqje kandidatësh dhe votimi i hapur u vendos me konsensus" tha Xhaçka. Zgjedhja në krye të forumit për Xhaçkën do të thotë përmbushje e disa sfidave, që nisin me angazhimin e gruas socialiste në fushatën e përcimit derë më derë të programit të socialisteve për një Rilindje Shqiptare. Të shtunën Kongresi i Forumit të Gruas Socialiste me votë unanime zgjodhi në krye të saj deputeten e qarqut të Korçës, Olta Xhaçka.

■ Komisioni i Sigurisë diskuton ligjin e përgjimeve
Komisioni i Sigurisë Kombëtare dhe ai i Veprimtarive Prodhuese pritet që të nisin seancat e sotme shqyrtimin e ligjit për përgjimet e telekomunikimive. Edhe pse parimisht Partia Socialiste është kundër këtij projektligji të sjellë në Kuvend nga ministri i Inovacionit, Genc Pollo, nuk dihet ende nëse deputetët opozitarë kanë përgatitur apo jo amendamente të vetat për përmirësimin e këtij projektligji. Ndërkohë që Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut do të shqyrtojë projektligjin "Për ratifikimin e instrumentit të angazhimit të Republikës së Shqipërisë në shtesën e burimeve të Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillimin (IDA), plotësimi i gjashtëmbëdhjetë".



Balla: Nuk dihet fati i tenderit për firbrat optike

Opozita debatoi dje në Komisionin e Integritimit lidhur me ligjin për komunikimet elektronike, ku ngriti shqetësimin e tenderit kombëtar për fibrat optike dhe shtrirjen e internetit në vend. Ministria e Inovacionit deklaroi se nuk ka asnjë kontratë të lidhur me ndonjë firmë për ndërtimin e rrjeteve bazë në Shqipëri për internetin. Deputeti socialist, Taulant Balla pyeti lidhur me fatin e tenderit

kombëtar për shtririmin e internetit. "Ka dështuar në nëntor të 2011. Një kompani ka çarë të gjitha rrugët kombëtare për shtrirjen e fibrave optike, që nënkupton instalimin e internetit. Ju do të bëni një tender tjetër lidhur me këtë apo do të merrni të mirëqënë ekzistencën e një rrjeti kombëtar të bërë nga një kompani jo me licencë të dhënë nga Ministria juaj, që është autoriteti i autorizuar me ligj apo sipas të dhënave nga një leje e

dhënë nga Ministria e Transporteve?" ngriti shqetësimin Balla. Gjatë diskutimit të ligjit për telekomunikimet elektronike opozita ngriti gjithashtu shqetësimin e kabllove nëndetare për shtririmin e fibrave optike Itali -Shqipëri. "Shtrirja e këtij kabulli nënujor nuk ka filluar ende, kur e keni në plan?", pyeti Balla. Përfaqësuesi i Ministrisë së Inovacionit theksoi se kjo kontratë është deri në janar të 2013.

BE-ja shqetësim për zbatimin në kohë të dixhitalizimit

Ligji në mbështetje të lajmeve qeveritare

Opozita pritet të kundërshtojë kompetencat e AMA

Lajmi


Komisioni i Medias pritet të përfshihet në debate mes palëve lidhur me pr/ligjin e mediave audiovizive, i cili në relacionin e vetë përfshin krijimin e AMA, që do të shërbejë si një autoritet përcaktues dhe kontrollues për lajmet e qeverisë.

TIRANE

ARTEMISA HOXHA

Kuvendi do të nisë diku tjetër e projektligjit "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", projektligji që pritet të ngallë debate mes palëve për nene të veçanta të tij. Një pikë që do të ketë kontestime nga deputetët e majtë është pikërisht ngritja dhe kompetencat që do të marrë Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) i cili do të merret me përcaktimin e një lajmi si të rëndësishëm dhe detyrimin që do të kenë të gjitha mediat për ta transmetuar atë lajm. Ky transmetim do të bëhet pa pagesë nga ana e tyre. "Në projektligjin "Për Mediavizive në Republikën e Shqipërisë", parashikohet që Autoriteti i Mediave Audiovizive në, pas këshillimit publik përcakton ngjarjet me rëndësi të madhe për shoqërinë. AMA vendos kur një ngjarje me rëndësi të madhe duhet të transmetohet direkt, e regjistruar apo në të dyja mënyrat dhe në të gjithë ose një pjesë e territorit të vendit. Në projektligji parashikohet që "një ngjarje me rëndësi" është një ngjarje me rëndësi publike në Republikën e Shqipërisë, në një pjesë të saj ose në vendet e Bashkimit Europian, e organizuar nga një subjekt që ka të drejtën e shtijes së të drejtës së transmetimit për këtë ngjarje. Projektligji synon rregullimin e transmetimit të ngjarjeve me rëndësi në kushtet e një konkurrence të ndershme sipas kërkesave të drektivës", thuhet në relacionin e këtij ligji. Kjo sipas arsyetimit të dhënë në këtë relacion, legjislacioni aktual nuk rregullon çështjet e transmetimit të ngjarjeve që konsiderohen me rëndësi të madhe për publikun, të cilat duhet të transmetohen hapur.

SHQETËSIMI I BE
Në progres raportin e KiE theksohet qartë se lidhur me këtë projektligj eksiston frika



Në foto: Faksimile e projektligjit

për mozbatimin në kohë të procesit të dixhitalizimit në vendin tonë. "Janë mbajtur konsultime me aktorë të ndryshëm dhe partnerët ndërkombëtarë, duke sjellë disa përmirësime në projekt-ligjin për Audiovizuale Shërbimet media, sidomos për sa i përket pavarësia e autoritetit rregullator. Megjithatë, miratimi i këtij ligji në parlament është shtyrë dhe është ende në pritje. Në maj të 2012,

qeveria miratoi një Strategji për dixhitalizimin dhe planin e veprimt, por zbatimin nuk ka filluar ende. Disa frekuenca janë përdorur ilegalisht nga një numër i lartë transmetuesish pa licencë. Sipas strategjisë, afati i fundit për plotësimin e kalimit dixhital është Qershor 2015. Ky afat i ri ngrje shqetësime të mundshme për zbatimin në kohë të procesit të dixhitalizimit", thuhet në këtë progres raport.

Reagon Dalipi

Do përjashtohet kontrolli qeveritar

TIRANE

Deputeti i PS dhe njëherësh anëtar i Komisionit të Medias, Alfred Dalipi në një prononcim për gazetën Shqiptarja.com theksoi se projektligji për mediavizive, për të cilin ka dhënë asistencë BE, KiE dhe OSBE në vetvete përmban një shkllje në kompetencat e një autoriteti tjetër kontrolues (AMA) që do të jetë përkrah qeverisë. "AMA do të jetë autoriteti që do të përcaktojë se cili është lajmi, që në projektligj konsiderohet si i ngjarje e rëndësishme dhe do të jetë po ky autoritet që do ta bëjmë lajmin që më pas do të transmetohet nga

të gjitha mediat me detyrim dhe pa pagesë nga ana e tyre. Edhe pse parimisht në kemi rënë dakort që ky projektligj të miratohet, në nene të veçanta siç është kjo e AMA-së, në do të kemi qëndrimet tona kundër. AMA nuk mund të ketë këtë autoritet. Edhe grupet e interesit që janë marrë me shqyrtimin e këtij projektligji e kanë kundërshtuar një gjë të tillë, pasi AMA nuk mund të ketë kompetencë. Nga ana e opozitës do të përjashtohet mundësia që ky autoritet t'i shërbejë pushtetit", tha Dalipi. Ndër të tjera, ai theksoi se mes palëve do të tentohet për 3 elementë: elementi i garantizimit, pluralizmi si dhe barazia në mediat vizive.



do të përjashtohet mundësia që ky autoritet t'i shërbejë pushtetit", tha Dalipi. Ndër të tjera, ai theksoi se mes palëve do të tentohet për 3 elementë: elementi i garantizimit, pluralizmi si dhe barazia në mediat vizive.

Idrizi

Asnjëherë i pranishëm në komision

Ish deputeti i Partisë Socialiste, Kastriot Islami, ngriti dje në Komisionin e Punëve të Jashtme, shqetësimin se mungesës së vazhdueshme të deputetit dhe kreut të PDIU në këtë komision, Shpëtim Idrizi. Këtë "Si shpjegohet që ky Idrizi nuk vjen fare në komision", pyeti Islami në komision. Këtë shqetësim e ngriti në të njëjtën kohë edhe kryetari i komisionit, Fatos Beja. Ai theksoi se deputeti Idrizi, i cili është anëtar i këtij komisioni, nuk është paraqitur në punimet e këtij komisioni që nga fillimi i sesionit të ri parlamentar. Beja bëri të ditur se lidhur me këtë mungesë, sekretaria e këtij komisioni ka njoftuar deputetin në fjalë nëpërmjet emalive apo dhe personave të tjerë, por nuk ka marrë asnjë përgjigje nga Idrizi. "Vërtetë që shpëtim Idrizi u bë kohë që mungon në komision. Unë kam njoftuar atë vetë duke e marrë në telefon. Po ashtu edhe sekretaria e ka njoftuar, por nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga deputeti Idrizi", theksoi Beja. Ndërkohë që pyetur lidhur me mungesën e deputetit Shpëtim Idrizi në Kuvend dhe mosparaqitjen e tij në mbledhjet e Komisionit të Jashtëm, bëhet e ditur se janë arsye familjare.

Komisioni i Jashtëm

Marrëveshje me BE, ja penalizimi

TIRANE

Komisioni i Punëve të Jashtme miratoi dje projektligjin për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në operacionet e menaxhimit të krizave të Bashkimit Europian, projektligji ky që u debatua nga ana e opozitës. Në veteve ky projektligj është në kontraditë, pasi sipas relacionit të tij Bashkimi Europian vendosë të përjashtojë Shqipërinë nga këto operacione nëse Republika e Shqipërisë ka të ardhura të brendshme bruto më të ulëta se të ndonjë shteti anëtar në BE. "Republika e shqipërisë do të kontribuojë edhe në buxhetin e përbashkët operacional, kontributi do të jetë në proporcion me raportin e të ardhurave të brendshme bruto të Repub-



likës së Shqipërisë dhe vendeve të tjera kontribuese ose në proporcion me raportin e numrit të personelit shqiptar me numrin e përgjithshëm të personelit pjesëmarrës në operacion. BE-ja vendosë të përjashtojë Republikën e Shqipërisë nga kontributimi në buxhetin e përbashkët nëse Republika e Shqipërisë ka të ardhura të brendshme bruto më të ulëta se të ndonjë shteti anëtar në BE", thuhet në projektligj. Ndërkohë që një shqetësim që u ngrit nga deputetja e PS, Artë Dade ishte pikërisht ndryshimi apo jo i kësaj marrëveshjeje nëse Shqipëria do të marrë statusin, pasi në relacion Shqipëria trajtohet si një vend anëtar i BE. Këtë shqetësim e ngriti në komision edhe

kryetari i komisionit, Fatos Beja, i cili kërkoi më shumë shpjegime lidhur me procedimin e lidhjes së këtyre marrëveshjeve duke marrë parasysh se Shqipëria nuk është në familjen europiane. Përfaqësuesi i Ministrisë së Mbrojtjes në Komisionin e Jashtëm bëri të ditur se pjesëmarrja e Shqipërisë në këto operacione për menaxhimin e krizave do të bëhet pas ftesës që vetë Bashkimi Europian do t'i bëjë Shqipërisë. "Republika e Shqipërisë ka të njëjtat të drejta dhe detyrime në lidhje me menaxhimin e përditshëm të operacionit si shtetet anëtare të Bashkimit Europian, që marrin pjesë në operacion, në pajtim me instrumentet ligjor të përcaktuar në marrëveshje", thuhet në relacionin.

Zgjedhjet 2013

Meta- Idrizin takim

për koalicionet

Edhe pak muaj na ndajnë nga fillimi i Efushatës së zgjedhjeve parlamentare dhe partitë kanë filluar diskutimet për koalicionet e ardhshme. Në kuadër të zgjedhjeve, dhe në mbërmbje kryetari i LSI, Ilir Meta takoi privatisht kreun e PDIU, Shpëtim Idrizi. Takimi u mbajt rreth orës 21:40 minuta në lokalin 'Il gusto di mare' që ndodhet tek zona e ish-blokut në Tiranë.

Ndërsa vitin tjetër priten zgjedhjet parlamentare, në arenën politike kanë nisur debatet për koalicionet e ardhshme partike. Burimet konfirmojnë se takimi Meta-Idrizi ka në fokus këtë temë si dhe situatën politike aktuale në vend. Mësohet se temë e diskutimit, mes Metës dhe Idrizit është bërë dhe Rezoluta Çame, për të cilën PDIU ka insistuar prej kohësh. Nuk dihet se çfarë

qëndrimi do të mbajë partia e drejtuar nga Ilir Meta lidhur me këtë çështje që do të shqyrtohet në Parlament. Ndërohet që pak kohë më parë u përfol për një koalicion të mundshëm mes Partisë Socialiste dhe asaj të LSI, por edhe në horizont nuk janë shfaqur nota pozitive për një koalicion të mundshëm mes tyre. Gjithësesi asnjëra nga palët e nuk e ka përjashtuar një mundësi të tillë.

Opozita kundër privatizimit të Lanabregasit nga Ujësjellësi i Tiranës

HEC-i, 15 mln euro për qeverinë

Shalsi: Ky transaksion nuk synon të fuqizojë pushtetin vendor, është thjesht dhe vetëm me paratë që do të marrë një mbushje e një tjetër grope në buxhetin e shtetit

Lajmi

Opozita akuzoi qeverinë se po përdor shitjen e HEC-it të Lanabregasit për të mbushur arkën e saj të zbarasur. Gjithashtu akuzat rënduan se nëpërmjet marrjes së kësaj kredie për blerjen e Lanabregasit, po rritet dhe borxhi publik kombëtar.



Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese

TIRANE

ARTEMISA HOXHA

Opozita votoi kundër marrveshjes për kalimin e hidrocentralit të Lanabregasit në varësi të Ujësjellës kanalizimit në kryeqytet. Deputetët e opozitës përveç votës kundër projektit deklaruan se ky privatizim bëhet vetëm për të mbushur arkën e buxhetit të shtetit. "I gjithë ky transaksion na vjen keq ta themi nuk synon rritjen e efikasitetit apo të efikasitetit të HEC Lanabregas, apo nuk synon të fuqizojë pushtetin vendor, është thjesht dhe vetëm me paratë që do të marrim një mbushje e një tjetër grope në buxhetin e shtetit", deklaroi deputeti i Partisë Socialiste,

Eduard Shalsi. Ndërkohë drejtori juridik i METE Zamir Stefani tha se ligji për transformimin e ndërmarrjes shtetërore në shoqëri tregtare, neni 4, i jep të drejtë ministrit të Ekonomisë të jetë përfaqësuesi i pronës publike dhe pra i legjitimohet të kryejë këtë lloj transaksioni. Sipas tij baza tjetër ligjore e kësaj kontrate është për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, ligji 9901, i ndryshuar. Çka do të thotë se nëpërmjet këtij ligji ke të drejtë, dy shoqëri tregtare, pavarësisht se kush janë përfaqësuesit ligjor të bëjnë transaksione nga dhënia me hua, falje, shitje, koncesion e të gjitha.

HIDROCENTRALI
Shitja e hidrocentralit të

Lanabregasit një shoqëria anonime, ka pjesën më të madhe të aksioneve e ka shtetit është manovra e qeverisë për të siguruar për buxhetin e shtetit 15 milionë euro. Në draftin i miratuar nga Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese është përcaktuar që çmimi total i blerjes së aksioneve të paguhet menjëherë ndërsa të drejtat e blerësit mbi dividendin për çdo aksion në shitje do të maturohen duke filluar nga data e mbylljes. Ndërkohë që privatizimi i hidrocentraleve të Ulzës dhe Shkopetit ka dështuar dy herë radhazi. Hidrocentrali i Lanabregasit ka një kapacitet 5 megavat. Energia e prodhuar nga ky hidrocentral do të përdoret nga ujësjellësi për depot e ujit, stacionet e pompimit.

DEBATET NË KOMISIONIN E VEPRIMTARIVE PRODHUESE

Eduard Shalsi: I gjithë ky transaksion na vjen keq ta themi nuk synon rritjen e efikasitetit apo të efikasitetit të HEC Lanabregas, apo nuk synon të fuqizojë pushtetin vendor, është thjesht dhe vetëm me paratë që do të marrim një mbushje e një tjetër grope në buxhetin e shtetit. Qeveria gjën marifete të mbushë arkën e saj. Në këtë marrëveshje që na keni sjellë bëhet fjalë për transferim 100% të aksioneve nga pushteti qendror në atë vendor, dhe këtë ju po e bëni kundrejt një pagese. Kush e ka përcaktuar çmimin 15 milionë euro? Ajo që na shqetëson ne më tepër është dhe amullia ligjore.

Jemin Gjana: Nuk mund ta mohojmë që shitja e Lanabregasit do të ishte pjesë e mirë për përfitimet në arkën e shtetit. Por kjo duhet parë edhe në disa koncepte të tjera. Ky kalim i Lanabregasit te ujësjellës kanalizimi do të sjellë një përmirësim, duke marrë parasysh këtu investimet e mëdha që janë bërë 3-4 vitet e fundit për këtë shoqëri. Lanabregasi nuk është një humbje nëpërmjet këtij kalimi.

Artan Gaçi: Borxhi kombëtar ka arritur në shifrën 60%. Mesa shoh unë asgjë nuk do të ndryshojë me këtë privatizim siç thoni ju, por do ndihë e njëjta gjë si me shitjen e hotel Dajtit, i cili i kushtoi qeverisë sonë plotë 30 milionë euro për godinën e Bankës së Shqipërisë, por që deri më tani ende nuk është vënë asnjë ditare. Kjo po ashtu i shtohet edhe shitja e Alpetrolit. Tnuk mund të flasim tashmë për Republikë të Shqipërisë, por për një shqipëri të tjetërsuar që po privatizon çdo pronë. Po spitalët do t'i privatizoni?

Selami Xhepa: Kjo është një e drejtë e privatizimit të UKT. Nuk kemi të bëjmë me një marrëveshje të fshehtë.

Zamir Stefani: Transformimin e ndërmarrjes shtetërore në shoqëri tregtare, neni 4, i jep të drejtë ministrit të Ekonomisë të jetë përfaqësuesi i pronës publike dhe pra i legjitimohet të kryejë këtë lloj transaksioni. Baza tjetër ligjore e kësaj kontrate është për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, ligji 9901, i ndryshuar. Nëpërmjet këtij ligji ke të drejtë, dy shoqëri tregtare, pavarësisht se kush janë përfaqësuesit ligjor të bëjnë transaksione nga dhënia me hua, falje, shitje, koncesion e të gjitha.

Jemin Gjana: Nuk është proces privatizimi, por tjetërsimi.

Eduard Shalsi: Shqetësimi ynë ka qenë dhe do të jetë rritja e shumës që do të paguajë pushteti vendor në arkën e qeverisë. Bëhet fjalë për një shumë plotë 15 milion euro. Ky pushtet vendor në vetete është në krizë. E kemi menduar ju këtë gjë?

Zamir Stefani: Këshilli i Ministrave miratoi formulën për privatizimin e këtij hidrocentrali ashtu si ka bërë dhe me hidrocentralët e tjera që janë në proces privatizimi. Qëllimi i transferimit të Lanabregasit është bën që një zgjidhje e tillë t'i japë rritje ekonomike vetë shoqërisë si dhe i shërben interesave publike në zonën e Tiranës. Vlera e shitjes të jetë 15 milion euro.

Artan Gaçi: Pse nuk e bëni nëpërmjet procesit të Privatizimit, ndoshta oferta e shitjes mund të ishte më e lartë ose më e ulët se 15 milion euro", ky për ne është një transferim i dyshimtë. Kjo nuk është gjë tjetër veçse një marrëveshje sa shpëton qeverinë.

Erjon Braçe

“Thaçi-Berisha, koalicion i dhunshëm në pushtet”

TIRANE

Deputeti i Partisë Socialiste, Erjon Braçe reagoi dhe lidhur me protestat e organizuara në Kosovë nga Lëvizja Vetëvendosje, nga ku mbeten të plagosur shumë qytetarë, por dhe deputeti i kësaj lëvizje, Albin Kurti. Duke krahasuar të dy kryeministrat, Hashim Thaçin dhe Salii Berishën, Braçe deklaroi se ka një koalicion të dhunshëm në pushtet. "Në Shqipëri! Në Kosovë! Hashim Thaçi dhe Salii Berisha nuk përballen dot me kundër-



shtarët! U bë e dyta herë që e shoh Hashim Thaçin të rrahë barbarisht kundërshtarët e tij! Pa bërë dallim në njerëz të thjeshtë dhe deputetë! Dhunë e gjak mbi të gjithë! Si është e mundur që kemi dy kryeministra që nuk i duan kundërshtarët, nuk i respektojnë kundërshtarët, nuk dialogojnë me kundërshtarët, nuk përballen me kundërshtarët që mendojnë ndryshe nga ta?", tha Braçe dhe në rrjetin social Façebook. Sipas deputetit socialist kjo nuk është demokraci nga asnjëra qeveri, qoftë aji në Kosovë apo dhe në Shqipëri.

Spartak Ngjela:

Në shoqëri kanë abuzuar të gjitha tiranitë shqiptare

TIRANE

Duke e konsideruar shoqërinë shqiptare si një shoqëri që ka frikë, në një status në Facebook, aleati i Opozitës së Bashkuar Spartak Ngjela thekson se kjo është e metë e kësaj shoqërie që nuk reagon ndaj abuzimeve tiranike në vendin tonë. "Të gjitha shoqëritë inaktive, mos mendoni se janë të tilla nga natyra e tyre indiferente, jo - ato janë që të gjitha të trembura. Në fakt ky është edhe defek-



ti ynë: ne shqiptarët jemi ende një shoqëri që e ka frikën natyrë shoqërore. Këtu kanë abuzuar të gjitha tiranitë shqiptare; dhe, sigurisht që, po këtu, abuzon edhe kjo e sotmja", shkruan Ngjela. Ndër të tjera, ai bën moral se një shoqëri e tillë ka vdekur. "Natyra jonë është veprimi; gjithë pjesa tjetër inaktive është vdekje. Kush nuk e kupton këtë, ka vdekur. Edhe njeriu i trembur është i vdekur. Edhe shoqëritë e trembura janë të vdekura", shkruan Ngjela në statusin e tij në facebook.



Ripaketimi

PROCESI i paketimit, ndryshoheshin arkat dhe data e fishekëve

Poliçani mashtroi zvicerianët me fishekët

Dokumentet e "Fiks Fare" përgënjeshtrojnë drejtorin e uzinës

TIRANE

Lajmi

Para pak ditësh, emisioni Fiks Fare publikoi pamjet nga brenda Kombinatit Mekanik të Poliçanit, ku shihej qartë se fishekët e vjetër nxirreshin nga kutitë metalike, pastroheshin dhe ripaktoheshin për tu bërë gati për shitje. Por drejtori i këtij kombinati, Lulzim Gjoka, tha se këto fishekë nuk shiten. Ai tha se kjo është një praktikë normale pune. Megjithatë Fiks Fare nuk e ka lënë me kaq, por ka zbuluar edhe një korrespondencë mes drejtorit të kombinatit dhe një kompanie zvicerane, e licencuar për tregtimin e armëve. Në këtë korrespondencë, drejtorit të kombinatit të Poliçanit i kërkohet një sasi e madhe

Emisioni investigativ "Fiks Fare" ka publikuar djeh disa dokumente letërkëmbimi mes Uzinës së Poliçanit dhe një kompanie zvicerane e cila kërkon të blejë fishekë në Uzinën e Poliçanit. Ndryshe nga sa pretendon drejtori i Uzinës se fishekët e ripaketuar nuk janë për shitje rezultoi se në fakt uzina shtet fishekë dhe pranon oferta.


fisheskësh kallashnikovi, por jo prodhim rus dhe kinez. Emisioni investigativ ka treguar letrën që ka mbërritur në adresë të drejtuesit të kombinatit të Poliçanit nga kompania zvicerane, në të cilën bëhej kërkesa e sipërpërmendur. "Ju lutemi të na siguronim që fishekët të mos jenë prodhim kinez ose rus", thuhet në letër, e cila hedh poshtë sqarimet e dhëna dy ditë më parë nga vetë drejtori Lulzim Gjoka. Drejtori i Kombinatit Mekan-

ik të Poliçanit, Lulzim Gjoka i ka quajtur absurde pretendimet për shitje të paligjshme të fishekëve në këtë kombinat. Ai sqaron se procesi i ripaketimit të municioneve është një praktikë normale pune që ka të bëjë me seleksionimin e tyre dhe përdorimin nga ushtria. Lidhur me supozimet e nje televizionit "Top Channel" për mungesë të kushteve të sigurisë në këtë kombinat, zoti Gjoka thotë se procesi i demontimit të municioneve

të tepërta në Poliçan kryhet në kushtet e sigurisë maksimale, të vlerësuar së fundmi nga NATO.

PAKETIMI

Në kombinatin mekanik të Poliçanit ripaktohen fishekë kallashnikovi si prodhim i ri, destinacioni i të cilave nuk dihet. Ajo që u mohua nga ministri i Mbrojtjes disa ditë më parë, u vërtetua dje në Fiks Fare. Emisioni "Fiks Fare", për herë të parë solli pamje ekskluzive të ripaketimit të fishekëve në Kombinatit Mekanik të Poliçanit. Investigimi i "Fiks Fare" erdhi pas denoncimit të kryetarit të bashkisë së Poliçanit, Adriatik Zotka, i cili kërkoi ndihmën e këtij emisioni për të treguar atë çka ndodh realisht në Poliçan. Sipas tij, "fishekët që sillen në



Faksimile e kërkesës së kompanisë zvicerane për uzinën e Poliçanit

këtë kombinat për demontim, proces i cili është financuar nga ana e vendeve të NATO-s dhe kryesohet nga Qeveria Amerikane, në vend që të shkatërrohen po ripaktohen dhe përdoren për t'u shitur, pikërisht në ato vende që janë kundër Amerikës". Kryetari i bashkisë së Poliçanit ndihet i pafuqishëm përpara indiferencës së institucioneve shtetërore. Ai për këtë

veprimtari të paligjshme që po kryhet në Kombinatit Mekanik të Poliçanit ka vënë në dijeni Ministrin e Mbrojtjes, kryeministrin, por ka dëshuar. Askush nuk ka reaguuar. Ai kërkon me këmbëngulje që të ngrihet një grup hetimor dhe të hetojë atë që po ndodh në repartet e kombinatit mekanik të Poliçanit, pasi sipas tij, po kryhet i njëjti proces ripaketimi që bëhej edhe në Gërdec.

Ritransmetim Enjte 21:30, te Shtune 16:30, të Dielë 16:30, 21:30

Eksplorimi i Shqipërisë së panjohur

SHTEGTIM

nga

ILIR MATI

Çdo të Enjte
16:30
premierë

A1 REPORT!

Origjina e Lajmit

DIGITALB

TOKESORE
KANALI 48

Do na ndiqni në gjithë Shqipërinë

DIGITALB

SATELITOR
KANALI 51

Do na ndiqni në gjithë Shqipërinë, Maqedoni, Kosovë, Itali, Greqi dhe në pjesën tjetër të Europës

VALË UHF

NË PREFEKTURAT:
TIRANE - DURRES - LEZHE - FIER

ABCOM

KANALI 158

WWW.VATRA.NET



Prof. Dr. Luljeta MINXHOZI
Drejtoresh e Programeve Master UET

MASTER
PROFESIONAL & SHKENCOR



**Universiteti
Europian i
Tiranës**

JEMI KUDO!



Regjistrohu tani! Blv. "Gjergj Fishta", tel: +355 4 242 18 06
cel: +355 68 20 16 616, info@uet.edu.al, www.uet.edu.al



**Mugesia e tregut
zvogëlohet toka e
mbjellë në Kukës**

Mungesa e tregut po kthehet në problem të mpredhtë për fermerët e zonave të thella të Shishtavecit, Zapodit, Topojanit e Bushtricës, në qarkun e Kukësit, ku kultivimi i patates zë vendin kryesor. Mungesa e marketimit ka bërë që aktualisht sipërfaqja e tokës së mbjellë me patate është zvogëluar me mbi 15 për qind. Nga ana tjetër, edhe rendimenti i kësaj

kulture ka pësuar rënie të ndjeshme, nga 230 në 202 kuintal për hektar. Prodhimi i deritanishëm ka arritur në mbi 8.860 tonë, kur një vit më parë në shkallë qarku ishin prodhuar mbi 15 mijë tone dhe vetëm rrethi i Kukësit kishte prodhuar mbi 14 mijë tonë. Thuajse çdo vit, fermerëve të zonës rurale në rrethin e Kukësit u shkon dëm një sasi e konsiderueshme prodhimi.

Ndërsa çmimi i një kilogrami ka shkuar në 50 lekë me pakicë, nga 30 lekë që ishte në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Vitin e kaluar, në zonën e Shishtavecit, nga rreth 12 mijë tonë prodhim, fermerët arritën të shesin vetëm rreth 3.000 tonë. Një fabrikë përpunimi, e ndërtuar që prej 5 viteve, ende nuk është vënë në funksionim.

Qeveria shpërfill paralajmërimet e shtetit gjerman

Linja me Kosovën OST: Tender i dytë

Opozita: Berisha pro vartësisë nga serbët

Lajmi

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) ka njoftuar bankën shtetërore gjermane KfW se, pavarësisht nga paralajmërimet e kësaj të fundit, ka vendosur të përsëritë tenderin për ndërtimin e linjës së interkonjeksionit Shqipëri-Kosovë



Arben Ibroja

Tenderi

Tenderi për linjën e interkonjeksionit Shqipëri-Kosovë në fakt është zhvilluar që në mars të vitit të kaluar, ku fituese rezultoi kompania kroate Dalekovod. Por qeveria shqiptare e bllokoj shpalljen e fituesit



■ ■ ■ **TIRANE**
GENC KONDI

Qeveria shqiptare ka vendosur zyrtarisht të anuloi tenderin për linjën e interkonjeksionit Shqipëri-Kosovë. Operatori i Sistemit të Transmetimit ka njoftuar bankën financuese gjermane KfW - institucion qeveritar - si financuese e projektit, se pala shqiptare ka vendosur anulimin e tenderit dhe ribërjen e tij. Më parë, në një letër të dërguar në shtator, banka gjermane, ndonëse rikëshillonte qeverinë të mos e anulonte tenderin, e kishte paralajmëruar atë që, në rast ritenderimi, duhet t'u përmbajet tre kushteve të panegociueshme për të mos humbur financimin.

Sipas letrës, KfW do të vazhdojë financimin e projektit nëse tenderi i ri do të ndahet në dy pjesë të veçanta, mes Shqipërisë dhe Kosovës. Po kështu, një tjetër kusht i vendosur nga KfW është ruajtja e standardeve të larta teknike si kritere në tender, ndërsa kushti i fundit është ai që pala shqiptare të pranojë rezultatit e tenderit, cilido qoftë ai, për të shmangur një ngërç të dytë.

Pala shqiptare, nga ana e saj, njofton zyrtarisht bankën gjermane për anulimin e tenderit dhe vendimin e ribërjes së tij. Në letër, kreu i OST Arben Ibroja premtos se institucioni që ai drejton do t'i përmbushë tre kushtet e vendosura nga KfW, por nuk garanton se të njëjtën gjë do e bëjë edhe ministria shqiptare e Financave. "Duke mbajtur parasysh

komunikimet me ministrinë e Financave, na lejon t'ju informojmë se kjo ministri nuk mund të përfshihet si palë në procesin e ritenderimit", thuhet në letrën që OST i dërgon bankës gjermane. Ndërkohë, opozita edhe një

herë, me këtë rast, e ka konsideruar si jo të rastësishëm anulimin e tenderit për linjën me Kosovën, duke akuzuar qeverinë se po shkel interesat kombëtare. "Në ditën kur Berisha derdhet lot patriotizmi në Kosovë, ish-bodigardi i tij Ar-

ben Ibroja, drejtor i OST-të në Shqipëri, i kërkonte bankës gjermane anulimin e tenderit për ndërtimin e linjës 400 kilovolt me Shqipërisë dhe Kosovës", deklaroi deputeti socialist Artan Gajë. Sipas tij, zvarritja e ndërtimit të linjës po bëhet me qëllim për të ruajtur monopolin serbe në energji.

"Është shumë e qartë ajo që ne kemi thënë që në fillim: zvarritja dhe anulimi i këtij

tenderi kanë si qëllim të vetëm mosbërjen e kësaj linje, për të mbajtur të varur, si Shqipërinë, po ashtu edhe Kosovën, nga linjat e transmetimit të serbëve, me të cilat aktualisht funksionon gjithë rrjeti energjetik shqiptar", tha Gajë.

Tenderi për linjën në fakt është zhvilluar që në mars të vitit të kaluar, ku fituese rezultoi kompania kroate Dalekovod. Por qeveria shqiptare e bllokoj shpalljen e fituesit,

duke tentuar të zëvendësonte ofertën më të mirë me atë që doli në vend të dytë, për shkak se ofronte një çmim më të ulët. Kjo nuk u pranua nga banka gjermane për shkak të çenimit të standardeve teknike - që vlerësoheshin me jo pak, por tri të katërtat e pikëve - dhe që nga ajo kohë projekti është në ngërç, duke e lënë edhe Kosovën pa këtë linjë tepër të rëndësishme furnizimi.

Licensa

Shtyhet vendimi i Entit Rregullator

■ ■ ■ **TIRANE**

Drejtori juridik i ERE-s, Ed Duard Elezi, deklaroi dje se mbledhja e anëtarëve të bordit të komisionerëve, që do të shqyrtonte kërkesat e operatorëve energjetikë në treg e që ishte planifikuar për t'u zhvilluar dje, është shtyrë në një datë tjetër të pacaktuar. Arsyeja, sipas tij, është përpunimi i të dhënave të shumta dhe gjetja e një zgjidhjeje, që do të minimizonte kostot dhe do të mbrohte konsumatorin. Kjo është hera e tretë që shtyhet mbledhja, që, sipas disa mediave, do të sillte heqjen e licencës për CEZ-in, çka është përgjeshëtruar nga vetë kjo kompani.

CEZ Shpërndarje, OST dhe KESH kanë paraqitur kërkesat e tyre për rishikim të çmimeve të energjisë dhe kostove operative, si edhe



planet përkatëse të investimeve. Për çmimin e energjisë që paguan konsumatori familjar nuk duhet të bëhet rishikim, derisa ERE ka marrë tashmë vendim për ruajtjen e tarifave aktuale deri në fund të vitit 2014. Kompanitë

Shpërndarja

CEZ: Pozicioni ynë në Shqipëri nuk ndryshon

CEZ Shpërndarje mbetet e përkushtuar për të vazhduar misionin e saj në Shqipëri, duke u ofruar një shërbim sa më cilësor klientëve të saj dhe përmirësuar marrëdhëniet e saj me autoritetet vendore dhe komunitetin. Pozicioni i saj në tregun energjetik mbetet i pandryshuar. Ky është reagimi zyrtar i kompanisë çeke të shpërndarjes në ditët që po përflitet më shpesh se kurrë për një ndryshim aksionesh, apo vendime të ERE për heqjen e licencës. Në njoftimin e djeshëm theksohet se kompania ka ndërmarrë një riorganizim të brendshëm, në mënyrë që të ndjekë praktikat më të mira europiane të të bërit biznes në Shqipëri, duke marrë masa disiplinore ndaj shumë punonjësve që kanë abuzuar me klientët dhe me asetet e kompanisë.

kërkojnë një harmonizim më të mirë të kostove për- sa u përket operacioneve të

përbashkëta dhe të tregut energjetik në përgjithësi. Ministri i Financave Rid-

van Bode deklaroi në një nga seancat parlamentare të javës së kaluar se "Enti Rregullator, që është autoriteti i Kuvendit, ka nisur procedurat për heqjen e licencës për CEZ. Nga ana tjetër, qeveria po bën të pamundurën për të garantuar furnizimin e pandërprerë me energji në të gjithë vendin". Sipas Bodes, qeveria po përgatitet prej kohësh, bashkë me Bankën Botërore, për të gjetur një zgjidhje që nuk çonon interesat e qytetarëve. "Kanë ardhur deri tani shtatë misione të Bankës Botërore, vetëm për këtë çështje, në mënyrë që të bëjmë një zgjidhje pa pasoja ekonomike për vendin", shtoi ai.

Por, ERE njoftoi dje se sërish problematikë në sektorin energjetik shqiptar do t'i nënshtrohet raketimit me institucionet ndërkombëtare.



EKONOMI

Bujqësia, qeveria tani nxit krijimin e kooperativave

Zv/ministri i Bujqësisë Ndoc Faslia, i pranishëm në takimin kombëtar me temë "Mbështetje për Fuqizimin e Bujqësisë", që u zhvillua në Vorë, ku morën pjesë fermerë nga i gjithë vendi, u shpreh se "kooperimi është një mundësi e mirë për të rritur prodhimin bujqësor, është alternative për të përmirësuar standardet në prodhim, alternativë e mirë

për të marketuar prodhimin dhe për të siguruar tregje e për të qenë konkurrues". Sipas tij, "qëllimi i takimit është të promovojmë dhe nxisim iniciativat e kooperimit në sektorin bujqësor në Shqipëri. Bujqësia shqiptare karakterizohet përgjithësisht nga fermat e vogla, me sipërfaqe të vogël toke, shpesh herë dhe me nivel të ulët mekanizimi. Ajo

çka vihet re është që dhe nivelet e kreditimit janë të limituara dhe përballë kësaj situatë ka një alternativë të mirë, siç është kooperimi". Kooperativat për më se 20 vjet janë parë si një produkt ekskluziv i shoqërisë komuniste, por duke filluar nga ky vit është miratuar edhe një ligj për kooperimin, me shtytjen edhe të Bashkimit Evropian.

Publikohet raporti për dështimin e nismës qeveritare

KLSH: Si dështoi amnistia fiskale

Borxhi tatimor sa 60% të të ardhurave

■ ■ ■ TIRANE

GENC KONDI

Amnistia fiskale ka qenë një eksperiment i dëshuar. Këtë qendrim zyrtar mban Kontrolli i Lartë i Shtetit, i cili, pas një viti analizë, del me konkluzionin se administrata tatimore nuk punoi sa duhet për të përfutur nga amnistia. Bazuar në të dhënat e raportuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, gjendja në vlerë e detyrimeve debitore në fund të vitit 2011 rezultoi 64,5 miliardë lekë që kanë qenë më 1 janar 2011, me një rritje prej 10.4 përqindësh. Kjo ka ndodhur pavarësisht nga ulja e detyrimeve nga ligji i faljeve, në shumën 10.7 miliardë lekë.

Detyrimet debitore në vlerë më 31 dhjetor 2011 ishin sa 59.5 për qind të vlerës totale të të ardhurave neto të realizuara nga organet e tatimit-taksave në vitin 2011, ndërsa kundrejt Prodhimit të Brendshëm Bruto për vitin 2011, vlera e detyrimeve debitore ishte sa 4.9 për qind të saj, nga 4.73 për qind e PBB-së që zinte në vitin 2010 dhe 4.31 për qind në vitin 2009, thekson raportin i KLSH.

Sipas këtij dokumenti, sa u përket masave të marra për zbatimin e ligjit të faljes nr. 10 418, datë 21/4/2011 "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor", subjektet me borxhe tatimore gjendje në fund të vitit 2010 kanë përfutur dhe u është falur vlera 10.690 milionë lekë, e cila ka ndikuar direkt në uljen e gjendjes debitore. Me gjithë këtë, përsëri gjendja debitore

më 31/12/2011 rezultoi me rritje në vlerën 6 miliardë lekë, nënvizon KLSH. Ky institucion po e monitoron vazhdimisht organin tatimor në këto 2-3 vitet e fundit, duke nxjerrë në pah disa probleme.

Nga analiza e këtyre treguesve rezultoi se, nga afro 43 miliardë lekë të logaritura për t'u falur në zbatim të ligjit të sipërcituar, janë

përfunduar procedurat dhe deri më datën 31.12.2011 është falur vlera në masën 24.9 për qind, e cila u përket 108.928 rasteve.

Sipas llojit të detyrimeve të falura, peshën kryesore e zë falja e gjobave për shumën 4.82 miliardë lekë. Sipas zonave, paraqiten me një nivel shumë të ulët Drejtoria rajonale e Tiranës, ku niveli i faljes rezultoi në masën 8.8

për qind, ndërkohë që kjo ka dhe vlerën më të madhe për t'u falur, e ndjekur nga DRT Durrës dhe Dibrë, përkatësisht 16.5 për qind dhe 21.9 për qind.

Detyrimet e falura pa pagesë për personat fizikë të regjistruar si subjekt i taksës vendore të biznesit të vogël të periudhës deri më datën 31 dhjetor 2010 rezultuan në 1,46 miliardë lekë për 29.715 raste, ose 2.3 për qind e totalit të faljeve.

raste, ose në masën 13.7 për qind të totalit të faljeve.

Detyrimet e falura pa pagesë për individët për periudhën tatimore deri më datën 31 dhjetor 2010 janë 244 milionë lekë për 6.432 raste, ose 2.3 për qind e totalit të faljeve.

Detyrimet e falura pa pagesë të tatimpaguesve, persona juridikë apo fizikë, të regjistruar si subjekt i TVSH-së, që janë të evidentuar në regjistrat e administratave tatimore deri më datën 31 dhjetor 2008, janë në shumën rreth 5 miliardë lekë për 11.566 raste, ose 47.7 për qind e totalit të faljeve.

Në total, detyrimet tatimore që u falën pa pagesë kapin vlerën 6.8 miliardë lekë për 47.713 raste, ose 63.7 për qind të totalit të vlerës së falur.

Ku nuk funksionoi procesi? Sipas KLSH, arsytet janë disa, duke filluar nga mosdërgimi brenda afatit ligjor i të dhënave të borxhit tatimor. Një nga problemet e hasura kanë qenë ndryshimet e herë-pa-herë të strukturave organizative e të punonjësve të ngarkuar me administrimin dhe rikuperimin e borxhit tatimor në qendër dhe në bazë, pa asnjë argumentim ligjor, thekson Kontrolli i Shtetit.



Arkëtimet

Detyrimet e falura për personat fizikë të regjistruar si subjekt i taksës së biznesit të vogël në periudhën deri më datën 31 dhjetor 2010 rezultuan në 1,46 miliardë lekë për 29.715 raste, ose në masën 13.7 për qind të totalit të faljeve. Detyrimet e falura pa pagesë për individët për periudhën tatimore deri më datën 31 dhjetor 2010 janë 244 milionë lekë për 6.432 raste, ose 2.3 për qind e totalit të faljeve.

Faksimile e raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit lidhur me mosrealizimin e objektivave të faljes fiskale nga organet tatimore


Pra, nga këto të dhëna, konstatohet se zbatimi i ligjit për legalizimin dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor, paraqitet në nivele mjaft të ulëta.

Në tërësi, kryesoret të krimit të gjenjes tepër të madhe të detyrimeve debitore dhe nivelit të ulët të mbledhjes së borxhit, si dhe punës së pamjaftueshme për faljen e detyrimeve tatimore në zbatim të ligjit të faljeve, paraqesin:



BANKAT

Kreditimi për individë rënie 4.6 %



Kreditimi i individëve Krezultoi segmenti i tregut bankar më i prekur nga pasojat e krizës ekonomike. Stoku i kredisë për individët është tkurrur krahasuar me vitin 2011 dhe në fund të muajit gusht kishte vlerën e 148.3 miliardë lekëve, me një rënie prej 4.6% kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë.

Sipas bankierëve, njëkohësisht është ulur kërkesa e individëve për kredi dhe janë shtrëguar standardet me të cilat bankat janë të gatshme të kreditojnë individët. Informaliteti në tregun e punës dhe në atë të pasurive të palujtshme nënle faktorë të tjerë, më specifikë, që vështirësojnë kreditimin e individëve. Megjithatë, banka të veçanta kanë ndjekur një rrugë të kundërt, duke hedhur në treg produkte të reja.

Konkurrenca

Vaji vegjetal, çmime artificiale

■ ■ ■ TIRANE

Autoriteti i Konkurrencës njoftoi dhe se, në bazë të një ankese mbi rritjen e çmimit të vajit vegjetal në treg, ka hapur procedurë të hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregutit me shumicë të vajit vegjetal, pasi ka konstatuar se nga aktorët në treg ka pasur kufizim të konkurrencës, duke rritur artificialisht çmimet e këtij produkti. Sjellja e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal, mund të përbëjë kufizim, shtrëmbërim apo pengim të konkurrencës, theksohet në



një njoftim të këtij Autoriteti.

Sipas monitorimit të tregut të bërë nga Autoriteti i Konkurrencës, oferta për vaj vegjetal në tregun shqiptar sigurohet nga importi i vajit të rafinuar dhe nga prodhimi në vend i vajit vegjetal (rafinimi i vajit të papërpunuar të importuar). Nga analiza e të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave mbi importet e vajit vegjetal ka rezultuar se tregu i importit të vajit vegjetal është shumë i përqëndruar dhe kjo ka ardhur në rritje. Treguesit e përqëndrimin në këtë treg janë shumë të lartë për vetë faktin se janë vetëm dy ndërmarrje prodhuese. Nga analiza e çmimeve të paraqit-

ura në ankesë si dhe të rezultuara nga monitorimi u konstatua se: ka marzhe të njëjta të rritjes së çmimit në afate të përafërta kohore; rritja e çmimit njoftohet më përpara në kohë se të ndodhe realisht kjo rritje; është vënë re mungesë oferte për një periudhë të shkurtër dhe furnizimi me çmime të rritura pas kësaj periudhe; rritja e çmimit të vajit vegjetal është reflektuar në tregun e shitjes me pakicë.

Çmimet e shitjes me shumicë nuk kanë reflektuar në kohë zbritjet dhe kanë reaguar menjëherë ndaj rritjes së çmimeve të blerjes në tregjet ndërkombëtare. Periudha nën hetim do të jenë muajt janar-tetor të këtij viti.



Tentuan të trafikonin

143 kg marijaunë

ndalohen 2 persona

Dy persona, një shqiptar dhe një tjetër me shtetësi pakistaneze, u arrestuan paraditen e djeshme në kufirin që lidh Greqinë me Shqipërinë, pasi u kapën me një sasi prej 143 kilogramësh marijuanë. Të arrestuarit janë kapur në zonën e quajtur Plasio, të Igumenicës. Ka rënë në pranga të policisë shqiptari Gëzim.C 28-vjeç, i shpallur në kërkim më parë nga policia

greke për mbajtje dhe trafikim të lëndëve narkotike. I arrestuari i dytë është një shtetas pakistanez Hali Kadi 34-vjeç, i cili dyshohet se ka luajtur vetëm rolin e transportuesit, informon korrespondenti i A1 Report Piro Nase. Sipas të dhënave të policisë droga vinte nga fshati Janjar i komunës Markas në rrethin e Sarandës dhe kishte si destinacion Athinën, ku shitet për

900 euro grami. Gjatë arrestimit dy personave iu sekuestrua edhe një automatik model 156. Policia po heton pasi dyshohet se në këtë trafik të jetë i përfshirë një grup i mirëfilltë trafikantësh të lëndëve narkotike midis dy vendeve fqinje. Materialet hetimore në ngarkim të dy të arrestuarve i kanë kaluar prokurorisë për akuzën e tentativës së trafikut të lëndëve narkotike.

Shantazh dashnorëve të së dashurës për t'i marrë para

Lajmi

Gjykata ka lënë në burg çiftin e mashtruesve, të cilët i bënë shantazh tregtarëve për ti marrë lekë. Spartak Alija përdorte të dashurën e tij për të krijuar lidhje me meshkuj, të cilëve iu prezantohej si shef krimesh.

■ ■ ■ TIRANE

ANXHELA TATO

Lihet në qeli çifti i mashtruesve, të cilët fustnin në kurriz tregtarëve duke i kanosur. Gjykata e Krimeve të Rënda ka vlerësuar si të ligjshëm arrestimin e çiftit, duke caktuar masën e sigurisë arrest me burg. I pandehuri Spartak Alija me të dashurën e tij Dhurata Kananaj krijuan një skemë përfitimi parash me anë të shantazhit. Dhurata Kananaj krijonte lidhje me tregtarë të ndryshëm, të cilët në takimin e dytë njiheshin me Spartak Alijan, i cili prezantohej si shef krimesh. 28-vjeçari kishte ngritur një skemë për zhvatjen e tregtarëve, duke futur në "lojë" edhe të dashurën e tij, Dhurata Kananaj. Kjo e fundit fuste në kurriz "pretë", duke iu vërdallisur tregtarëve për shumë ditë. Pasi pranonte një "kafe" nga tregtarët dhe takoheshin diku, ndërhynte Alija. Me pistoletë në brez, dokument identifikimi të Policisë së Shtetit dhe një radiomarrëse, 28-vjeçari u kërkonte llogarit tregtarëve "përse ngacmonin të dashurën e tij". Madje, ai i shantazhonte se do t'u hapte edhe procedim penal për shfrytëzim prostitucioni. Pas këtyre fjalëve, Dhurata kontaktonte tregtarët duke u thënë se "shefi do 50 mijë lekë ta mbyllë këtë muhabet, pasi në të kundërt do të nisë hetimin". Nga frika e një hetimi, por edhe nga diskreditimi në shoqëri dhe familje, pasi pjesa më e madhe e tregtarëve ishin të martuar, ata pranonin të paguanin një shumë që varionte rreth 50 mijë lekë. Sipas Policisë së Tiranës, kjo skemë ka funksionuar të paktën katër herë, ndërsa vetëm një tregtar ka guxuar ta denoncojë këtë rast. Mbrëmjen e së premtes, Komisarjati i Policisë nr.4 në Tiranë ka arrestuar

Arrest me burg për çiftin mashtrues

Përdorte të dashurën si karrem për tregtarët



Gjykata e Krimeve të Rënda

tuar dy shtetas, të dyshuar për shtrëngim me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie pasurie. "Kallëzimi penal është nga i dëmtuari, shtetasi K. Merko, 35 vjeç, tregtar, i cili akuzonte për gjobëvënie Dhurata Kananajn, 28 vjeçe, banuese në Tiranë, dhe Spartak Alijan,

28 vjeç, lindur dhe banues në Shkodër, i dënuar më parë për 'vjedhje me dhunë' dhe largim i të burgosurit nga vendi i vuajtjes së vendit të dënimit", pohojnë burimet nga policia. Sipas tyre, arrestimi u realizua pasi këtyre shtetasve u është dokumentuar tërësisht

implicimi në shtrëngim për dhënie pasurie të disa tregtarëve. "Nga shtrirja në kohë e një hetimi intensiv, rezultoi se shtetasi Spartak Alija, shfrytëzonte përmes mashtrimit disa tregtarë, duke u prezantuar shtetasen Dhurata Kananaj. Ai u prezantohej tregtarëve si punonjës policie dhe i kërcënonte më pas ata për dhënie pasurie. Pretendonte se do t'u niste një procedim penal ndaj tyre për shfrytëzim prostitucioni ose

kartëmonedha që kapin vlerën e 50 mijë lekëve. Kartëmonedhat janë fotokopjuar dhe u është marrë numri i serisë. Më pas, tregtari, i cili ishte nën presionin e Spartak Alijas, kontaktonte me gjobëvënesin dhe lënë një vend takimi, në rrugën "Jordan Misja" në Tiranë. Të gjitha lëvizjet e denoncuesit dhe gjobëvënesit janë vëzhguar nga strukturat e policisë, ndërsa operacioni është dokumentuar edhe me një përgjim ambiental. Në vendtakim, tregtari i ka dhënë Spartakun një shumë prej 50 mijë lekësh dhe pas një bisede të shkurtër është larguar nga vendngjarja. Pak çaste më vonë, kanë ndërhyrë agjentët e policisë, duke bërë arrestimin e 28-vjeçarit, i cili sapo kishte takuar edhe Dhurata Kananajn. Të dy janë shoqëruar në ambientin e policisë dhe pasi u janë bërë të ditura provat, i arrestuan me akuzën e gjobëvënies. Tashmë, hetimi për këta dy persona do të ndiqet nga Prokuroria e Krimeve të Rënda.

Dhurata Kananaj krijonte lidhje me tregtarë të ndryshëm, të cilët në takimin e dytë njiheshin me Spartak Alijan, i cili prezantohej si shef krimesh dhe i kërcënonte

Policia

Përdhunoit të miturën, pranga njerikut

■ ■ ■ DELVINE

Një 47-vjeçar ka përdhunuar një vajzë të mitur, vetëm 8-vjeçe në fshatin Krane të Delvinës, ndërsa është arrestuar në orët e para të mëngjesit rreth orës 02:00. Sipas informacioneve autori i ngjarjes njihet edhe më parë në zonë për prirje seksuale ndaj të miturve. Ai e ka mashtruar 8-vjeçaren duke e çuar në kasollen e bagëtive, ku edhe e përdhunoi. Abuzuesi ka shfrytëzuar faktin që nëna e vajzës nuk gjendej në shtëpi. Panajoti ishte i dashuri i nënës së vajzës 8-vjeçare dhe bashkëjetonte me të e dy fëmijët e saj. Ai e ka mashtruar viktimën e përdhunimit me lekë duke i



kërkuar asaj të shkoste në kasollen e bagëtive për ti dhënë një dhuratë të bukur. Fëmija 8-vjeç me iniciale K.C. nga naiviteti i moshës e ka besuar Anagnostin. Komshinjtë kanë mbërritur në vendngjarje pasi dëgjuan të bërtiturat e së miturës, të cilën e gjetën të traumatizuar duke qarë vazhdimisht, çka kërkoi më pas edhe ndihmën e një psikologu. Mungesa e një psikologu të mirëfilltë për trajtimin e gëshëve të tilla qoftë në Delvinë apo Sarandë, ka bërë që fëmija të qëndrojë i struktur në dhomën e së emës. Anagnosti pas përdhunimit është larguar në drejtim të paditur, ndërkohë që Policia e Delvinës mundi ta arrestonte në orët e para të

ditës së djeshme, vetëm pas disa orësh kërkimesh. Abuzimi seksual ndaj së miturës ka ndodhur disa ditë më parë dhe ka qenë vetë nëna e saj, e cila ka bërë denoncimin në polici. K.C është paraqitur në Komisarjatin e Policisë së Delvinës dhe ka kallëzuar faktin se para disa ditësh vajza e saj 8-vjeçare është abuzuar seksualisht nga bashkëjetuesi i saj Panajot Anagnosti, 47-vjeç. Nga ekspertiza mjeko-ligjore ka rezultuar se me vajzën e mitur është kryer marrëdhënie seksuale. Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë së Rrethit të Sarandës për veprën penale marrëdhënie seksuale me të mitur, parashikuar nga neni 100/1 i Kodit Penal.

LAJME SHKURT

■ **Pasaportë gjermane false, arrestohet kosovari**
Policia kufitare në Portin e Durrësit vuri në pranga 24-vjeçarin Asllan Mazreku nga Rahoveci i Kosovës, teksa po tentonte të kalonte përtej detit me një pasaportë të falsifikuar. Burime zyrtare nga uniformat blu bëjnë me dije se 24-vjeçari tentoi të kalojë kufirin për në Itali në mënyrë të kundraligjshme, me një pasaportë gjermane, e cila dyshohet të jetë e falsifikuar. Si rrjedhojë u bë shoqërimi në polici i Asllan Mazrekut, ndërsa materialet në ngrakim të tij i kaluan Prokurorisë së Rrethit Durrës për veprën penale të falsifikimit të letërnjoftimeve, pasaportave apo i vizave.

■ **Gjendet trupi i pajetë i 46-vjeçarit, nisim hetimet**
Një 46-vjeçar është gjetur i pajetë në Mjedë të Shkodrës, trupi i të cilit kishte përfunduar në një kanal anës rrugës. Sipas të dhënave paraprake siç bëhet me dije nga policia, Vladimir Mustafa është gjetur i pajetë, ndërsa pranë tij u gjet edhe një motor me të cilin viktimja ka qenë duke udhëtuar. Trupi i pajetë do të nënshtrohet ekspertizës mjeko-ligjore, e cila do të ndihmojë policinë për të zbuluar motivin e vrasjes. Nga ana e uniformave blu kanë nisur hetimet, ndërsa ende nuk është ngritur ndonjë pistë. Dyshimet e bluve janë se viktimja mund të ketë humbur jetën gjatë një aksidenti me motor, por vdekja mund të ketë ardhur edhe nga shkaqe natyrore.



Masakroi

ish-bashkëshorten

lihet në qeli 48-vjeçari

Mbetet në qeli autori i krimt makabër të ndodhur para disa netësh në Durrës. Masakroi ish-bashkëshorten, duke e goditur me çekiç në kokë, ndërsa është ulur në bankën e të akuzuarve duke u njohur me akuzën e vrasjes me paramendim. Gjykata e qarkut Durrës ka vendosur masën e sigurisë arrest me burg për shtetasin Bujar Dedej, i cili pak ditë më parë vrau me mjete të forta ish-

bashkëshorten. Gjatë zhvillimit të seancës, prokurori ka ngritur ndaj Dedejit akuzën e vrasjes me paramendim, pasi ai e goditi bashkëshorten teksa ajo ishte në gjumë. Ngjarja ndodhi natën mes së premtës dhe së shtunës, në një banesë në lagjen numër 8 të qytetit bregdetar, i cili mbeti i shokuar nga krimi i rëndë. 48-vjeçari goditi me mjete të forta bashkëshorten e tij 6 vjet më të re gjatë natës, pasi më herët kishin pasur

një debat të ashpër në ambjentet familjare. Lime Dedej u dërgua në gjendje të rëndë nga policia në spitalin e Durrësit, por nuk mundi të mbijetonte, ndërsa autori i krimt u arrestua nga shërbimet e policisë. Nga veprimet e para hetimore, policia arriti në përfundimin se krimi ishte kryer për motive të dobëta, konkretisht për xhelozë, por pritet që hetimet në vazhdim të hedhin më shumë dritë mbi të.

Fqinjët: Fëmijët kanë vënë një karrige dhe kanë lidhur një litar

Vetëvaret në oborr 10-vjeçari

Fëmija ishte duke luajtur me një shokun e tij ndërsa ka tentuar të improvizojë në oborrin e shtëpisë skenën e një filmi. Kanë qenë fqinjët, të cilët kanë gjetur trupin e pajetë të 10-vjeçarit

Lajmi

Vetëvaret 10-vjeçari gjatë tentativës për të improvizuar një skenë filmi. Fëmija ishte vetëm në shtëpi me vëllanë 5-vjeç, pasi prindërit ishin në një ceremoni mortore.

BULQIZË

ANXHELA TATO

Një fëmijë 10-vjeçar u gjet i varur në pemë në oborrin e shtëpisë së tij. Ngjarja e rëndë u shënuar paraditen e djeshme në fshatin Fushë-Dushë të komunës Fushë Bulqizë, 5 kilometër larg qytetit të Bulqizës. Ekspertiza mjeko-ligjore vërtetoi se kemi të bëjmë me vetëvarje me litar. Sipas të afërmeve të viktimës, 10-vjeçari Viron Shehu ishte në banesë me vëllanë e tij të vogël. Babai i fëmijëve, Rifat Shehu, kishte kërkuar leje nga shkolla për të bërë birin 10-vjeçar që të kujdesej për vëllanë 5-vjeç, pasi prindërit kishin shkuar për të marrë pjesë në një ceremoni mortore. Komshinjtë, të cilët kanë lajmëruar policinë mbi këtë ngjarje, tregojnë se kanë dëgjuar të bëriturur e 5-vjeçarit, i cili kërkonte ndihmë.



Foto nga vendngjarja

Fëmija 5-vjeç ishte shokuar pasi pa vëllanë e varur në pemë. Dy vëllezërit kanë qenë duke ndjekur një film, ndërsa vetëm pas disa minutash Vironi u gjet i varur. Komshinjtë e familjes Shehu deklarojnë se fëmijën e kanë gjetur pa frymë dhe se kanë njoftuar menjëherë policinë. Menjëherë 10-vjeçari është transportuar në urgjencën e spitalit, ku edhe vazhdon të jetë aktualisht. 10-vjeçarit i është kryer ekspertiza mjeko-ligjore. Hetimet e para konfirmuan se fëmijës i është gjendur shenjë shtrëgimi në qafë, e cila dyshohet se është

të shenja e lënë nga litarit me të cilin është vetëvarur. Në trup nuk kishte shenja të tjera. Fëmija është dërguar menjëherë në spital por përpjekja për ta shpëtuar ka qenë e kotë, pasi 10-vjeçari ka gjetur vdekjen e menjëhershme nga mungesa e frymëmarrjes. Fillimisht u tha se fëmija ishte gjetur i varur nga familjarët, por më pas u mëtua se ata ishin lajmëruar nga policia. Kanë qenë fqinjët që kanë gjetur 10-vjeçarit në pemë, dhe kanë njoftuar policinë për këtë ngjarje. Pasi kanë dëgjuar britmat e fëmijës 5-vjeç,

ata kanë gjetur trupin e pajetë të 10-vjeçarit, të cilët kanë tentuar ti japin ndihmën e parë. Policia ka marrë në pyetje fqinjët, të cilët kanë qenë dëshmitarë në vendngjarje. Në deklaratimet e tyre ata kanë rrëfyer se 10-vjeçari së bashku me një shok kanë qenë duke luajtur. Sipas tyre fëmijët po improvizonin skenën e një filmi. "Djali bashkë me një djalë tjetër më të vogël kanë qenë duke luajtur. Fëmijët kanë improvizuar skenën e një filmi, kanë vënë një karrige dhe kanë lidhur një litar, më pas ndodhi ajo që ndodhi",

Policia

Kanë qenë fqinjët që kanë gjetur 10-vjeçarit të varur në pemë, dhe kanë njoftuar policinë për këtë ngjarje. Pasi kanë dëgjuar britmat e fëmijës 5-vjeç, ata kanë gjetur trupin e pajetë të 10-vjeçarit, të cilët kanë tentuar ti japin ndihmën e parë.

rrëfejnë ata. Fqinjët shtojnë se prindërit e 10-vjeçarit nuk kanë qenë në banesë në momentin e ngjarjes. Nga dëshmitë e mbledhura nga uniformat blu, 10-vjeçari me iniciale V.Sh kishte marrë leje në shkollë për tu kujdesur për vëllanë e vogël, pasi babai i tij kishte shkuar të blinte një dash për Kurban Bajramin, ndërsa e arma ndodhej në Bulqizë në një ceremoni mortore. Policia kanë nisur hetimet, por ende nuk ka deklaruar pistën. Dyshohet se vetëvrasja ka qenë aksidentale, pasi fëmija ka dashur të improvizojë një skenë filmi. Ndërsa ka lidhur një litar në pemë, ai është vetëflitur duke e menduar si një lojë. Por nuk ka mundur dot të lirohet duke u mbytur. Vetëvrasja është kthyer në një fenomen mjaft shqetësues dhe problematik gjatë këtyre viteve të fundit.

LAJME SHKURT

■ Hidhet nga kati i 4-rt, vuante nga depresioni

Një 59-vjeçar në kryeqytet i ka dhënë fund jetës duke u vetëhedhur nga kati i katërt i një pallati. Policia sqaron se ngjarja ka ndodhur tek Rruga e Elbasanit afër Drejtorisë së Tatimeve, ndërsa shtetasi Sotiraj Përmeti mësohet ta ketë kryer aktin e rëndë në kushtet e depresionit. Mësohet se viktimja ka humbur jetën 15 minuta pas rënies nga lartësia, ndërsa ka rezultuar i kotë dërgimi i tij në spital. Hetimet e policisë për ngjarjen vazhdojnë, ndërsa janë marrë në pyetje dëshmitarët. Nga ana e uniformave blu nuk është konfirmuar ende ndonjë pistë e mundshme hetimesh, por dyshohet se viktimja vuante nga depresioni. Policia ka pyetur të afërmit të viktimës, nëse 59-vjeçari ka pasur probleme të mëparshme.

■ Akuzohen për vrasje, ekstraduar 3 shqiptarët në Itali


Janë ekstraduar ditën e djeshme në aeroportin e Fiumicino në Itali dy shqiptarë Artan Gjoka dhe Ndreç Laska. Gjoka dhe Laska akuzohen se në natën mes 5 dhe 6 prillit të këtij viti sulmuuan shtëpinë e Sergio Scoscias dhe Maria Raffaelli në Cenerente, në veri të qytetit të Perugia, një grabitje që përfundoi me vdekjen e ish-argjendarit dhe nënës së tij të moshuar. Dy shqiptarët janë ekstraduar pas pothuajse 4 muaj kërkimesh. Në Fiumicino u pritën nga hetuesit e skuadrës së Perugia dhe nga Policia e Burgut për ti dërguar në burgun Spoleto. Gjoka dhe Laska, së bashku me Alfons Gjergjin, i arrestuar në Romë, natën mes datës 5 dhe 6 prill hynë në shtëpinë e Scoscias, në kërkim të arit të ish-argjendarit, një thesar prej 150 mijë eurosh i fshehur në një laborator të vjetër. Gjoka ishte vënë në dijeni të këtij thesari një e fejuara e tij, një prostitutë në rrugën Pantona dhe mike e Scoscias.

Ngjarja

Shqiptari vritet me plumb në kokë

ITALI

Vrasja e një shqiptari me plumb në kokë dhe plagosja e një tjetri në mes të ditës teksa ata po konsumonin një birrë në një bar, në lokalitetin turistik të Alba Adriatika, ka ngjallur reagimin e ashpër të komunitetit atje. Të shtunën pasdite, 30-vjeçari i identifikuar nga mediat italiane si Leven Ferra, së bashku me një bashkëatdhetar 23-vjeç i identifikuar me inicialet P.H, ishin ulur para një lokali kur i janë afruar disa persona, mendohet edhe ata shqiptarë. Fillimisht mes tyre ka pasur një sherr me fjalë dhe më pas agresorët kanë qëlluar. Ferra është qëlluar me plumb pistolette në kokë, ndërsa 23-vjeçari është plagosur me thikë në gjoks. Policia e Tera-



mos ka nisur hetimet për të zbardhur autorët por dhe motivet e vrasjes. Ndërkohë që në një distancë të shkurtër nga vrasja policia mendon se ka gjetur një makinë, Audi Station Eagon me të cilën mund të kenë udhëtuar autorët, ose ishte e viktimës. Gjurmët e gjetura në makinë janë dërguar në laboratorin kriminalistik dhe policia shprehet se mund të ndihmojnë për identifikimin dhe më pas arrestimin e autorëve. Sipas policisë italiane 30-vjeçari mund të jetë qëlluar me plumb në kokë, dhe jo dy siç u deklarua fillimisht në media. Por do të jetë autopasia që do të zhvillohet nesër për të përcaktuar në mënyrë definitive si është vrarë Ferra. Ndërsa shoku i tij është

plagosur me thikë në mushkëri. Ky i fundit ka tentuar të largohet nga vendi i krimt por është arritur nga policia e cila më pas e ka dërguar në spital. Pas verifikimeve është mësuar se 30-vjeçari i cili jetonte në provincën Martinscuoro, me dokumente të rregullta, ishte person me precedentet penale. Faqja online Abruzzo. Net shkruan se Ferra ishte me precedent penalë për dhunë seksuale dhe krime kundër pronës. Mendohet se vrasja mund të ketë lidhje me drogën ose me prostitucionin. Pikërisht vrasja në mes të ditës, në një bar dhe në një zonë të frekuentuar shumë ka shqetësuar së tepërmi banorët duke ngritur pikëpyetje të mëdha mbi sigurinë e tyre.



“Urdhëri”:

Farmacitë në kaos

40 pa licencë

Sistemi farmaceutik në vend është në kaos pasi shumë prej subjekteve shkelen ligjin dhe nuk respektojnë rregulloren për ushtrimin e profesionit. Akuzat janë lëshuar dje nga “Urdhri i farmacistëve” i cili gjatë muajit shtator kreu kontrolle në rreth 400 subjekte farmaceutike në mbarë vendin. Kreu i farmacistëve, Arjan Jaupllari deklaroi për mediat se nga kontrollet u vunë re 40

raste të rënda të shkeljes së legjislacionit që nga mospajjsja me licencë e subjekteve e deri te ushtrimi i profesionit të farmacistit nga persona pa diplomën përkatëse. Të gjitha këto shkelje sipas Jaupllarit vënë në rrezik jetën e pacientëve që përballë kësaj situatë, janë të pambrojtur nga shteti e strukturat e tij përgjegjëse për sigurinë e shëndetit të tij. “Urdhri i farmacistëve” i ka dërguar shkresë

zyrtare strukturave përgjegjëse mbi rezultatet e kontrolleve të kryera në farmaci, por ai kërkon që sanksionet për shkelësit të ligjit të jenë më të rrepta. Jaupllari tha se në zbatim të ligjit për profesionet e rregulluara këtë vit të ri akademik, farmacistët i janë nënshtruar edhe provimit në praktikë ku vetëm gjatë ditës së hënë janë testuar rreth 40 studentë.

Drejtorët: Duhet trajnime, janë një hallkë shumë kyçe

Mjekët e familjes s’njohin as diabetin

Anketa: 30 për qind me mangësi serioze

Lajmi

Mjekët e familjes në Tiranë kanë probleme serioze me zbatimin e protokolleve mjekësore që trajtojnë sëmundjet më të shpeshta. Pikërisht për këtë arsye drejtorët e parësorit shprehen se është i nevojshëm kualifikimi me anë të trajnimeve i kësaj kategorie.



Mangësitë

Sipas mjekëve që realizuan studimin, shumë prej kolegëve të tyre as vizitën me pacientin nuk e kryejnë siç duhet. Dhe bëhet fjalë për 200 mjekë që punojnë në kryeqytet

TIRANE

ESMERALDA KETA

Për të matur njohuritë e tyre është zhvilluar një anketë mbi një sëmundje që aktualisht është kthyer në shqetësim për mbarë botën. Bëhet fjalë për diabetin. Dhe kësaj prove i janë nënshtruar rreth 200 mjekë të sistemit parësor në kryeqytet, ku është vënë re se një pjesë e kon-

siderueshme e tyre nuk zbatonin si duhet rregullat për diagnostikimin e kësaj sëmundjeje. Sipas mjekëve që realizuan studimin, shumë prej kolegëve të tyre as vizitën me pacientin nuk e kryejnë siç duhet. Gjatë këtij studimi u vu re se mbi 50 për qind e mjekëve të familjes në qendrat shëndetësore tek pacientët me diabet të tipit 2, nuk e kryejnë kontrollin e këm-

bëve sa herë që këta pacientë paraqiten për vizitë. Ndërsa kontrollin e syve apo lipidogramën, nuk e kryenin rreth 30 për qind e mjekëve. “Rezultatet treguan që një pjesë e konsiderueshme e mjekëve kishin njohuri dhe e praktikonin, por ishte edhe një pjesë tjetër goxha e madhe që nuk kishin njohuritë e mjaftueshme. Kështu u mor një shembull konkret se

sa mjekë e kuptojnë kush është lipidograma dhe sa e rëndësishme është në këtë rast, sa janë normat dhe si duhen të vlerësohen ato të glicemisë në të dyja nivelet, esëll dhe pas ushqimit”, - shpjegon Ramiz Kërnaja, drejtor i qendrës shëndetësore numër 6. Studimi nënvizon gjithashtu se është nevojë urgjente që mjekët e familjes të mos mjaftohen vetëm me arsimin dyvjeçar, por duhet të trajnohen vazhdimisht. “Pavarësisht se mjeku i familjes është një rol strategjik në sistemet shëndetësore duhet të vazhdojë akoma më shumë nëpërmjet trajnimeve. Do të thotë që të

ketë mundësinë e njohjes më të madhe, të ketë mundësinë e përmirësimit të punës së tij për të ofruar një shërbim më cilësor”, - thotë më tej Kërnaja. Rezultatet duken të frikshme edhe për faktin se anketimi është realizuar me 200 mjekë që punojnë në qendrat shëndetësore të kryeqytetit. Kjo lë të

dyshosh se mjekët që punojnë në zona të thella të vendit dhe shkojnë vetëm një herë në muaj tek pacientët e tyre janë shumë larg zbatimit të protokolleve shëndetësore të një sëmundjeje të caktuar. Si pasojë edhe sëmundja nuk diagnostikohet si duhet duke rritur kostot.

Politrauma

Ministria e Shëndetësisë ndihmë nga Usaid

TIRANE

Ministria e Shëndetësisë, ka kërkuar ndihmën e USAID për një shfrytëzim sa më të mirë të Politraumës në Spitalin Ushtarak, pas janarit 2013, periudhë, kur ky shërbim pritet të kalojë në administrimin e shëndetësisë. Gjatë një takimi që ministri i Shëndetësisë, Vangjel Tavo ka zhvilluar dje me drejtorin e USAID në Tiranë, Jim Barnhart



al të politraumës, pranë Spitalit Ushtarak, ndihmë për hartimin e protokolleve dhe shfrytëzimin maksimal të këtij shërbimi, meqenëse nga janari 2013, politrauma do të jetë në administrimin e ministrisë së Shëndetësisë. Përfaqësuesi i USAID e ka siguruar ministrin Tavo, për mbështetjen në këtë drejtim. Vetëm pak ditë më parë ka nisur debati për kalimin e politraumës nën varësinë e ministrisë së Shëndetësisë. Ndërkohë që janë hedhur dyshime se pas kësaj marrëveshjeje, në të vërtetë po tentohet të privatizohet spitali ushtarak që ndodhet në Laprakë, duke ia lënë ambientet një spitali privat.

Blog/Joga dhe Ju

Harmonia e jogës dhe sportet



NGA ANILDA NOÇKA

sport, në mënyrë profesionale ose amatore mund të ndjejnë se me integrimin e Jogës në praktikën dhe trajnimin e tyre, performanca ndryshon në mënyrë pozitive. Jo vetëm që përmirësohet ana fizike, por integrimi i përqëndrimit, qartësia e meditim dhe ndjerësia e frymëmarrjes së integruar, përmirëson fokusin dhe qëndrueshmërinë pozitive që është shumë e rëndësishme për sukses në çdo fushë sportive.

Në varësi të sportit që praktikon, çdo sportist përqëndron vëmendjen gjatë trajnimit në grupet e muskujve që janë më të rëndësishëm për sportin që ata ushtrojnë. Kur disa pjesë të trupit janë të super trajnuara, pjesë

të tjera janë të nën stërvitura ose dhe më të ngurtësuar. Atletët, si shembull, kanë pulpa më të ngurtësuar se futbollistët. Qëllimi i sportistit është të përdorë Jogën për të rigjeneruar forcën e muskujve rreth shtyllës kurrizore, të shtojë fleksibilitetin, të sjellë trupin në balancë dhe të mësojë kordinimin e fokusimit me frymëmarrjen.

Ka shumë mënyra për të mësuar si të praktikosh Joga, mund të shikosh një video, lexosh një libër, etj. Mënyra më e mirë, për çdo njeri apo sportist që është fillestar, është në prezencën e një instruktori. Një instruktur i trajnuar dëgjon dhe punon me çdo individ për të individualizuar

pjesët e trupit që kërkojnë më shumë punë, dhe krijon një praktikë individuale për çdo nevojë apo pjesë të trupit. Instruktori gjithashtu ndihmon në programimin e intensitetit dhe serisë së duhur, në momentin e duhur të praktikës, pa krijuar dëmtime dhe probleme.

Një element tjetër i rëndësishëm në Joga është frymëmarrja ose "pranayama". Përqëndrimi në frymëmarrje gjatë praktikimit të Jogës mund të konsiderohet një nga efektet më të rëndësishme për një sportist në mënyrë të veçantë. Të mësohet se si të qëndrosh i fokusuar në pozicione të ndryshme dhe në tranzicionet midis pozicioneve të ndryshme, duke u

përqëndruar në frymëmarrjen, ndihmon sportistin, në veçanti, të qëndrojë i fokusuar gjatë aktivitetit të tij dhe garave të rëndësishme. Lidhja mendje-trup në Joga është thelbësore në zhvillimin e qartësisë mendore dhe përqëndrimit. Në harmoni, Joga bashkon relaksimin, jo vetëm të muskujve të integruar, por dhe të mendjes së stresuar dhe tensionuar.

Një mendje e relaksuar është bazë për një performancë më cilësore. Sportistë të njohur dhe Joga: Michael Jordan (basketbolli), David Beckham(futboll), Serena Williams (tenis), Tony Parish (NFL), e shumë të tjerë.



Presidentja Jahjaga mbështeti takimin Thaçi - Daçiç

Pas takimit me presidenten e vendit, Atifete Jahjaga dhe me nënkryetarin e AAK-së Blerim Shala, kryeministri Hashim Thaçi takoi të hënën edhe kreun e LDK-së, Isa Mustafa. Sipas komunikatës nga Kryeministria, me këtë rast Thaçi njoftoi Mustafën lidhur me takimin e mbajtur në Bruksel. "Ishte konstatim i përbashkët që të vazhdohet

me procesin e normalizimit të marrëdhënieve në mes të shtetit të Kosovës dhe Serbisë, me qëllim të krijimit të raporteve ndërshtetërore, të stabilitetit rajonal dhe perspektivës evropiane", thuhet në njoftim. Siç edhe ishte paralajmëruar, pas takimit me presidentin Jahjaga, kryeministri i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi,

është takuar sot edhe me nënkryetarin e AAK-së, Blerim Shala. Temë diskutimi ishte takimi i kryeministrit Thaçi me përfaqësuesen e lartë të Bashkimit Evropian, baroneshën Catherine Ashton dhe me kryeministrin e Serbisë, Ivica Dacic. "Kryeministri Thaçi e informoi nënkryetarin e AAK-së, Shala rreth takimit.

Policia shpërndan në Prishtinë protestën kundër dialogut me Serbinë

Kosovë, dhunë mbi deputetët

Liburn Aliu është rrahur te hoteli ish-Iliria, dhe nga plagët e marra, është trajtuar në spital. Ndalohen 63 protestues. Sot sërish protestë kundër bisedimeve Kosovë-Serbi

Lajmi

Policia dhunoi me dhjetra protestues së lëvizjes Vetëvendosja në Prishtinë, dje paradite, ndërsa protestohet kundër bisedimeve Serbi-Kosovë. Policia dhunoi edhe deputetët e kësaj lëvizjeje dhe ndaloi 63 aktivistë.



Në foto: Protesta e djeshme e Vetëvendosjes dhe Deputeti Liburn Aliu i rrahur nga policia

e fundit nga kjo lëvizje thuhet se disa nga protestuesit që janë në Qendrën Klinike Universitare, janë në gjendje jo të mirë shëndetësore. Më herët gjatë ditës, Vetëvendosje bëri të ditur se deputeti Liburn Aliu, është në mesin e të lënduarve. Sipas Ymerit, Liburn Aliu është rrahur te hoteli ish-Iliria, dhe nga plagët e marra, është trajtuar në spital. Por, Policia e Kosovës tha se deputeti Aliu nuk është rrahur me personat e tjerë.

kufij të mbrojtur, me integritet territorial, e me zhvillim ekonomik. Ne duam që të mobilizohemi si shqiptarë, si Kosovë, si komb, si shoqëri, si qytetarë kundër Serbisë. Konflikti me Serbinë nuk ka përfunduar", theksoi Kurti.

encë për media të mbajtur gjatë ditës, tha se autoritetet e rendit janë përballur me një

protestë të dhunshme dhe të paparalajmëruar nga Lëvizja Vetëvendosje. Sa i takon num-

rit të të arrestuarve, për Vetëvendosjen, numri është shumë i madh. Në njoftimet

Ndërkaq, Policia e Kosovës bëri të ditur se ka shoqëruar në stacione policore rreth 63 protestues të Lëvizjes Vetëvendosje, derisa kanë demonstruar në shenjë pakënaqësie për takimin që ka zhvilluar kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, me kryeministrin e Serbisë, Ivica Dacic, në Bruksel. Zëdhënësi i Policisë së Kosovës, Baki Kelani, deklaroi: "Numri i personave të shoqëruar në stacione policore deri më tani ka arrihur në 63 persona. Të gjithë janë shoqëruar në momentin kur kanë qenë të dhunshëm ndaj zyrtarëve policorë, duke hedhur mjete të ndryshme, duke përfshirë edhe gurë masiv në drejtim të policisë". Protestuesit nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, që në

orët e hershme të mëngjesit provuan të shkonin pranë ndërtesës së Qeverisë së Kosovës, siç u tha, "për të penguar punën normale të ekzekutiv-it". Aktivistë dhe deputetë të saj kanë pësuar lëndime, derisa njësitet speciale të Policisë së Kosovës po tentonin ta shpërndanin turmën, e cila kishte mësyre ndërtesën e Qeverisë. Autoritetet e rendit kanë përdorur herë pas here gazin lotsjellës për të shpërndarë turmën, prej nga raportohet se janë hedhur edhe gjësende të forta. Zëvendës-drejtori i Policisë së Kosovës, Naim Rexha, në një konfer-

TIRANE

Pas disa përpjekjeve të policisë për të shpërndarë protestën e aktivistëve të Vetëvendosjes, të cilët ishin duke protestuar kundër dialogut me Serbinë, protesta ka përfunduar në orët e pasdites. Përfundimi i protestës ndodhi, pasi policia lejoi demonstruesit që të qëndrojnë para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës. Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, para përfundimit të protestës, tha se tentimi për të arritur deri te ndërtesa e Qeverisë, që nga mëngjesi,

Aktivistë dhe deputetë të saj kanë pësuar lëndime, derisa njësitet speciale të Policisë së Kosovës po tentonin ta shpërndanin turmën, e cila kishte mësyre ndërtesën e Qeverisë

është, siç u shpreh ai, "beteja e parë e re në mesin e shumë betejave që janë zhvilluar, kundër dialogut politik me Serbinë, kundër autonomisë së veriut dhe ndarjes së Mitrovicës". "Le të jetë kjo ditë, ditë e dy parullave kryesore: 'Me hajna nuk ka shtet' dhe 'Sheshi është yni, jo i Qeverisë', u shpreh Kurti në mblyllje të protestës. Kurti deklaroi se vullneti i njerëzve për të qenë të lirë, për të pasur drejtësi e barazi, është i pandalshëm. "Nuk ka cizme dhe nuk ka njësit special që e ndal vullnetin tonë. Ne jemi për një Kosovë sovranë, me

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

NJOFTIM PER VEND TE LIRE PUNE

Në zbatim të nenit 35 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" dhe ligjit nr. 8549 datë 11.11.1999 "Statusi i Nënpunësit Civil", institucioni i Avokatit të Popullit, shpall konkurrimin për një vend të lirë pune në detyrën e specialistit të Administratës. Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme në përputhje të nenit 12 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nënpunësit Civil".

Kërkesat e veçanta për kandidatët janë:

- ☉ Të kenë përfunduar studimet e larta
- ☉ Të kenë jo më pak se tre vjetë eksperiencë pune
- ☉ Preferohet gjuhë e huaj
- ☉ Të zotërojnë programet bazë të punës në kompjuter
- ☉ Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup
- ☉ Të mos ketë pengesa të veçanta për t'u paraqitur në çdo kohë kur do të jetë e nevojshme në detyrë
- ☉ Paga për këtë pozicion pune është e specialistit të lartë III-B (55.500 lekë)

Paraqitja e dokumenteve

- Brenda datës 20.11.2012 kandidati duhet të paraqesë dokumentet pranë Drejtorisë së Personelit dhe Administratës, në Institutin e Avokatit të Popullit. Dokumentet duhet të përmbajjnë:

Kërkesën për punësim

- CV-në
- Diplomën e Librezën e notave të fotokopjuar e noterizuar
- Librezën e Punës
- Certifikata Kualifikimi
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit përbën shkak për shkallëzim.
Kandidati të japë adresën e saktë të vendbanimit si dhe një numër telefoni

Konkurrimi

Konkurrimi është i hapur për nënpunësit civil të së njëjtës klasë me procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë. Nëse vendet nuk plotësohen nga këta kandidatë, konkurrimi zhvillohet me kandidatët jashtë administratës publike sipas procedurave të pranimit në shërbimin civil. Pas verifikimit paraprak do të bëhet shpallja e listës së konkurrentëve që do të vazhdojnë më tej konkurrimin si dhe data kur do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista me gojë.

Kandidatët duhet të përgatiten në këto fusha:
Ligji për "Avokatin e Popullit" i ndryshuar, Kodi i Procedurës Administrative, Ligji nr. 9643 dt.20.11.2006 i ndryshuar me ligjin nr.9800 dt.10.09.2007 "Për prokurimin publik".
Të gjitha njoftimet për rezultatet e verifikimit paraprak, si dhe datat kur do të zhvillohen testimet mund t'i gjeni pranë Drejtorisë së Personelit dhe Administratës në Institutin e Avokatit të Popullit.

Lëvizja

Sot sërish protestë të "Nënë Tereza"

Lëvizja VETËVEN DOSJE! u bëri thirrje qytetarëve të Kosovës të grumbullohen në sheshin Nënë Tereza, në demonstratën paqësore në orën 11:00. Ajo kërkoi edhe lirimin e menjëhershëm të aktivistëve që policia i arrestoi dhunshëm dhe vijon t'i mbajë të burgosur. "Ata qytetarë nuk janë kriminelë, ata nuk ishin të armatosur, ata nuk përbëjnë rrezik për shoqërinë, dhe veç i bëjnë nder shoqërisë. Ata dolën në emër të së drejtës demokratike për pjesëmarrje, kundër një qeverie që ia mihon pjesëmarrjen popullit"-dekloroi mbremë VV.



Intervista

NJË MONOGRAFI e studiueses Suzana Varvarica Kuka, synon të zbardhë gjithë jetën dhe krijimtarinë e artistit të rrallë që jetoi vetëm 66 vjet...

■ ■ ■ TIRANE

ADMIRINA PEÇI

SUZANA VARVARICA

Mio, piktori i rrallë që vdiq nga dëshpërimi

“Enver Hoxha nuk e ndihmoi të kuronte djalin e sëmurë”

Nëse ndodhni para një tabloje, me një peizazh diku nga Korça ku sundon një blu e veçantë, diçka midis blusë dhe violës, shiheni me kujdes në fund të tablosë, mund të jetë nënshkrimi "Vangjush Mio". Mund të jetë një nga 30 veprat e tij që u shpallën të humbura në Galerinë e Korçës para pak kohësh. Ishte një skandal i madh, një humbje kolosale. Për këtë piktor, së fundi po shkruhet një monografi. Studiuesja Suzana Varvarica do të na rrëfejë disa linja mjaft ngacmuese të kësaj monografie e disa të fshehta nga jeta e artistit...mbi fillesat, të veçantën e artit të tij, detaje jetësore nga biografia, deri tek fundi tragjik. Mio u nda nga jeta në moshë mjaft të re, mbase nuk e përballoi dot sëmundjen e të birit dhe pafuqishmërinë e tij për ta ndihmuar, edhe pse zërin e ngriti deri tek Enver Hoxha, të cilin e njihje që nga liceu i Korçës.

Ishte një humbje dramatike ajo që ndodhi në Muzeun e Korçës. 30 piktura të një piktori të rangut të Vangjush Mios janë një humbje e madhe kombëtare?

-Ke shumë të drejtë. Këta lloj artistësh janë një fat i madh që i kemi pasur, dhe një fat shumë më i madh që kishim Vangjush Mion. Të arrish sot dhe të thuash që rreth 30 vepra të tij, (madje është diçka më tepër se kjo është vjedhja e tretë që i bëhet Vangjush Mios, pra, kemi një sasi veprash që shkon rreth 50 vepra të vjedhura të Vangjush Mios qysh pas 94-s e deri në ditët e sotme)... kjo është një humbje jashtëzakonisht e madhe për atë autor, edhe për kulturën tonë. Ne kemi aq pak artistë, duke e krahasuar me kombet e tjerë, dhe të mendosh se veprat e atyre artistëve gjenden në shtëpiza të bukura ose vila të bukura dhe i mbajnë disa individë, kjo është e dhimbshme. Nuk i kanë më galeritë, pra këtë sasi prej 50 veprash nuk i ka muzeu ose shtëpia muze Vangjush Mio në Korçë, por gjenden në këto shtëpi. Pse të mos ishin më muze, ku publiku që do të vijë më pas, brezat pas nesh do ta njohin më mirë nga ne Vangjushin? Një sasi veprash të zhdukura, do të thotë të humbasësh periudha të caktuara nga vepra e tij.

Nuk e vë në diskutim, janë njerëz me shije ata që i kanë marrë në shtëpitë e tyre ose në ato vilat e bukura siç thua ti. Humbja më e madhe është se publiku s'do të jetë në kontakt me to, ndërsa studiuesit ose restauratorët në rast se ato dëmtohen nuk mund të kujdesen për to...

-Ke shumë të drejtë. Gjithkush që i ka ato duhet t'i ruajë si një vlerë të jashtëzakonshme. Mio është fillimtar i artistëve profesionistë dhe këtë e them me bindje. Duke shfletuar dokumentacionin e fillimshkullit të 20-të Mion e gjejmë një artist të kompletuar dhe profesionist, duke nisur që nga fillimet e para të studimeve të tij. Ai kreu



Autoportreti i pikturuar nga Vangjush Mio

dy shkolla shumë të mira. Në Bukuresht ishte një shkollë 200 vjeçare dhe kur shkoi Mio e kishte fituar statusin e 200 vjetëve akademi. Studioi atje pesë vjet. Këto pesë vjet i takojnë krahasimisht një shkollë të mesme tonës. Më pas ai kthehet në Korçë. Hap atje ekspozitën e tij të parë dhe ky është një element shumë i rëndësishëm për kulturën e arteve pamore në Shqipëri.


Pra, kemi një sasi veprash që shkon rreth 50 vepra të vjedhura të Vangjush Mios qysh pas 94-s e deri në ditët e sotme.

Ka po ashtu një momente tejet të rëndësishëm, kur ai hap studion e parë. Por shpejt e vendos se duhet të vijont emë tejet em studimet, në një shkollë të një kapacitetit më të lartë. Studion në Akademinë e Arteve të Bukura në Romë dhe merr dy diploma, në fillim si restaurator dhe është një nga restauratorët e parë të shkolluar dhe kjo ndodh në vitet '24-'26 e më pas merr edhe diplomën si piktor. Pra Mio vjen në Shqipëri, në dh-

jetëvjeçarin e tretë të shekullit të 20-të si një piktor profesionist. Shpeshherë më bëjnë pyetje: pse e thekson 'piktor profesionist'. Po të tjetër nuk ishin? Ishin por Mio ka një përshtatje të kapacitetit të tij artistik më të ndryshëm se piktorët e tjerë të kohës së tij. Mion e bën të veçantë kjo, sepse Mio doli të pikturonte në natyrë. Pra peizazhet e tij janë të bëra drejtpërdrejt nga natyra. Kjo është një veti e impresionistëve. Shpeshherë gjejmë si të thuash etiketimin Mio impresionist. Janë edhe disa elementë tjerë që e bëjnë Mion të tillë që të jetë impresionist. Përveç kësaj Mio ka subjekte dhe temat e veta që lidhen kryesisht me peizazhin, paksa me portretin, apo edhe me nudot që ai krijoi në Itali.

Nuk njohim shumë nudo të krijuara pas ardhjes së tij në Shqipëri. Ka disa tentativa të bëjë disa nudo. Disa janë të pambaruara. Por kemi disa vizatime që tregojnë se Mio mund të pikturonte shumë mirë, nudo, mund pikturonte shumë bukur portretin, por ai si të thuash "u thjeshtëzua" tek peizazhi.

Kiço Ristani shkruan në kujtimet e vetadicka shumë interesante mbi mardhënien e Mios me peizazhin: Dukej Mio kur dilet nga shtëpi e tij



Në nga letrat e Mios dërguar kolegëve

me biçikletën Herkuliana, një biçikletë e madhe për ne se ishim të vegjël dhe e ngarkonte me gjithcka që i duhej. Dukej sikur nuk do të kthehej më, aq shumë gjëra merrte me vete në biçikletën e tij.

Mion e shihnim gjithmonë në pasqyrimin e peizazhit të asaj kohe. Shohim fushën e madhe të Korçës, malin e Moravës, shohim personazhet të vogla, që janë vendosur në këtë linjë të stilit impresionist. Ai nuk i jepe rëndësi figurës, por figura është aty, trajtuar njësoj si peizazhi, ka të njëjtën rëndësi trajtimi edhe në stil edhe në preokupimin e artistit, për të dhënë si të thuash klishtë e veta.

Mio qëndron në këtë lloj profesionizmi për atë shije që lë pas, e që publiku e pranon si një piktor të freskët e me dinjitet, një piktor që ka ditur ta vlerësojë pikturën, ka ditur të vlerësojë edhe atë çka ditur të bënte.

Një sasi veprash të zhdukura, do të thotë të humbësh periudha të caktuara nga vepra e Vangjush Mios, ato nuk janë pak

Mio nuk është ngatërruar shumë.

Që do të thotë...?!

Dhe kur u ngatërrua në vitet '40 me ardhjen e komunizmit, kur nga Lidhja shkrimtarëve u sugjeroheshin të trajtonin tema me klasën punëtore, të bëheshin tema me ndërtimin e Shqipërisë, sepse filluan të ndërtohen hekurudha hidrocentrale, Mio shkoi të punonte. Megjithatë nuk arriti kurrë të krijonte si të thuash atë



ndjesi që shkaktonte kur pikturonte peizazhin, pra peizazhin që ai e zgjidhte vetë, nuk e kishte të stisur, nuk e kishte të porositur.

Ky artist i mrekullueshëm jetoi vetëm 66 vjet. Ai vdiq në 57-n, por si ishte jeta e tij. Ishte një jetë e lumtur, një jetë me vuajtje me dhimbje që ai e reflektoi në veprën e tij? Në ç'formë e reflektoi?

-Ky fakt që ju thoni është shumë interesant. Por unë do të thoja që Mio ka pasur një jetë të dhimbshme nga momenti kur i sëmuret djali. Ai nuk gjeti forcë, nuk gjeti një mënyrë komunikimi me shtetin e kohës, që të ndihmonte familjen Mio. Pra ta ndihmonte këtë personalitet të artit shqiptar për kurimin e djalit të tij, dhe siç e kanë të shkruar në dokumente ai donte ta çonte jashtë djalin për kurim. Ky është shqetësimi më i madh i Mios që nga dita kur sëmuret djali dhe derisa ai vdes. Por gjithë ky shqetësim, nuk është se raportohet, nuk është se pasqyrohet në krijimtarinë e Mios.

Sepse Mio e shkruan mjaft qartë që gjëja më e rëndësishme që kam në jetë është arti dhe familja. Mio merr prej me punët e familjes por nuk e superonte sëmundjen e djalit. Ikte në natyrë. Ishte një ilçe e butë në natyrë. Donde të të jetonte me veten, me natyrën.

Kur flet për ndërrimin e sistemeve vajza e tij reagon shumë egër, sepse thotë që babai im dhe mamaja vuan shumë në shtetin e kohës, që të sëmure. Ky ishte shqetësimi, turbulencia që kishte gjatë gjithë kohës, derisa edhe vdiq.

Në atë kohë ai kërkoi ndihmë

ENVER HOXHA hipte në skenë për të takuar gjithë trupën dhe... Mio nuk u ngjit kurrë ta takonte...



Në foto: Studio e piktorit pikturuar nga Mio

nga shteti. Ai ishte njohur me Enver Hoxhën në Liceun e Korçës. Nuk pati mundësi të kontaktohe personalisht me të, ti kërkonte ndihmë? Ka dokumente që e dëshmojnë këtë?


-Ekzistonin letra për këtë lloj komunikimi. E bija thotë se babai i shkroi direkt Komitetit Qëndror, në atë kohë dhe Enver Hoxhës, sepse e njihte. Kanë qenë të dy pedagogë në Liceun e Korçës, madje kanë miqësi të jashtëzakonshme me njëri-tjetrin, sepse Mio vërtetë nuk mori pjesë në luftë por anonte për prosperitetin e atdheut në kohën e Luftës së Dytë Botërore.

E bija thotë se shkroi disa letra, por nuk mori kurrë përgjigje. Kur Enver Hoxha shkoi në Korçë në ndiqte shfaqjet e Tetarit të Korçës, Mio punonte si skenograf dhe kostumograf. Por kur vinte momenti i

Mio kishte një aparat shumë të mirë në shtëpi dhe ka një sasi rreth 500 xhamash, të cilat Mio i ka fotografuar vetë

mbylljes së shfaqjes dhe Enver Hoxha hypte në skenë për të takuar e gjithë trupën, Mio mbyllet në studio dhe shihte punën e tij. Ai nuk u ngjit kurrë ta takonte, t'i jepte dorën. Edhe njerëz që sot jetojnë e pohojnë faktin që Enver Hoxha nuk i ktheu kurrë përgjigje për punën e djalit të tij. Ishte një lloj revolte që bënte familja Mio përkundrejt qeverisë së asaj kohe.

Si çdo monografi edhe juaja



Një nga letrat që tregojnë se piktori vizatonte kudo

kërkon dokumente, dëshmi, etj. Në çlinja keni punuar?

-Për të bërë një monografi të një piktori duhet patjetër të drejtohesh në disa linja. E para, ka qenë imazhi, natyrisht i veprave të artit dhe i mazhi i vetë artistit. Pra, imazhin e veprave të artit e kam marrë në disa burime, si ç' është Galeria e Korçës ku nuk arrita të merrja të gjitha për faktin se ekzistonin vjedhja, më shtëpinë muze në Korçë, në shtëpinë e vet Vangjush Mios, në Galerinë Kombëtare të Arteve dhe në disa koleksionistë të cilët njihen si blerës nga vetë familja Mio. Por ka dhe një burim tjetër të imazhit që Mio e ka lënë vetë nëpërmjet aparatit të tij fotografik, sepse miqësia e tij me fotografin Kristaq Sotiri në Korçë ka qenë tepër e ngushtë, madje e përmend disa herë edhe e bija Roza. Dilnin të dy bahskë, njëri për të fotografuar, e tjetri për të pikturuar. Ndërkohë edhe Mio fotografonte, sepse Kristaqi i kishte mësuar disa teknika fotografimi. Dihet që Mio kishte një aparat shumë të mirë në shtëpi dhe ka një sasi rreth 500 xhamash, të cilat Mio i ka fotografuar vetë. Aty sheh të fotografuar familjen, pikturat, peizazhet që pikturonte, etj Pra ky është burimi i dytë i imazheve. I treti që të bësh një monografi të tillë janë dokumentet dhe jam bazuar shumë në shkrimet mediatike të viteve '50. Më kanë ndihmuar shumë gazeta e Korçës, me shkrimet e saj deri deri në vite 57, ku shkrime në këtë kohë sundohen nga demagogjia. Më është dukur shumë me vlerë gazeta Minerva, e cila ka tekste të jashtëzakonshme.

Burim tjetër është e bija Roza, dhe arkitekti Pirro Thomo i cili ka restauruar shtëpinë e vjetër të Mios e më ka ofruar fakte të jashtëzakonshme për ndërtimin e kësaj shtëpie, sesi zbuloi se është një nga shtëpitë më të vjetra. Ai, ndërsa pastronte faqen muri, ka gjetur fletë librash të shkruara dhe datën kur është ndërtuar shtëpia.

Megjithatë duhet thënë se është e vështirë të shkruash monografinë e një artisti në shqipëri, pasi nuk ka shumë materiale të shkruara nga vetë ata. Po ashtu periudha e viteve të komunizmit është shumë e vështirë, ka dogmë, ideologji. Nuk gjen shprehje estetike. Në këto kushte, në Shqipëri është sakrificë të shkruash për një artist që nuk ekziston.

Monografia ka përfunduar apo jo...kur do të botohet?

Po është gati për botim, por duhet ende edhe pak kohë që të bjerë në duart e lexuesve..

85- vjetori

NJË FËMIJËRI ndërmjet Frymës së Shenjtë dhe Hitlerit, shkruan biografi i Grassit, Michale Jürgs

Nobelisti Gunter Grass, rikujtohet biografia e errët

Pranoi anëtarësinë në Waffen SS kur ishte 17 vjeç

TIRANE

Pas dhënies së çmimit Nobel 2012, pothuajse të gjitha me diat kanë pasuar shkrime kritike për mungesën e kritereve prej Akademisë Suedeze. Nobelisti kinëz Mo Yan 2012, u shpall fitues edhe për figurën e lartë morale, por ç'mund të thuhet për fituesin e Nobelit 1999, Gunter Grass, nëse do të ndiqej i njëjti kriter nga juria e Nobelit. Pikërisht këtë gjykimi mediatik, Gras nuk i ka shpëtuar as në ditëlindjen e 85-të të tij. "Jeta e tij, përplot ulje e ngritje, momente magjike e mospranime, filloi më 16 tetor 1927", shkruan Kornelia Rabitz në shkrimin e saj "Një nobelist që provokon (NOA, 22.10.2012). Autorja e këtij shkrimi risjell gjithë biografinë e Nobelistit, duke iu referuar biografëve të tij: "Një fëmijëri ndërmjet Frymës së Shenjtë dhe Hitlerit", shkruan biografi i Grassit, Michale Jürgs." Dhe më poshtë në shkrimin e saj shkruhet se: "Në moshën 17-vjeçare, Grass ishte dëshmitar i mizorive të Luftës së Dytë Botërore, si një ndihmës i njësitit të antiajror, në vitin 1944, e më vonë edhe si pjesëtar i elitës Waffen SS. Shumë dekada më vonë Grass zbuloi përfshirjen e tij në luftë, duke shkaktuar një skandal të madh, edhe pse shqetësimi i tij



Në foto: Nobelisti Gunter Grass

kryesor gjatë luftës ishte mbijetesat". Në përkujtimin e 85-vjetorit autorja e shkrimit Kornelia Rabitz sjell edhe një varg veprash, të cilat janë mjaft provokuese, ashtu si edhe biografia e tij. "Grass edhe sot mbetet një krijues shumëdimensional, një novelist, poet, artist grafik, skulptor, e nganjëherë edhe ilustrues librash. Por, ka tërhequr vëmendjen edhe me ndërhyrjet e tij politike. Ka kohë që njëhet edhe si një lloj "autoriteti moral" në Gjermani." (NOA). Duke e konsideruar në çdo aspekt të jetës provokuese si jetën politike dhe në veprat e tij, Kornelia kujton se "Në vitin 2006 Grass i pranoi dëshmitë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Kur pranoi anëtarësinë në Waffen SS-në kohën kur ishte vetëm 17-vjeç,

shkaktoi një debat të hapur akuzues publik brenda e jashtë Gjermanisë." Autorja e shkrimit nuk lë pas dore edhe faktin që në prill të vitit 2012 Grass publikon lirikën "Was Gegasagt Werden Muss" (Çfarë duhet thënë), dhe sërisht shkakton një skandal, që i kalon kuffitë e Gjermanisë. Teksti, i shtruar në formë poeme, ishte një kritikë ndaj politikës izraelite. Grass paralajmëronte një sulm bërthamor izraelit ndaj Iranit, duke i etiketuar kapacitetet e tij bërthamore dhe politikat uzurpuese si kërcënim për paqen botërore. Poema shkaktoi zemërimin izraelit, dhe autori atje u shpall person non grata. Nisën të qarkullonin edhe akuzat antisemitiste ndaj tij.

Feim Ibrahimi Zana Shuteriqi: Artisti që sfidoi kornizat

TIRANE

Akademia përkujtimore për kompozitorin Feim Ibrahimi "Artist i Popullit" (1935-1997), u çel dje me një mini-ekspozitë të krijimtarisë së tij në mjediset e Qendrës së Kulturës dhe Botimeve të Mbrotjes. Në mesin e kësaj ekspozite gjendej edhe partitura e veprës "Rapsodia shqiptare" që daton në vitin 1972. Ndërkohë në përkujtimore u lexuan edhe kumtesat me temë "Vendi i Feim Ibrahimit në kulturën muzikore shqiptare", nga Prof. Dr. Z Shuteriqi, Prof. as. Nestor Kraja, Dr. Eno Koço, Edmond Buhara, Saimir Skënduli, etj. Në fjalën e tyre, referuesit e spikëtën Feim Ibrahimin si një nga personalitetet më të spikatura të muzikës shqiptare që prej viteve 1970 e më tej. Gjithashtu, Dr. Zana Shuteriqi u shpreh se "Feim Ibrahimi u përpoq me të gjithë mënyrat të sillte një muzikë antidogmatike, anti-



Filmi "Pylli i lirisë" muzika Feim Ibrahimi

ideologjike, jashtë kornizave të kohës", etj. Në përshëndetjen e saj bashkëshortja e kompozitorit, Vera Ibrahimi, pasi foli për partiturat dhe rapsodinë shqiptare, tha se këto partitura kërkojnë më shumë vëmendje për të mos u prishur më tej. "Nuk bëhet asgjë për ruajtjen e këtyre partiturave dhe e them këtë,

jo vetëm për Feimin, por për të gjithë kompozitorët që nuk janë më dhe ata të rëndësishmit numërohen me gishta. Unë i ruaj partiturat që kam në shtëpi me fanatizëm, por në kushtet e shtëpisë ato dëmtohen çdo ditë që shkon", tha ajo duke bërë apel për subvencion nga organizatam shtetërore që të ndërhyjnë për dixhitalizimin e këtyre partiturave, të cilat janë shkruar të gjitha me laps në ato kohë dhe lapsi fshihet. Feim Ibrahimi, një figure qendrore e muzikës shqiptare të shekullit XX, zë një vend të rëndësishëm në kulturën tonë kombëtare. Ai njihet

si kompozitori i filmave shqiptarë me temë heroike si: "Ngadhënjim mbi vdekjen", "Kur zbardhi një ditë", "Pylli i lirisë", "Shembja e idhujve", "Ballë për ballë", etj.



Koment

Greva dhe mësimet prej saj



NGA AFRIM KRASNIQI

vijon nga faqja 1

...institucioneve kushtetuese morën vendimin e duhur për mbylljen e aktit të protestës ekstreme. Në historinë e grevave të urisë në Shqipëri kjo është greva më jetëgjatë, dhe njëherësh, greva më e vogël numerikisht por më e komentuar në politikë, media e shoqëri.

Greva të tilla zakonisht mbyllen me një bilanc dhe ajo e djeshmja ka arsye të besohet se bilanci i tyre ishte pozitiv. Vetë grevistët e theksuan dhe këtë fakt. Ata nuk arritën të bindin qeverinë të pranonte dialog, nuk arritën të marrin përgjigje për kërkesat e tyre ekonomike, nuk arritën të imponojnë protesta masive publike në mbështetje të tyre, por ata arritën ta sfidojnë pushtetin arrogant dhe të fitojnë simpati të gjerë publike brenda e jashtë vendit. Asnjë grevë tjetër ekonomike nuk ka pasur kaq shumë jehonë dhe nuk ka lënë kaq shumë gjurmë në politikën dhe shoqërinë shqiptare. Asnjë grevë tjetër e dhjetë viteve të fundit nuk ka qenë më e komentuar nga SHBA, BE, përfaqësuesit ndërkombëtarë në Tiranë dhe institucionet vendore e ndërkombëtare të drejtave të njeriut. Për të u fol në Departamentin Amerikan të Shtetit, në Bruksel, në Strasburg, në Vjenë, në Prishtinë, dhe çdo orë të ditës edhe në Tiranë. Për herë të parë pati akte proteste vetëfillimi, të cilat fatmirësisht nuk morën jetë, por kurajo e grevistëve tejkaloi çdo parashikim dhe ishte një leksion demokracie për çdo qytetar në një shoqëri apatike, të mësuar në bashkëjetesë me të keqen dhe të paafit të kuptojë nevojën dhe kohën e ndryshimit.

Falë tyre, sot nuk ka dilemë se u provua përfundimisht se sistemi aktual politik e qeverisës është ngritur mbi mosmirënjohjen, mungesën e humanizimit, moralit dhe integritetit, paaftësinë për të përmbyshur përgjegjësitë kushtetuese dhe arrogancën e një klike politike pa vizion dhe shtojcë e mentaliteteve, sjelljeve dhe praktikave të sistemit të vjetër komunist. Falë tyre shoqëria shqiptare mësoi se mjekët - politikanë dhe politikanë në emër të qytetarit mbetën slogane boshë përballë sulmeve arkaike të kohës së luftës së klasave dhe strategjisë miopie qeveritare denigruese, fyese dhe përqarëse. Prej saj u mësuja se shoqëria shqiptare sidomos ajo politike, nuk vepron dhe as funksionon horizontalisht, por në formë piramide, me udhëheqësin në krye që jep udhëzime e urdhër për turmen militantë në rrugë, në media, në institucione, në parlament, dhe kjo e fundit, njësoj si në sektet fetare fundamentaliste, është e gatshme të keqpërdoret, të besojë gjithçka që lideri thotë, të luftojë kundër atyre

që mendojnë ndryshe dhe ta çojë publikun në një ndarje të thellë pro e kundër, - një tipar i dukshëm oriental dhe parademokratik.

Greva rihapi debatin mbi të kaluarën dhe raportet e shoqërisë me fajet dhe përgjegjësitë e saj. Ajo dëshmoi se e kaluara nuk ka ikur, mbetet sunduese, mban peng të sotmen dhe për shkak të mosgjdhjes, - mbetet kërcënim serioz edhe për të ardhmen. 18 grevistët na treguan falsitetin e një sistemi politik të ngritur mbi propagandën, parullat dhe amoralitetin, të paafit të reformohet dhe të prodhojë besim, si dhe të dominuar nga lufta për influencë midis klaneve rozë e blu, të dyja të lidhur fuqishëm me kastën e vjetër drejtuese ish-komuniste. Grevistët nuk panë dallim midis qeverisjes me theks komunist të PS në fundin e viteve '90 me qeverisjen e sotme të PD-së, nuk gjetën dallime midis Fatos Nanos së vitit 2004 dhe Sali Berishës së vitit 2012, midis ZP së viteve 90 dhe RD së vitit 2012, pra midis atyre që më 1990 përbënin piramidën e lartë komuniste (shumica në PS) dhe atyre që u formua si shtresë e mesme në kupolën e PPSH, mori peng PD-në, i humbi asaj identitetin duke e shndërruar një krizës të dështuar tranzicioni. Debatet mbi grevën dëshmuar se e gjithë linja piramidale dhe administrative e atyre zyrtarëve të sotëm që duhej të trajtonin problemet e grevistëve të urisë përbëhen nga ish sekretarë partie, ish drejtues të Vllneratëve të Enverit, prinjollë të klaneve të larta komuniste dhe ish lektorë militantë të marksizëm - leninizmit. Të gjithë kanë qenë anëtarë të PPSH dhe asnjë prej tyre nuk është ish i përndjekur politik, çfarë tregon se kllka në pushtetin e sotëm dhe koalicioni që fshihet pas sundimit të tij, ka braktisur përfundimisht vlerat morale, ideologjike, identitetin dhe parimet politike, duke u bërë imitues e denjë e një kaste politike të njëjtte me atë të Byrosë Politike të viteve 1986-1990. Greva e qartësoi këtë regres demokratik vlerash, krizën e thellë të përfaqësimit, dekompozimin e të djathtës shqiptare dhe përcjell kështu një mesazh të fortë politik për zgjedhjet e vitit 2013, me një kosto të madhe të prishme kundër mazhorancës aktuale.

Greva nxori në pah edhe problematika të tjera të keqfunksionimit të qeverisjes. P.sh, ajo tregoi se partitë aleate të PD janë fiktive, mendimi i tyre për dialog u shpërfill tërësisht, ndërsa në vetë PD nuk ka mbetur më asnjë politikan me dinjitet e personalitet qytetar që të sakrifikojë për lirinë e mendimit, parimet e djathta dhe interesat publike. Katër ministra të rëndësishëm gjetën kohë të ishin në Peqin në garën e gjelave, por asnjë prej tyre, përshirë zëvendësimit apo vartësit të tyre nuk gjetën kurajë, kohë dhe as motiv të vizitonin goftë edhe dy minuta 18 grevistët e përndjekur, të cilët mbanin mbi supet e tyre 27 vite burgim politik. Kurajën e tillë nuk e gjeti dot as kryetari i Bashkisë së Tiranës dhe asnjë prej këshilltarëve lokalë të qeverisë, shumica e të cilëve janë profesorë universiteti, doktorë apo politikanë që kanë marrë edhe vetë pjesë në greva urie të mëparshme. Të

njëjtin efekt pati edhe për PS dhe të majtën shqiptare, e cila nga frika e kritikimit qëndroi asnjëherë dhe kështu, humbi rastin të dëshmojë se beson tek parimet sociale apo se ka aftësi për një rilindje të vërtetë kombëtare. Greva nxori jashtë loje partitë tradicionale të djathta (PBK, PLL, PDIU, PDK, etj) të cilat deri sot mburreshin me ish të përndjekurit, por që në presionin e PD heshtën ose u bashkuan me fushatën denigruese ndaj grevistëve dhe shtresës që ata përfaqësojnë.

Greva nxori zbuluar edhe institucionet kushtetuese, sidomos gjykatat, policinë e shtetit, prokurorinë, avokatin e populli, presidentin, parlamentin, etj, të cilët nën presion, me mosveprim të ndërgjegjshëm ose veprim të njëanshëm u bënë shtojcë të pushtetit kundër qytetarëve. 31 ditët treguan se institucionet që përfaqësojnë Shqipërinë, shtetin dhe qytetarët janë e mbeten gjysmaka, përfaqësues vetëm të një pale politike, të paafit të prodhojnë besim e stabilitet, unitet dhe garanci për demokraci funksionale. Për herë të parë pas shumë vitesh pamë një polici militante, që merr kurajën të tejkalojë ligjin dhe të etiketojë grevën e grevistët me fjalorin e padenjë dhe thellësisht partiak të kryeministrit. CNN, Reuters, BBC, VOA etj i kushtuan kronika, intervista dhe lajme periodike grevës së urisë, kurse ekranin ynë publik TVSH, jo vetëm që refuzoi për 31 ditë të japë një lajm apo kronikë të grevistëve, por u investua rregullisht në fushatën denigruese zyrtare e militantë kundër tyre.

Së fundi, greva u mbyll por debati mbi të mbetet më i hapur se më parë. Ajo i dha të drejtë përcaktimit të presidentit Jefferson se "edhe një individ i vetëm kur është me të drejtën përbën mazhorancë". Ata ishin 18, mbetën 6, mijëra herë më pak sesa pjesëmarrësit në mitingje periodike të partive të vjetra, por mesazhi e simbolika e tyre ishte e mbetet mijëra herë më e fuqishme sesa mitingjet e panumërtë të partive politike. Me këtë forcë morale greva nxiti partitë dhe shoqërinë të diskutojë vlerat e demokracisë, parimet kushtetuese ku bazohet shoqëria jonë, si dhe sfidat e saj për të ardhmen. Që sot askush nuk ka më dilemë se standardet e pushtetit ndaj grevës ishin tërësisht në kundërshtim me këto parime dhe vlera, dhe se hendeku midis Shqipërisë së sotme dhe asaj evropiane u bë edhe më i thellë. Grevistët morën premtimin se në rast të rotacionit politik kërkesat e tyre do të realizohen brenda tre viteve, si dhe dhanë premtimin se do të jenë aktiv në ditët, javët dhe muajt e ardhshëm në mbrojtjen e kauzës të cila besojnë, për të cilën kanë sakrifikuar rininë e tyre dhe për të cilën ka aq shumë nevojë Shqipëria. Mbi të gjitha greva dha mesazhin se ky vend ka nevojë themelore për një revolucion idesh, vlerash, virtutësh dhe moraliteti, për një rzigim të përgjegjësisë publike e qytetare, për rotacion elitash dhe ndryshim të sjelljes politike, për një shoqëri civile më aktive, media më të pavarur, politikë më qytetare dhe institucione më funksionale.

Koment

Vetvrasja e shumicës në pushtet



NGAANDI KANANA

vijon nga faqja 1

...shpirtërore, thashethemet e deri tek edukimi pa kursim me ngjyrime mallëngjimi patern. Komentimi i opozitës si lojë publike bëhet i përditshëm, kur në dispozicion ke gati të gjithë televizionet, radiot, dhe gazetat. Gara e inteligjencës filozofike ngelet si qëllim në vetvete, dhe këtu fillon kurthi i të rreshtuarit gati të vërtetave politike. Çfarë i kërkoni kundërshtarët opozitës Shqiptare? Program dhe organizim. Kërkesa logjike, që bëheshin me bindjen se ndërkohë që këto ndodhnin ekuilibrat mes organizatorit do të humbinsin. Media e "pafund" e pozitës do gjente skema ku do të vendoste mbi baza kohore, apo besimi opozitarë kundër opozitarësh. Kjo ka funksionuar për një kohë të gjatë me momente të shkurtra armëpushimi. Nëse Partia Socialiste do të kish fituar në vitin 2009 asnjë ndryshim nuk do të kish' ardhur. Me shumë gjasa Sandër Frangaj do kish' ndërruar kurs. Çili do transformonte mendimet e tij dhe kaq. Një Parti përtej të majtës dhe të djathtës do të kishte arsye të forta të perceptonte si arsye të fitores pragmatizmin, gjetjet elektorale, raport i mirë i Pi-ar, problematikë që do të fillonte dhe mbronte në një fjalim. Asnjë përgjegjësi ndaj elektoratit të papërcaktuar si në formë, si në bindje. Berisha i vodhi votat, dhe çoi për pak kohë në kaos opozitën që votohet si mahorancë çdo herë që kërkon votat e Shqiptarëve. Ndoshta e vetmja vjedhje që do mund t'i falet Salut., për dy arsye. E para se, mandati i dytë tregoi se dilemtat mbi ndryshimin i tij ishin të pavërteta. Berisha në të njëjtin model, po grabit çdo institucion, vret dhe lë të vdesin qytetarë të këtij vendi. Gënjën për krizën, si në vitin '96. E dyta se, pa-ndryshimi i tij konstant në kohë vuri në pozita ndryshimi opozitën. Historia e 15 viteve me parë kërkon dhe një program të ndryshëm, që të tregojë se ndryshimi do të vijë këtë herë i menduar dhe jo spontan.

Por programi nuk mjafton. Të dish ku qëndron i ndryshëm nga kryeministri është vetëm njëra anë e detyrës së një opozite të vërtetë. Organizimi serioz kundër një pushtetari që të vret ditën me diell ishte hapi tjetër për tu kryer në kohë. Maxhoranca ka organizim tek i cili dhe varet. Administrata ka mbi 80 mijë të punësuar. Policia e shtetit, garda, ushtria, marina, ushtarët në Afganistan drejtorja e burjeve, policia bashkiake, rojet e ministrive, punonjësit e trenave, mësuesit e kërcënuar, Teatri kombëtar, kori i ndryshëm të sjelljes politike, për një shoqëri civile më aktive, media më të pavarur, politikë më qytetare dhe institucione më funksionale.

toruar nga një cep i botës tek tjetri. Në një shkrim me titull "strategjia e fitores" të Leart Kolës, që me erdhi me e-mail përpara se të botohej, lexovase Opozitës i duhen militantët për të fituar dhe se strategjia e organizimit kapilar, qytetet më qytet, fshat më fshat, lagje me lagje për zgjedhjet e ardhshme është e duhura. Dhe ka të drejtë Learti. Të organizuar në formatin e vjetër opozitarët janë më shumë. Për shkak të traditës, për shkak të eksperiencës; se organizatorët evjetër njohin çdo detaj të zgjedhjeve. Një pikë tjetër e fortë është se kjo strategji bën të pamundur mundësimin e sulmit me "kokë poshtë" nga mediat e pozitës. Mund të sulmohet Edi Ramën, Gramoz Rucin, apo Eri-on Velinë por është pamundur të sulmohet aktivistët e organizatave në periferi. Anonimiteti është forca e tyre. Njerëz të padukshëm që mund të luftojnë çdo ditë me forcën e bindjes, se këtë herë Berisha duhet të ikë.

Një parti opozitare që nuk vepron si parti elektorale merr mbi vete përgjegjësi dhe detyrime që janë peshë më evidente se komentimi i disa analistëve në një studim me ndriçim dhe temperaturën e duhur për të mos u djersitur përgjatë kundërshtive mediatake. Organizator në bazë mban mbi vete peshën e një premtimi që duhet mbajtur dhe kjo e bën me të vërtetë se çdo premtim i parë përmes virtualitetit. Organizimi mbi bazën e organizatave në çdo cep të Shqipërisë e bën opozitën të preklushe nga njerëzit, me këmbë në tokë dhe jo futurake. Organizimi klasik i jep forcë bazës, e domosdoshme kjo në periudha të vështira ku zhvillimi ekonomik ndikon më mënyrë më agresive në jetën e njerëzve.

Tv Klan e ka të pamundur organizimin e sulmit mediatak, duke qenë se debati dhe forca e vërtetë e opozitës nuk do të jenë deklaruar për shtyp, shpesh spontane, por organizimi në detaj i përballoje-s me shtetin e Berishës.

Sa për thyerje; gazetarët në kohën e lirë janë njerëz shumë të lezetshëm dhe kjo do vlerësohet në kohën e duhur.

Detaj simpatik i këtij zhvillimi është se ishin komentuesit e pozitës ata që e kthen opozitën në rrugën e duhur. Tani është vonë që të kthejnë mendje për të menduar një kurth që do të ndryshonte rezultatit. Ishte arroganca në veprime që ka rreshtuar çdo kundërshtar ndaj pozitës në një front të përbashkët. Ishte mëndje-madhësia dhe besimi se administrata mjafton ajo që i shtyu demokratët të flasin për mungesë strategjie dhe organizimi. Është koha e gjatë në pushtet që ka përforcuar vullnetin dhe besimin se ndryshimi duhet të ndodhë në 2013. Rruga e duhur është organizimi dhe PS di ta bëjë. Meritën për këtë sigurisht e kanë deputetët dhe drejtuesit e PD, ashtu siç pati meritë Hitleri, që bota mbarë pas vdekjes së tij e urreu e bindur luftën. Si Führer-i dhe PD me vetvrasjen e saj, transformoi forcën tjetër në vend, duke na dhënë një shans pas torturës, për të pasur një alternativë më demokratike në qeverisje.



ZBAVITJE

[SHQIPTARJA.com] *nditëse*

Dalin në shitje këpucë me GPS

Tashmë nuk mund ti fshiheni askujt pasi me këto këpucë "magjike" mund të zbulojnë vendndodhjen tuaj. Por jo vetëm kaq. Të gjithë familjarët e atyre pacientëve që vuajnë nga sëmundjet të kujtesës nuk duhet të shqetësohen më pasi t'i pajisin ato me këto lloj këpucësh. Në pamje të parë, ato dukën si këpucë normale, por në fakt janë shumë ndryshe, pasi në brendësi të tyre janë të pajisura me një sistem GPS. Kjo për të ndihmuar më së shumti personat që vuajnë nga sëmundjet e memories. Këpucët kanë dalë në shitje për herë të parë në Mbretërinë e Bashkuar. Tani familjarët e pacientëve që do të mbajnë veshur këto lloj këpucësh nuk do të shqetësohen më për vendndodhjen e tyre, pasi përmes aparatit smartphone do të bëjnë të mundur vendndodhjen e tyre për disa sekonda.



Tallet me një lutje në rrjete sociale, rrezikon 18 muaj burg

Pianisti dhe kompozitori i njohur turk Fazil Say është paraqitur sot përpara një gjykate në Stamboll, pasi akuzohet për blasfemi. Say, i cili ka luajtur për Orkestrën Filarmonike të New York-ut dhe me Orkestrën Simfonike të Berlinit, akuzohet për disa postime të tijat në rrjete sociale, mbi të gjitha për një postim gjatë muajit prill, ku tallej me një lutje. Gjatë muajit qershor, prokurorët ngritën padi kundër tij për nxitje të urrejtjes publike dhe për fyerje të vlerave fetare. Say, i cili ka shërbyer si ambasador i kulturës për Bashkimin Evropian, i ka mohuar akuzat e ngritura kundrejt tij dhe ka kërkuar që të lirohet nga këto akuzat. Gjykimi i tij është shtyrë deri më 18 shkurt dhe nëse shpallet fajtor ai rrezikon deri në 18 muaj burg.



Adoleshentja 16-vjeçe me mjekër dhe mustaqe

Një adoleshente 16-vjeçare nga Kina është izoluar në dhomën e saj dhe nuk pranon të dalë, pasi fytyra e saj është e mbuluar nga mjekra dhe mustaqe. Vajza me emrin Nana vuan nga hirsutizmi që i është shkakuar nga mjekimet për aneminë e saj në vitin 2010. Për shkak të mungesës së rruazave të kuqe ajo u shtrua në spital ku mjekët e trajtuan me medikamentet e nevojshme për aneminë. Ndonëse ilaçet i përmirësuan shëndetin, i shkakuan edhe ndryshime fizike si dalja e mjekrës dhe mustaqeve. "Pasi mori ilaçet nisi t'i dilte mjekra, krahët dhe këmbët i janë mbuluar me qime," është shprehur nëna e saj. Ndërkohë 16-vjeçarja ka dy vite që nuk shkon më në shkollë pasi i vjen turp nga pamja e saj.



SUPER FJALEKRYQ

15x15 crossword puzzle grid with numbers 1-99.

HORIZONTAL

- 2. Emri në Kod i operacionit të sulmit nazist kundër Bashkimit Sovjetik.
10. Bëjnë basma me një as.
13. U quajt Toka e van Diemen.
20. Fillojnë aktivitetin.
22. Ishte muza e astronomisë.
24. Burt që qe aktor i famshëm.
26. Kufizojnë një rajon.
27. Sigla e gjuajtës-bombarduesve britanikë.
29. Marsi i akrepi.
31. Janë amatorë.
34. Është centrali me reaktore.
35. Një pjesë e referetatit.
37. Bazohet në ekstreme.
38. Mund të jetë pa kushte.
40. Forma po nuk ra.
41. Të parat në stadium.
42. Komandohet nga gjenerali.
44. U paraprindë fabrikave.
45. Ndre i Vaji I bylbylit.
47. Një ushtrorët një me dhunë.
49. Mund të jetë kala.
49. Muzika e eminem.
51. Kështu ju të palëvizshmet.
54. Posta elektronike.
55. Ka dhembë të hekurit një e tillë.
57. Mund të jetë edhe asnjënjese.
60. U printe hunëve.
61. Kështu është ai që nuk qesh.
63. Është dritë për sakë.
66. Mund të bëhen kundër një vendimi.
68. Ishte populli i druidëve
71. Ajo e luftës ishte Ares
73. Njëlloj për latinët.
74. Janë holandezë në Natal.
75. Kush bën... vështron.
76. Nënstron dakët.

- 78. I famshëm ai i Sizifit.
80. Inicialet e Moravia-s.
82. Kufizojnë matjet.
83. Janë të ndryshme në teste.
84. Një... në domino.
85. Giulio, kimist Italian fitues Nobel në vitin 1963.
87. Të lenë në mëdyshe.
90. Kanë qenë numrat 1 në futboll.
94. Një pjesë e operas.
95. Teket e një tende.
96. Një... dollar.
97. U shkrua nga Dostojevskij.
98. Shkruhet edhe i dhjeti.
99. Fillojnë ideologjinë.

VERTIKAL

- 1. Një piano... lokal
3. Në krye të autoriteteve.
4. Rrallë është përgjysmë.
5. Një fis si vandalet.
6. Janë në skaje.
7. Turistë të oazit.
8. Një hyrje të oazit.
9. Xhiro e Spanjës.

- 10. Linda e Ekzorcisti.
11. Republika me kapitenët regjentë.
12. Janë armët si bazooka.
13. Një mund të jetë mbi xhiro.
14. Në fund majtas.
15. Mund të jenë 4 X 100.
16. Janë mënyra... për të mësuar gjuhë.
17. Janë produktet kundërmuese.
18. Opera e Mascagni-t.
19. Janë shqetësimet e... prijtes.
21. Është krimb në grep.
23. Një V në CV.
25. Fillojnë ceremoninë.
28. Janë vajzat në volejball.
30. Një qytetar i... qytetit.
31. Është sëmundje ngjitëse.
32. Janë makinat si limousine.
33. Tallur pa çifte.
36. Ishin hipokritët e Nikodemit.
38. Është edhe ai i krahërorit.
39. Korri një fitore që askush s'e dëshiron.
42. Matet pa kufij.
43. Kush është... hap rrugë.
46. Inicialet e Steinbeck.
50. Lunaire i Schönberg.

- 52. Kështu është alumini.
53. Ishte mifma që u dashurua nga Zeusi.
55. Janë enë bakri.
56. Është lavdia në kabala-në hebraike.
58. Është goditja direkte në boks.
59. Haset pa kufij.
62. Shkroi Një jetë e Jezusit
64. Është histori dashurie.
65. Besa aktore.
67. Mbyllin fushatat.
69. Janë torta pa zë.
70. Nuk shuhej dot nga Tantalit.
71. Një marrëveshje.
72. Të parat në ambient.
75. Parashitesë zmadhuese.
77. Gjysmë rekord.
79. Një mendim.
81. Udhëhoqi Marshimin e Madh.
82. Parashitesa e muskulit.
86. Qenër në kaos.
88. Harris aktor.
89. Kufizojnë trotuarët.
91. Mbarojnë fare.
92. Markë pistolette.
93. Fillojnë ristas.

"Ruan" virgjërinë e vajzës, nëna seks me shokët e saj



Epabesueshme por e vërtetë, një nënë ka kryer marrëdhënie seksuale me tre shokë të vajzës së saj në mënyrë që ajo të mos humbte virgjërinë. Pas zbulimit të këtij fakti ka qenë vetë nëna, e cila ka rrefyer për autoritetet arsytet se përse ka kryer një akt të tillë. Gruaja rreth të 30-ve ka qenë mjaft e shqetësuar për jetën seksuale të vajzës së saj. Adoleshentja kishte shumë miq por në veçanti shoqërohej me

tre djem, të cilët ishin miqtë e saj të ngushtë dhe vinin shpesh në shtëpinë e tyre për të takuar vajzën. Sipas nënës ajo ka menduar se djemtë do ta bindnin vajzën e saj për të kryer marrëdhënie seksuale duke gjykuar edhe nga mosha e re e djemve. Kështu ajo ka vendosur të "sakarifikohet" për të, duke kryer vetë marrëdhënie me të miturit dhe duke shpresuar se ata do ta linin të qetë adoleshentën.

HOROSKOPI

Dashi
Sot në shenjin tuaj do mbizotëroj ndjenja e peripetisë. Ndoshta do keni edhe qëllime serioze në planet tuaja megjithëse kjo do ketë veshjen e dickaje të vrullshme optimiste të re dhe ndoshta paksa të rezikshme.

Demi
Dita e sotme me sa duket do ju sjell lajme të mira në planin ekonomik. Me sa duket ju jeni në fazën e një finalizimi të një marrëveshje ekonomike megjithëse shpenzimet në anën tjetër janë të konsiderueshme.

Binjaket
Dita e sotme me kaq shumë dalje dhe energji nga ana juaj pa detyrim mund të ngrej zhelozi në të tjerëve apo kundërshtimet e tyre Kujdes apo marrëdhëniet në çift apo në debatet dhe diskutimet me bashkëpunëtorë të ndryshëm.

Gaforja
Dita e sotme nuk do ketë të ngjashme asgjë me fjalën rutinë apo mbyllje. Do keni shumë energji dhe shumë punë për ta shpenzuar. Kujdes nga nervozizmi apo aksidentet e vogla të cilat mund të ndodhin trjeshit nga pakujdesia.

Luani
Për shenjin tuaj dita e sotme do jetë me sa duket një ngacim i fuqishëm në aspektin erotik. Me dëshirën për të bërë gjërat shpejt dhe me shumë forcë shpirtërore do kërkonti vazhdimisht gjëra për tu argëtuar.

Virgjëresha
Dita e sotme për shenjin tuaj sjell më shumë se sa duhet dëshirë apo fiksim për tu soganur me cëshitet familjare apo me problemet që mund të keni patur aty. Nuk duhet të krijoni situatë të ndërlikuara.

Peshorja
Do gjeni së pari një mundësi për të dal dhe biseduar më shumë në ditën e sotme. Mund të udhëtoni apo të planifikoni për gjëra që vërtet i doni apo i keni patur si pikësynime. Mos u acaroni në caste pritjeje.

Akrepi
Dita e sotme do sjell për ju një shans për tu kënaqur në aspektin ekonomik por edhe një mundësi më shumë për të shpenzuar. Kujdes në mënyrën se si do të manaxhoni paratë tuaja pasi shumë shpejt mund të mbeten pa gjë.

Shigjetari
Sot energjia dhe veprimi nuk do mungojnë në shenjin tuaj. Mund të mos arrihet të përbani nevrat në moment të caktuar por e sigur është që odo qëllim që I keni vënë vetes do keni mundësi të shikoni në fund.

Bricjapi
Evetmja mënyrë për tu qetësuar në ditën e sotme është të merreni me veprimtari krijuese. Nu duhet për asnjë moment të mendoni negativisht apo të bëheni hakmarrës. Shikoni me kujdes të gjitha veprimet.

Ujori
Dita e sotme do jetë një ditë ku shokë e miq do jenë të shumtë. Dajlet dhe takimet apo qëllimet do duket se mund t keni më të lehta për ti arritur. Në jetën erotike do ndjeheni më mirë apo më të privilegjuar.

Peshqit
Nuk duhet gjatë kësaj periudhe të nervozoheni apo të humbni kontrollin përse i përket sqarimeve me epror apo persona me të cilët ju lidh puna. Po kështu nuk duhet të vështroni në disa aspekte të marrëdhënies në çift.

ASTROLOGE MERI SHEHU 0900 673 4000

**LAJME
NGA BOTA**

**■ Dje debati i fundit
Obama- Romney**

Barack Obama dhe Mitt Romney realizuan dje debatin e tretë dhe të fundit para zgjedhjeve të 6 nëntorit. Debatit do të mbahet në Boca Raton të Floridës dhe pritet që të ketë fokus në politikën jashtme. Pyetjet, të drejtuara nga udhëheqësi i debatit, priteshin të parashtronin pesë tema të diskutimit: "Rolin e Amerikës në botë", pastaj konfliktin në Afganistan dhe Pakistan, programin bërthamor të Izraelit dhe Iranit, ndryshimet në Lindjen e Mesme dhe ballafaqimin me terrorizmin, si dhe "rritjen e Kinës dhe bota nesër".

**■ Izraeli e SHBA-ja, stërvitja
me e madhe e përbashkët**

Armata izraelite njoftoi sot për fillimin e stërvitjes më të madhe ushtarake që është mbajtur ndonjëherë në SHBA. Në stërvitjen e mbrojtjes kundërajrore të quajtur "Sfida e egër 2012" marrin pjesë 3500 amerikanë dhe 1000 izraelitë. Ushtritë e dy vendeve aleate ushtrinë se si t'i përgjigjen bashkërisht një varg kërcënimeve me të cilat ballafaqohet Izraeli. Në fillim ishte planifikuar që ushtrimi të mbahej në muajin prill, por ai qe shtyrë me kërkesë të Izraelit. Kjo ndodhi në momentin e spekulimeve në rritje për sulmin e mundshëm izraelit mbi stabilitetet nukleare iraniene nëse Teherani nuk do të ndalonte me pasurimin e uranimit.

**■ Planifikuesit e aktit
terrorist gjykoen në Londër**

Tre britanikë janë paraqitur para gjyqit në Londër, nën akuzat se kanë planifikuar komplot për të kryer sulme vetëvrasëse me bomba që, si thanë prokurorët, do të mund të kishin qenë më vdekjeprurëse se sa sulmet e 7 korrikut të vitit 2005, kur në shpërthimet vetëvrasëse të koordinuara nëpër autobusë dhe në rrjetin hekurudhor nëntokësor (metro) qenë vrarë 51 persona dhe mbi 700 të tjerë qenë plagosur. Prokurorët i thanë gjykatës se Irfan Khalid dhe Ashik Ali, që të dy 27 vjeçarë, dhe Irfan Naseer, 31 vjeç, planifikuan të kryejnë sulme ndoshta në një shkallë edhe më të madhe.

**■ Rasmusen: Forcat afgane
të gatshme për sigurinë**

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen i tha Radios Evropa e Lirë se ai është "i bindur" se forcat afgane "do të jenë plotësisht të afta" për të marrë kontrollin e sigurisë së vendit të tyre deri në fund të vitit 2014. Rasmussen tha se forcat afgane tashmë po udhëheqin rreth 80 për qind të operacioneve të sigurisë në vend, një fakt ky që ai e quajti "mjaft domethënës". Shëfti i NATO-s kërkoj gjithashtu nga fqinjii i Afganistanit, Pakistani, që të "risë" operacionet kundër kryengritësve në rajonin kufitar.

**■ Tre të vrarë nga të
shtënat në Milwaukee**

Tri gra janë vrarë dhe katër persona janë plagosur si pasojë e të shtënave në qendrën tregtare në periferi të Milwaukee, raportojnë mediat amerikane. Ndërkohë, policia ka identifikuar sulmuesin si Raddcliffe Franklin Haughton. Sipas policisë, i dyshuari, 45 vjeçar, është gjetur i vdekur në këtë qendër. Policisë i janë dashur disa orë që të gjejnë trupin e viktimës, ngase druhej se mund të kishte eksploziv brenda objektit. Raportohet se sulmi mund të ketë pasur lidhje me mospajtimet që sulmuesi ka pasur me gruan e tij, e cila thuhet të ketë punuar në këtë qendër.

**■ Irani e Siria, ndërhyrje
në transmetime satelitore**

Unioni Evropian i Transmetimeve (EBU) tha se Siria dhe Irani duket se qëndrojnë pas ndërhyrjeve në shërbimet satelitore të lajmeve të SHBA-së dhe të BE-së në disa pjesë të Lindjes së Mesme. EBU, duke e quajtur ndërhyrjen si një "sulm mbi pavarësinë e mediave", tha se transmetuesit e goditur janë BBC, France 24, Deutsche Welle dhe Zëri i Amerikës.

Video dhe lajme nga e gjithë Bota



DIGITALB

TOKESORE
KANALI 48

*Do na ndiqni në
gjithë Shqipërinë*

DIGITALB

SATELITOR
KANALI 51

*Do na ndiqni në gjithë Shqipërinë,
Maqedoni, Kosovë, Itali, Greqi
dhe në pjesën tjetër të Europës*

VALË UHF

NË PREFEKTURAT:
TIRANE - DURRES - LEZHE - FIER

ABC

ALBANIAN BROADCASTING COMMUNICATION
KANALI 158

Çdo ditë në

A1 REPORT!

Origjina e Lajmit

• Alba Malltezi
Drejtores e Përgjithshme
e Free and Fair Media Group

• Anila Basha
Drejtores e Shqiptarja.com
• Arben Rrozhani
Kryeredaktor

Politika: Jakin Marena
Ekonomia: Genc Kondi
Kronika: Habjon Hasani

Sociale: Esmeralda Keta
Kulturë: Admirina Peçi

Design: Altin Aliaj
Genti Manelli
Website: Suela Gera
Indrit Maraku

Departamenti i Marketingut:
Cel: +355696060419
marketing@shqiptarja.com

Shpërndarja:
Saimir Zenelaj
cel: +355696060418
Ermal Kacaniku
cel: +355696088847